FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 47

Tiranë – E martë, 29 mars 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 26/2022, datë 17.3.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 95/2016 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit".....	7019
Vendim i Kuvendit nr. 27/2022, datë 17.3.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil".....	7021
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 12.3.2022	Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë.....	7023
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 174, datë 25.3.2022	Për emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Shkodrës.....	7024
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 16.2.2022	Me objekt deklarimin e shkarkimit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.....	7024
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 22.2.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 2, datë 12.1.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 63, datë 3.3.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; dhe nr. 00-2021-360, datë 25.5.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	7080

VENDIM
Nr. 26/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 95/2016 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIN E PAGAVE TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, dhe nenit 12, pika 6, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të vendimit të Kuvendit nr. 95/2016 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit" ndryshohen sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 17.3.2022

Lidhja nr.1 **STRUKTURA E AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**



Lidhja nr. 2 ORGANIKA E AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

	POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I.	**Kryetari i Autoritetit**		**1**
	Sekretar/e i Kryetarit		**1**
	Specialist i Medies, Marrëdhënieve me Publikun dhe i Publikimeve	III B	**1**
	Anëtarët e Autoritetit		**4**
	Drejtoria e Arkivit		**11**
	Drejtori	II B	1
	Sektori i Ruajtjes së Fondeve		4
	Përgjegjës Sektori	III A	1
	Specialist	III B	3
	Sektori Përpunimit		3
	Përgjegjës Sektori	III A	1
	Specialist	III B	2
	Sektori Digjitalizimit dhe Fotokopjes		3
	Përgjegjës Sektori	III A	`1
	Specialist	III B	2
	Drejtoria e Sigurisë dhe Zhvillimit Teknologjik		**6**
	Drejtor	II B	1
	Sektori I Zhvillimit Teknologjik		3
	Përgjegjës Sektori	III A	1
	Specialist	III B	2
	Sektori i Sig dhe Qark. të Inf. të Klasifikuar		2
	Specialist	III B	2
II .	**SEKRETARIATI TEKNIK**		**41**
	Sekretari i Përgjithshëm	I B	**1**
	Drejtoria e Informacionit		**13**
	Drejtor	II B	1
	Sektori Kërkesa Individuale dhe për Qëllime Rehab. e Dëmshpërblimi		9
	Përgjegjës Sektori	III A	1
	Specialist	III B	8
	Sektori Kërkesa për Informim nga Institucionet		3
	Përgjegjës Sektori	III A	1
	Specialist	III B	2
	Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit të Qytetarëve		**7**
	Drejtori	II B	1
	Sektori i Projekteve Studimore dhe Audiovizuale		3
	Përgjegjës Sektori	III A	1
	Specialist	III B	2

Sektori Kërkesa për Qëllime Studimore, Medie etj.		3
Përgjegjës Sektori	III A-1	1
Specialist	III B	2
Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financave		**15**
Drejtori	II B	1
Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit		4
Përgjegjës Sektori	III A	1
Specialist (burime njerëzore)	III B	1
Specialist (arkiv protokolli)	IV B	2
Sektori Juridik dhe Prokurimeve		3
Përgjegjës Sektori	III A	1
Specialist	III B	2
Sektori i Financës dhe Shërbimeve		7
Përgjegjës Sektori	III A	1
Specialist i Financës	III B	1
Specialist i Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes	III B	1
Magazinier		1
Pastrues		2
Shofer		1
Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur		**5**
Drejtori	II B	1
Specialist	III B	4
Gjithsej		**65**

VENDIM
Nr. 27/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 98/2014 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL"

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, si dhe nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të vendimit të Kuvendit nr. 98/2014 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil" ndryshohen sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 17.3.2022



Lidhja nr. 2

STRUKTURA E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Funksioni	**Nr. Punonjës**	**Kategoria**
Komisioneri	**1**	
Kabineti	**(2)**	
Këshilltar	1	II-b
Sekretar	1	
Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes	**(19)**	
Drejtor i Përgjithshëm	1	II- a
Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	**(7)**	
Drejtor	1	II- b
Inspektor	6	III- a
Drejtoria e Mbikëqyrjes	**(7)**	
Drejtor	1	II- b
Inspektor	6	III- a
Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese	**(4)**	
Drejtor	1	II- b
Inspektor	3	III- a
Drejtoria e Çështjeve Juridike, Integrimit dhe Studimeve	**(5)**	
Drejtor	1	II- b
Specialist	4	III- b
Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse	**(8)**	
Drejtor	1	II- b
Specialist (IT)	1	III- b
Specialist (Marrëdhëniet me Publikun dhe Burimet Njerëzore)	1	III- b
Specialist (Financë/Buxhet)	1	III- b
Specialist Arkivë/Protokoll	1	IV-b
Punonjës Mirëmbajtjeje	1	
Shofer	1	
Pastrues	1	
PUNONJËS GJITHSEJ	**35**	

VENDIM
Nr. 159, datë 12.3.2022

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR ZBUTJEN E EFEKTEVE TË NDIKUARA NGA LUFTA NË UKRAINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë mbështetje financiare, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj për një periudhë tremujore, kategoritë e mëposhtme:

a) Familjet dhe individët përfitues të ndihmës ekonomike, të përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë";

b) Individët përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c", të nenit 8, të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë";

c) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar;

ç) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar;

d) Personat, që përfitojnë pension invaliditeti, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

dh) Personat, që përfitojnë pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

e) Personat, që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe masa e pensionit mujor të tyre është më e ulët ose e barabartë me 50% të pagës minimale neto në shkallë vendi;

ë) Kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe përfitojnë kompensim për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 9.8.2006, "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike", nr.238, datë 7.4.2010, "Për një ndryshim në vendimin nr.565, të Këshillit të Ministrave, "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike"", nr.8, datë 14.1.2015, "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 5 187 429 000 (pesë miliardë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e njëzet e nëntë mijë) lekë dhe do të përballohen, në masën 5 000 000 000 (pesë miliardë) lekë nga buxheti i shtetit dhe 187 429 000 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e njëzet e nëntë mijë) lekë nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Mbështetja financiare e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, paguhet çdo muaj, duke filluar nga data 1 prill 2022 deri në datën 30 qershor 2022. E drejta për përfitimin e mbështetjes financiare është deri në datën 30 qershor 2022.

4. Procedura e pagesës së mbështetjes financiare realizohet, sipas legjislacionit në fuqi për pagesat e përfitimeve nga skemat e sigurimeve shoqërore dhe shërbimit social.

5. Mbështetjen financiare e përfitojnë personat e kategorive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të cilët kanë të drejtë për përfitim deri në datën 31 mars 2022 dhe kanë të drejtë të marrin vetëm një herë këtë mbështetje financiare pavarësisht se mund të jenë të përfshirë në më shumë se një kategori.

6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror bashkëpunojnë për verifikimin e personave që përfshihen në më shumë se një kategori me qëllim shmangien e pagesës së mbështetjes financiare më shumë se një herë.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe

Mbrojtjes Sociale, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.174, datë 25.3.2022

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Majlinda Angoni të emërohet prefekt i Qarkut të Shkodrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1, datë 16.2.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Elsa Toska	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Përparim Kalo	anëtar.

me sekretare Blerina Basha, në datat 1.2.2022, 3.2.2022 dhe 7.2.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen nr. 6 (K) 2021 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Taulant Balla, Klotilda Bushka, Mimoza Arbi dhe Erind Mërkuri, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Bledar Dervishaj dhe Katrin Treska, me autorizim.

OBJEKTI: Deklarimi i shkarkimit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 78 dhe 90, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 61 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Përparim Kalo, mori në shqyrtim pretendimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(Kuvendi),* përfaqësuesit e të cilit në përfundim të gjykimit kërkuan deklarimin e shkarkimit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë *(Presidenti),* zotit Ilir Meta, për shkelje të rënda të Kushtetutës, prapësimet e Presidentit, përfaqësuesit e të cilit në përfundim të gjykimit kërkuan deklarimin si të papajtueshme me Kushtetutën dhe shfuqizimin e vendimeve nr. 44/2021 dhe nr. 45/2021, datë 7.5.2021, nr. 54/2021 dhe nr. 55/2021, datë 9.6.2021, të Kuvendit, konstatimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes kushtetuese të krijuar nga Kuvendi me Presidentin, si dhe deklarimin e faktit se Kuvendi nuk ka kompetencë dhe legjitimitet të kryejë veprimtari hetimore parlamentare gjatë 4 muajve të fundit të mandatit të tij, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Presidenti i Republikës Ilir Meta është zgjedhur nga Kuvendi me vendimin nr. 53/2017, datë 28.4.2017. Në zbatim të nenit 88, pika 3, të Kushtetutës, ai ka filluar ushtrimin e detyrës në datën 24.7.2017.

2. Pas kësaj date ka nisur punimet Legjislatura IX e Kuvendit, me 140 deputetë, të cilët u organizuan në grupe të ndryshme parlamentare. Bazuar në dekretin e Presidentit nr. 10599, datë 29.8.2017, për datën e thirrjes së mbledhjes së parë të Legjislaturës IX, mandati i saj ka zgjatur për periudhën 9.9.2017–9.9.2021.

3. Gjatë kësaj periudhe mjedisi politik ka qenë i polarizuar dhe i karakterizuar nga mungesa e besimit të ndërsjellë midis aktorëve politikë. Midis ngjarjeve që shënuan edhe "*krizë politike dhe institucionale*" përfshihen zgjedhja nga Kuvendi në datën 19.12.2017 e Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm, bojkoti i punimeve të Kuvendit nga partitë politike opozitare për periudhën shtator – dhjetor 2018, dorëzimi në bllok i mandateve nga deputetët e partive politike opozitare më 21.2.2019 dhe zëvendësimi i tyre me kandidatët nga listat shumemërore, protestat e partive opozitare, shtyrja e datës së zhvillimit të zgjedhjeve vendore me dekret nga Presidenti, organizimi dhe zhvillimi i zgjedhjeve vendore në datën 30.6.2019, pavarësisht dekretit të Presidentit, mospjesëmarrja e partive opozitare në zgjedhjet vendore dhe zhvillimi i tyre pa kandidatë kundërshtarë në 30 bashki, përzgjedhja dhe emërimi i gjyqtarëve kushtetues, reforma zgjedhore për ndryshimet kushtetuese dhe ligjore gjer në caktimin e datës së zgjedhjeve të përgjithshme më 25.4.2021, zhvillimi i të cilave u parapri nga një fushatë zgjedhore e polarizuar.

4. Me zëvendësimin e deputetëve që dorëzuan mandatet e tyre në bllok, Legjislatura IX mbeti me 122 anëtarë. Ata u riorganizuan në grupe parlamentare, midis të cilave nuk pësoi ndryshim vetëm grupi parlamentar i shumicës qeverisëse.

5. Pas zgjedhjeve vendore të datës 30.6.2019, Kuvendi, bazuar në kërkesën e 55 deputetëve, vendosi ngritjen e një komisioni hetimor për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga Presidenti në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, me fokus dekretin për shtyrjen e tyre, kundër të cilit ishte miratuar edhe rezoluta "Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore"". Në datën 5.12.2019, me kërkesë të deputetëve propozues, Kuvendi vendosi zgjerimin e objektit të hetimit, duke përfshirë edhe veprimtarinë e Presidentit në emërimin e gjyqtarëve kushtetues. Edhe për këtë situatë Kuvendi kishte miratuar paraprakisht rezolutën e datës 15.11.2019, "Për shmangien e krizës kushtetuese me synim legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese".

6. Gjatë veprimtarisë së atij komisioni hetimor, me kërkesë të Kuvendit dhe të Presidentit, Komisioni i Venecias dha dy opinione, respektivisht opinionin CDL-AD(2019)019 të datës 14.10.2019 dhe opinionin CDL-AD(2020)010 të datës 19.6.2020. Në vijim të këtyre opinioneve, Kuvendi, në seancën plenare të datës 27.7.2020, miratoi raportin përfundimtar të komisionit hetimor për mosshkarkimin e Presidentit.

7. Zgjedhjet parlamentare të përgjithshme u zhvilluan në datën 25.4.2021 dhe fushata zgjedhore u karakterizua nga polarizimi i theksuar, gjë që u reflektua në mesazhet politike. Për mënyrën e komunikimit gjatë fushatës zgjedhore, Misioni i Kufizuar i OSBE/ODIHR-it, në raportin përfundimtar për vëzhgimin e këtyre zgjedhjeve parlamentare, ka konstatuar: "*Zgjedhësve iu prezantuan një sërë koalicionesh, partish dhe kandidatësh të pavarur si mundësi zgjedhjeje. Pavarësisht kësaj, në praktikë debati u përqendrua te zgjedhja midis vazhdimësisë dhe ndryshimit. Fushatës politike dhe posaçërisht mbulimit të saj nga media, i mungoi thellësia, me mesazhe publike që shpesh përqendroheshin te figura e liderëve kryesorë të partive dhe jo te diskutimet me në qendër problemet e vërteta. Mjetet e fushatës përfshinin takimet publike dhe fushatën derë-më-derë dhe, për shkak të situatës së pandemisë, pati një element të shtuar online, ku një rol të rëndësishëm patën rrjetet sociale dhe platformat e mesazheve. Posterat promovues u lejuan vetëm në zona të caktuara. U vu re edhe bërja e një fushate negative përmes përdorimit të billbordeve. Toni i gjuhës së përdorur gjatë fushatës nga disa udhëheqës partie dhe, në veçanti, nga Presidenti, ishte konfrontues. Ndonjëherë gjuhë agresive u përdor edhe në seksionet e komenteve në rrjetet sociale*" (*shih faqen 16 të raportit*).

8. Në datën 30.4.2021, bazuar në nenin 90, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 112 të Rregullores së Kuvendit, 49 deputetë kanë paraqitur kërkesë për shkarkimin nga detyra të Presidentit për shkelje të rënda kushtetuese. Në mënyrë të përmbledhur, sipas tyre, Presidenti, me veprimet, sjelljet dhe mesazhet e dhëna në publik, para dhe gjatë fushatës zgjedhore të

zgjedhjeve të përgjithshme të datës 25.4.2021, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore, ka shkelur rëndë nenin 86, pika 1, të Kushtetutës, sepse nuk ka garantuar unitetin kombëtar dhe nuk ka moderuar konfliktin politik; ka kryer veprimtari të njëanshme partiake kundër shumicës; është shfaqur si partiak dhe në daljet ose mesazhet publike ka mbajtur qartësisht anën e opozitës, në kundërshtim me nenin 89 të Kushtetutës; ka shkelur rëndë dhe në mënyrë të përsëritur detyrimin kushtetues të betimit, të parashikuar nga neni 88, pika 3, i Kushtetutës; ka cenuar rëndë të drejtat kushtetuese të individëve, imazhin dhe reputacionin e vendit, si dhe marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë, përmes mesazheve publike dhe intervistave në media dhe rrjete sociale; ka kryer veprime në kundërshtim me kompetencat kushtetuese të përcaktuara në nenin 94 të Kushtetutës nëpërmjet dhënies pa asnjë procedurë të titujve dhe dekoratave ose dhënies së shtetësisë shqiptare personave që nuk përmbushin kriteret ligjore apo nuk u janë nënshtruar procedurave të kontrollit ligjor.

9. Kryetari i Kuvendit, në datën 4.5.2021, ka vënë në dijeni Presidentin për kërkesën e grupit të deputetëve për shkarkimin e tij nga detyra, si dhe ia ka përcjellë atë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni i Ligjeve)* bashkë me dokumentet shoqëruese.

10. Në datën 4.5.2021 Kuvendi i ka përcjellë Presidentit shkresën e kryetarit të Komisionit të Ligjeve, në të cilën pohohej se komisionit i është përcjellë kërkesa e grupit të deputetëve dhe se ai do të mblidhej për shqyrtimin e saj më 5.5.2021, ora 12:00.

11. Presidenti, me shkresën e datës 5.5.2021, i ka konfirmuar Komisionit të Ligjeve marrjen e njoftimit në rrugë elektronike dhe shkresore, duke shprehur rezerva për përmbajtjen formale të tij. Ai e ka konsideruar procesin si mjet për të neutralizuar rolin e tij, duke evidentuar edhe shkeljet e procesit zgjedhor, që, sipas tij, duheshin analizuar nga Kuvendi. Në fund të shkresës Presidenti është shprehur se, nisur nga vëllimi i informacionit që duhej diskutuar, "*mbetet në pritje të reflektimit dhe përgjigjes, duke shprehur gatishmërinë për t`u takuar e diskutuar me Komisionin, edhe virtualisht, më 10.5.2021, Ditën e Drejtësisë*".

12. Në vijim të përgjigjes së Presidentit, Kuvendi brenda ditës i ka përcjellë atij njoftimin e Komisionit të Ligjeve për pjesëmarrje në seancën dëgjimore *online* më 6.5.2021, në përgjigje të të cilit Presidenti është shprehur se, bazuar në detyrimin e nenit 112, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, afati 24 orë ishte i pamjaftueshëm, për shkak të rëndësisë së çështjes. Po ashtu, Presidenti ka propozuar që seanca të zhvillohej më 10.5.2021, duke sqaruar se në datën 6.5.2021 do të zhvillonte veprimtari zyrtare të planifikuara më parë.

13. Komisioni i Ligjeve në datën 6.5.2021 ka shqyrtuar kërkesën e deputetëve dhe ka vendosur të miratojë raportin, duke i propozuar Kuvendit ngritjen e komisionit hetimor, me arsyetimin se kërkesa ishte në përputhje me nenin 90, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 112 të Rregullores së Kuvendit.

14. Me urdhër të Kryetarit, Kuvendi është mbledhur në seancë plenare në datën 7.5.2021, ora 10:00 dhe ka miratuar vendimet nr. 44/2021, "Për miratimin e raportit dhe të propozimit të komisionit të ligjeve për ngritjen e komisionit hetimor" dhe nr. 45/2021, "Për ngritjen e Komisionit Hetimor, "Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë"". Sipas këtij të fundit, hetimi ka për qëllim verifikimin e mënyrës së ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga ana e Presidentit në periudhën përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore, kurse objekt i punës së komisionit hetimor është përcaktuar: a) hetimi dhe verifikimi nëse aktet e kryera dhe deklaratat e dhëna nga Presidenti gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021 përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës; b) verifikimi i pasojave të këtyre akteve në raport me parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të vendit, si dhe marrëdhënieve me partnerët strategjikë të Shqipërisë; c) verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit, në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese. Komisioni hetimor parlamentar përbëhej nga 9 deputetë dhe afati i ushtrimit të

veprimtarisë së tij ishte 3 javë nga hyrja në fuqi e vendimit.

15. Këto dy vendime i janë njoftuar Presidentit në datën 10.5.2021, së bashku me njoftimin e së drejtës së tij për t'u shprehur në komision, duke i bashkëlidhur edhe dokumentet shoqëruese.

16. Në vijim, komisioni hetimor në datën 14.5.2021 ka njoftuar Presidentin për zhvillimin e seancës dëgjimore më 18.5.2021, bazuar në nenin 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, duke e ftuar për t'u dëgjuar në lidhje me objektin e hetimit. Presidenti i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit me shkresën e datës 16.5.2021, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit për ngritjen e komisionit hetimor dhe ndërprerjen e procedurave përkatëse parlamentare, me pretendimin se procesi shkel nenin 77 të Kushtetutës dhe është i parregullt në drejtim të legjitimitetit të komisionit hetimor, fiktivitetit të tij dhe kohës së pamjaftueshme për të kryer veprimtari. Gjithashtu, Presidenti ka ngritur pretendime se Kuvendi ka tejkaluar kompetencat, ka krijuar mosmarrëveshje kushtetuese dhe ka cenuar pavarësinë e institucionit të Presidentit. Ndër të tjera, Presidenti është shprehur se në datën 18.5.2021 kishte planifikuar të zhvillonte takime në Slloveni në kuadër të takimit të Kryetarëve të Shteteve të Nismës së Procesit të Brdo-Brijunit, për të cilin kishte dijeni Protokolli i Shtetit, si dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

17. Duke qenë se Presidenti nuk u paraqit në seancën dëgjimore të datës 18.5.2021, Kuvendi, brenda ditës, i ka përcjellë njoftimin e komisionit hetimor për të marrë pjesë në seancë dëgjimore në ditën dhe orën që do të ishte më e përshtatshme për të brenda periudhës 19.5.2021–24.5.2021, duke kërkuar që t'ia njoftojë atë komisionit të paktën një ditë përpara. Presidenti i është përgjigjur këtij njoftimi me shkrim në datën 21.5.2021, duke vënë në dukje se mbetej në pritje të shqyrtimit të kërkesës së tij të datës 16.5.2021, për të cilën duhet të reflektonin deputetët.

18. Në datën 21.5.2021 Presidenti është njoftuar nga Kuvendi se komisioni hetimor do të zhvillonte seancën dëgjimore në datën 24.5.2021. Në përgjigje të këtij njoftimi Presidenti ka dërguar shkresën e datës 24.5.2021, me të cilën është shprehur se nuk mund të diskutonte dhe as të dëgjohej nga një strukturë pa legjitimitet, që nuk duhet të ekzistonte sipas Kushtetutës.

19. Në vijim, komisioni hetimor, me vendimin nr. 7, datë 28.5.2021, ka miratuar raportin përfundimtar, duke i kërkuar Kuvendit miratimin e tij dhe shkarkimin nga detyra të Presidentit për shkelje të rënda kushtetuese. Në marrjen e këtij vendimi komisioni hetimor është bazuar në nenin 90, pika 2, të Kushtetutës, nenin 112 të Rregullores së Kuvendit dhe nenin 20 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" (*ligji nr. 8891/2002*).

20. Me vendim të Konferencës së Kryetarëve të datës 31.5.2021, shqyrtimi dhe votimi i raportit përfundimtar u caktua për t'u zhvilluar në një seancë të veçantë plenare, më 9.6.2021, ora 10:00. Brenda ditës, Kuvendi i ka përcjellë Presidentit raportin e komisionit hetimor dhe e ka njoftuar për datën e seancës plenare, duke e ftuar të dëgjohet.

21. Në datën 8.6.2021 Presidenti i është drejtuar Kuvendit, duke i kërkuar respektimin e Kushtetutës e ligjit dhe i ka përcjellë sërish shkresën e datës 16.5.2021 që përmbante pretendimet e tij për këtë proces.

22. Kuvendi, pasi ka shqyrtuar në seancën plenare të datës 9.6.2021 raportin përfundimtar, provat e administruara dhe propozimin e komisionit hetimor, me vendimin nr. 54/2021 ka miratuar raportin dhe konkluzionet e komisionit hetimor, ndërsa me vendimin nr. 55/2021 ka vendosur: "*Shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës.*".

23. Kuvendi ka arritur në përfundimin se Presidenti ka kryer shkelje të rënda kushtetuese, për shkak se ka cenuar: detyrimet kushtetuese si Kryetar i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit (neni 86, pika 1, i Kushtetutës) dhe për të mos qenë anëtar i një partie politike apo për të mos kryer çdo lloj veprimtarie tjetër që e bën të papajtueshëm në ushtrimin e funksioneve (neni 89 i Kushtetutës); betimin mbi Kushtetutë (neni 88, pika 3, i Kushtetutës), të lidhur me shkeljet në të drejtat në procesin zgjedhor, marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe marrëdhëniet me jashtë, pavarësinë e organeve të shtetit, si dhe në lidhje me rendin dhe sigurinë në vend; nenin 94 të Kushtetutës që e ndalon të ushtrojë

kompetenca që nuk janë parashikuar për të në Kushtetutë dhe në ligj.

24. Vendimi nr. 55/2021 i është dërguar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 14.6.2021, bashkë me provat dhe dokumentacionin përkatës.

25. Më 15.10.2021 Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, në bazë të nenit 62, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II
Pretendimet e palëve

26. ***Kuvendi,*** në vendimin e tij nr. 55/2021 dhe parashtrimet në seancë plenare, ka arsyetuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

26.1 Presidenti ka shkelur rëndë neutralitetin që duhet të ketë përfaqësuesi i unitetit të popullit në fushata zgjedhore (neni 86, pika 1, i Kushtetutës) pasi ka treguar anësi politike në mënyrë të hapur, publike, përsëritëse, aspak etike, madje në shumicën e rasteve denigruese për figura politike ose qeveritare, duke dalë jashtë rolit të tij kushtetues si Kryetar i Shtetit, që kërkon që ai të jetë asnjanës, jopolitik, të moderojë konfliktin politik dhe të jetë ekuilibrues. Presidenti ka shkelur nenin 89 të Kushtetutës në kuptimin substancial, pasi nga pozicioni i tij institucional u ka bërë thirrje publike shqiptarëve që të votonin ndryshimin, ka lëshuar akuza kundër shumicës, qeverisë dhe anëtarëve të saj dhe është sjellë si opozita, duke vepruar në thelb si anëtar partie. Ai ka shkelur edhe nenin 88, pika 3, të Kushtetutës që parashikon detyrimet për t'i shërbyer interesit të përgjithshëm të popullit, për të cilat është betuar t'i respektojë me dorën mbi Kushtetutë, shkelja e të cilave përbën shkelje të rëndë të Kushtetutës. Asnjë nga veprimet e Presidentit që janë vlerësuar si shkelje të rënda të Kushtetutës nuk parashikohet si kompetencë e tij në dispozitat e nenit 92 të Kushtetutës.

26.2 Shkeljet e rënda të Kushtetutës që kanë të bëjnë me betimin lidhen me: të drejtat në procesin zgjedhor; marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe vendet e tjera; pavarësinë e organeve të shtetit; rendin dhe sigurinë në vend.

26.2.1 Shkelja e të drejtave në procesin zgjedhor konsiston në: i. ndërhyrjen në procesin zgjedhor duke cenuar të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, e parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës; ii. mosrespektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në kundërshtim me nenin 15, pika 2, të Kushtetutës; iii. shfaqjen e sjelljeve diskriminuese që lidhen me bindjet politike, në kundërshtim me nenin 18, pika 2, të Kushtetutës.

26.2.2 Marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe vendet e tjera janë cenuar prej: i. qëndrimeve në intervista në emisione televizive për marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (*SHBA*) dhe ambasadoren e saj, të cilat konsiderohen se dëmtojnë rëndë marrëdhëniet me aleatin strategjik të Shqipërisë; ii. dëmtimit të imazhit dhe pozitës ndërkombëtare të vendit, për shkak të qëndrimeve publike denigruese ndaj përfaqësuesve të tjerë të trupit diplomatik.

26.2.3 Pavarësia e organeve të shtetit është cenuar nëpërmjet: i. retorikës së ashpër me institucione shtetërore; ii. ndërhyrjes në veprimtarinë funksionale të organeve të rendit dhe atyre të pushtetit vendor, siç është rasti i partisë "Fryma e Re Demokratike" (*FRD*), si dhe kërcënimit të strukturave të policisë vendore; iii. mbledhjes së denoncimeve të qytetarëve dhe ndërhyrjes në kompetencat e prokurorisë dhe në veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*KQZ*); iv. ndërhyrjes në pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese.

26.2.4 Shkeljet në fushën e rendit dhe të sigurisë në vend kanë të bëjnë me: i. mosmoderimin e konfliktit politik, madje nxitjen e tij; ii. përdorimin e një gjuhe të papërshtatshme për institucionet e pavarura dhe ato shtetërore gjatë deklaratave dhe qëndrimeve publike; iii. mesazhet që nxisin dhunën, ndasinë sociale dhe urrejtje midis popullatës.

26.3 Veprimet e Presidentit konsiderohen shkelje e rëndë në vlerësim të këtyre faktorëve: qëllimi i veprimeve/akteve që përbëjnë shkelje; rëndësia e ligjit/së drejtës së shkelur; konsistenca/përsëritja e shkeljes; impakti/pasoja që sjell shkelja; qëndrimi i subjektit ndaj shkeljes.

26.3.1 Qëllimi i sjelljeve të Presidentit nuk vlerësohet legjitim dhe Presidenti nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim konkret, sipas mekanizmave që parashikon Kushtetuta dhe ligji, për të rivendosur ndonjë shkelje të Kushtetutës

ose ligjit nga organet e tjera të shtetit, siç pretendohet prej tij.

26.3.2 Për sa i përket rëndësisë së ligjit/së drejtës së shkelur, aktet e Presidentit, që janë vlerësuar si shkelje kushtetuese, kanë cenuar marrëdhënie shoqërore dhe politike tejet të rëndësishme, që mbrohen nga Kushtetuta dhe ligje të miratuara me shumicë të cilësuar, si Kodi Zgjedhor dhe Kodi Penal ose ligjet e reformës në drejtësi, që lidhen me të drejtat e njeriut, rendin dhe sigurinë, marrëdhëniet me jashtë, pavarësinë e institucioneve dhe funksionimin e shtetit demokratik.

26.3.3 Për sa i përket konsistencës/përsëritjes së shkeljes, Presidenti i ka shfaqur qëndrimet e tij në emisione televizive (19), deklarata për mediet (9), postime në rrjetet sociale (45), si dhe në disa shkresa drejtuar institucioneve të pavarura në mënyrë të përsëritur. Presidenti ka pasur një rol tejet aktiv në fushatën zgjedhore, duke cenuar neutralitetin e procesit zgjedhor. Veprimtaria e tij ka qenë konsekuente dhe me intensitet të lartë gjatë gjithë fushatës, duke konkurruar edhe me forcat e tjera politike, që bënin fushatë sipas parashikimeve të legjislacionit zgjedhor.

26.3.4 Për sa i takon impaktit/pasojës që sjell shkelja, sjellja e Presidentit gjatë periudhës së hetimit ka treguar jo vetëm mungesë të plotë të vullnetit për bashkëpunim institucional midis aktorëve shtetërorë në të mirë të interesit publik dhe zhbllokimit të situatave që dëmtojnë demokracinë, por veprimtaria e tij në shkelje të Kushtetutës është bërë akute, duke sjellë që përmasat e shkeljeve të bëheshin jo vetëm të rënda, por edhe të rrezikshme, si në kontekstin e rendit kushtetues, ashtu dhe në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare, shtetit ligjor dhe rendit publik. Presidenti është përfshirë në fushatën zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare të muajit prill 2021, duke cenuar funksionin e përfaqësuesit të unitetit të popullit. Ai është pozicionuar kundër një pjese të caktuar të popullit, duke mos përfaqësuar më unitetin e popullit, pra tërësinë e tij. Qëndrimet dhe sjelljet që nxisin dhunën, si mjet për zgjidhjen e problemeve, ose retorikat e përdorura prej Presidentit në aktet e veta, kanë ardhur duke u përshkallëzuar deri në fund të fushatës. Me sjellje të përsëritura që prej vitit 2017, Presidenti ka kthyer me dekret një numër të konsiderueshëm të akteve ligjore të miratuara nga Kuvendi. Shkresat ose deklaratat e Presidentit drejtuar organit të prokurorisë, KQZ-së, Gjykatës Kushtetuese etj. rrezikojnë të zbehin punën e këtyre organeve të pavarura. Shkresa dërguar Gjykatës Kushtetuese ka sjellë uljen e integritetit të figurës së gjyqtarit kushtetues. Në nivel ndërkombëtar imazhi i Shqipërisë është cenuar nga kritika që Presidenti ka bërë publikisht për ambasadoren e SHBA-së dhe për trupin diplomatik në tërësi. Rezulton se aktet dhe sjelljet e Presidentit kanë pasur ndikim thelbësor.

26.3.5 Qëndrimi i Presidentit ndaj akteve dhe sjelljeve të tij, të cilat vlerësohen si shkelje kushtetuese, ka qenë i palëkundur dhe ai është justifikuar me argumentin se nuk njeh legjitimitetin e komisionit hetimor. Në shkresat drejtuar Kuvendit, Presidenti ka mbajtur qëndrimin se ky është një proces i montuar, për hakmarrje, se komisioni është jolegjitim dhe se ai vetë ka vepruar në mbrojtje të Kushtetutës etj. Një qëndrim i tillë i Presidentit vlerësohet si mungesë arsyetimi i shëndoshë dhe që e rëndon pozitën e tij në procesin e shkarkimit.

26.4 Presidenti në parashtrimet e tij ka ngritur vetëm argumente procedurale dhe nuk ka trajtuar anën materiale të procesit. Sipas dispozitave të ligjit nr. 8577/2000, në rastin e procedurave të shkarkimit është Kuvendi që vë në lëvizje një procedurë të tillë, ndaj nuk mund të ketë kërkime të tjera nga subjekti i interesuar, i cili nuk ka asnjë të drejtë procedurale dhe legjitimitet për të zgjeruar periudhën ose sjelljet që duhet të merren në konsideratë.

26.5 Pretendimet e Presidentit për shkeljet kushtetuese dhe ligjore në procedurën e dorëheqjes nga mandati të disa deputetëve të Legjislaturës IX, janë haptazi të pabazuara, pasi dorëheqja është akt individual i vendosur me vullnetin e tyre. Legjitimiteti i Kuvendit nuk mund të vihet në dyshim nga dorëheqja e disa deputetëve dhe fakti se ai mbeti me 122 deputetë. Kjo situatë është trajtuar edhe nga Komisioni i Venecias dhe ODIHR-i. Vetë sjellja e Presidentit ndaj Kuvendit në këtë periudhë i ka njohur legjitimitet të plotë këtij organi nëpërmjet shpalljes së ligjeve të miratuara. Madje edhe në dekretet për kthimin e disa ligjeve nuk është përdorur si argument mungesa e legjitimitetit. Presidenti, gjithashtu, është paraqitur në

komisionin e mëparshëm hetimor për shkarkimin e tij, si dhe ka administruar betimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese të emëruar nga kjo legjislaturë.

26.6 Pretendimi për mosdhënien e kohës së mjaftueshme për mbrojtje është haptazi i pabazuar. Presidenti e ka shfaqur qëndrimin e tij në lidhje me propozimin e grupit nismëtar për shkarkim dhe i ka kthyer përgjigje negative ftesës së kryetarit të Komisionit të Ligjeve për të qenë i pranishëm. Bazuar në nenin 89, shkronja "b", të Kodit të Procedurave Administrative, meqenëse ai e ka paraqitur paraprakisht mendimin me shkrim, e drejta e tij për t`u dëgjuar në këtë fazë është respektuar dhe zhvillimi i një seance dëgjimore do të ishte i pakuptimtë. Presidenti është ftuar disa herë për t`u paraqitur dhe për të dhënë shpjegimet e tij, si dhe është njoftuar për seancën plenare, pra i është dhënë mundësia të realizonte të drejtën e mbrojtjes. Ndërkohë, edhe caktimi i seancës plenare pas paraqitjes së raportit të komisionit hetimor është në përputhje me parashikimin e nenit 112, pika 3, të Rregullores.

26.7 Pretendimi për cenimin e afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 4, pika 6, i ligjit nr. 8891/2002, nuk qëndron. Ky ligj nuk zbatohet në këtë rast, sepse komisioni hetimor për Presidentin është ngritur në funksion të nenit 90 të Kushtetutës dhe jo të nenit 77 të saj, që ka të bëjë me realizimin e funksionit ligjvënës. Edhe Rregullorja e Kuvendit i parashikon komisionet hetimore në nenin 25, ndërsa procedura e shkarkimit rregullohet nga neni 112 i saj. Në rastin e shkarkimit vendimmarrja e Kuvendit nuk është rekomanduese dhe nuk ka funksion ligjvënës, por ajo vë në lëvizje në mënyrë detyruese një procedurë kushtetuese.

26.8. I vetmi ndalim për Kuvendin është ai i parashikuar nga neni 65, pika 4, i Kushtetutës për mosnxjerrjen e ligjeve brenda 60 ditëve të fundit të mandatit, ndërkohë që nuk ka asnjë ndalim kushtetues për funksionimin e komisioneve hetimore disiplinore. Referuar edhe përmbajtjes së nenit 4, pika 6, të ligjit nr. 8891/2002, nëse këto komisione janë ngritur, nuk ka ndalim për funksionimin e tyre. Legjislatura IX e mbyllte mandatin e saj më 9.9.2021 dhe periudha pararendëse 4-mujore fillonte më 9.5.2021. Komisioni hetimor është ngritur me vendimin e datës 7.5.2021, pra para fillimit të këtij afati, çka legjitimon punën e tij edhe në këtë periudhë.

26.9. Pretendimi i Presidentit se e drejta e shprehjes së tij nuk mund të kufizohet dhe se Kuvendi ka cenuar kompetencat e tij, është një kërkim që nuk mund të paraqitet në këtë lloj gjykimi, pasi ligji nr. 8577/2000 nuk e parashikon "kundërkërkesën" si mjet procedural. Kuvendi nuk ka krijuar mosmarrëveshje kompetencash, por ka ushtruar një kompetencë të parashikuar shprehimisht nga neni 90 i Kushtetutës.

27. ***Presidenti,*** në prapësimet e tij me shkrim dhe në seancë plenare, ka pretenduar se vendimi i Kuvendit është i papajtueshëm me Kushtetutën, pasi ai nuk mundet të ndërhyjë në ushtrimin e kompetencave kushtetuese nga Kryetari i Shtetit ose të vlerësojë dhe udhëzojë se si ai duhet t'i ushtrojë kompetencat e tij. Në mënyrë të përmbledhur, Presidenti ka parashtruar si vijon:

27.1 Procesi i zhvilluar nga Kuvendi është antikushtetues, pasi që nga paraqitja e kërkesës, njoftimi, vlerësimi, ngritja dhe funksionimi i komisionit hetimor parlamentar janë cenuar rëndë parimet e funksionimit të demokracisë, parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve dhe të procesit të rregullt ligjor. Vendimet e marra nga Kuvendi dhe strukturat e tij janë produkt i një veprimtarie të kryer në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, prandaj duhet të deklarohen të papajtueshme me Kushtetutën dhe të shfuqizohen nga Gjykata.

27.2 Procesi ka qenë fiktiv, pasi Kuvendi ka ngritur një komision hetimor pa objekt, pa identifikuar shkeljen e ndonjë dispozite kushtetuese ose kryerjen e ndonjë krimi të rëndë. Ngritja e këtij komisioni hetimor parlamentar nuk përputhet me funksionin dhe qëllimet e kontrollit parlamentar, të përcaktuara në nenin 77 të Kushtetutës.

27.3 Komisioni hetimor është ngritur dhe ka funksionuar përtej afateve dhe procedurave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji për komisionet hetimore, çka i bën të pavlefshme aktet e tij. Veprimtaria hetimore parlamentare dhe vendimmarrja për miratimin e rezultateve të saj është realizuar brenda periudhës fundore-tranzitore 4-mujore të përfundimit të mandatit të Kuvendit. Sipas Kushtetutës dhe ligjit gjatë kësaj

periudhe veprimtaria e Kuvendit kufizohet dhe ai nuk mund të kryejë asnjë lloj veprimtarie hetimore parlamentare, aq më tepër procedurë për shkarkimin e Presidentit. Edhe për shkak të mungesës së opozitës në Kuvend, ai nuk gëzonte legjitimitet për të ngritur komision hetimor dhe kryer veprimtari hetimore.

27.4 Procedurat parlamentare të ndjekura nga Kuvendi janë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe parashikimet e Rregullores së Kuvendit dhe në shkelje të parimit kushtetues të procesit të rregullt ligjor. Njoftimi i parë i Komisionit të Ligjeve i dërguar më 4.5.2021, pa lëndë, pa shkak dhe pa objekt, në mënyrë aspak të denjë për rëndësinë e çështjes që do të trajtonte, u dërgua në atë datë, mënyrë dhe urgjencë për të mos tërhequr vëmendjen e Institucionit të Presidentit ose vetë Presidentit, duke shpresuar në mosreagimin ndaj tij. Pavarësisht gatishmërisë dhe kërkesës së Presidentit për të qenë i pranishëm në seancë dëgjimore dhe për t'u dëgjuar në lidhje me kërkesën e deputetëve për shkarkim, kërkesa për zhvillimin e saj në datën 10.5.2021 nuk u mor parasysh. Kuvendi u njoftua se Presidenti në datën 6.5.2021 do të priste dhe realizonte takime me përfaqësues shumë të lartë shtetesh, për të cilat ishte planifikuar edhe agjenda zyrtare nga Protokolli i Shtetit, pra ishte në pamundësi objektive për të qenë i pranishëm në dëgjesën e Komisionit të Ligjeve në atë datë.

27.5 Ky komision, në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin dhe Rregulloren e Kuvendit, hartoi nxitimthi raportin e datës 6.5.2021, duke rekomanduar ngritjen e komisionit hetimor, ndërkohë që Kuvendi e dinte se ishte e pamundur të ngrinte komision hetimor e jo më të funksiononte apo të kryente proces hetimor ndaj Presidentit.

27.6 Mbledhja e Kuvendit në seancën plenare të datës 7.5.2021 dhe përcaktimi i rendit të ditës të kësaj seance është bërë në zbatim të urdhrit nr. 19, datë 6.5.2021 të Kryetarit të Kuvendit, në kundërshtim me nenet 27, pika 5 dhe 27/1, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, sipas të cilit përcaktimi i rendit të ditës nuk mund të bëhet më vonë se 48 orë përpara zhvillimit të seancës së planifikuar. Miratimi i raportit në seancën plenare është bërë në shkelje të pikës 3 të nenit 112 të Rregullores së Kuvendit. Raporti i Komisionit të Ligjeve u shqyrtua ditën e nesërme në seancë plenare, çka provon se asnjë deputet nuk ka pasur kohën e mjaftueshme të njihet me të, pasi koha nga miratimi i raportit prej komisionit deri në shqyrtimin në seancë është *de facto* më pak se 24 orë.

27.7 Po ashtu, është vepruar në kundërshtim me nenin 31 të Rregullores së Kuvendit, i cili përcakton procedurën e ndryshimit të rendit të ditës së seancës plenare. Ngritja e komisionit hetimor nuk ishte përcaktuar në rendin e ditës të caktuar nga Kryetari i Kuvendit dhe nga shqyrtimi i praktikës parlamentare nuk rezulton të jetë paraqitur ose shqyrtuar kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës.

27.8 Në seancën plenare të datës 7.5.2021 janë shkelur kërkesat e nenit 112, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, që përcaktojnë detyrimin e Kuvendit për të dëgjuar Presidentin.

27.9 Në thelb, procesi hetimor është motivuar nga hakmarrja politike e shumicës ndaj Kryetarit të Shtetit për të gjitha përpjekjet që ai ka bërë për ta frenuar në veprimtarinë e saj antikushtetuese gjatë periudhës 2019–2021. Qëllimi i kësaj veprimtarie hetimore parlamentare është qartazi paralizimi i veprimtarisë kushtetuese të Presidentit, përmes ndërhyrjes në ushtrimin e kompetencave të tij e duke krijuar një konflikt/mosmarrëveshje të re kushtetuese midis dy organeve (Kuvend-President). Kuvendi ka shkelur parimin e ndarjes së pushteteve dhe është sjellë si një super organ i pushtetit të shtetit, duke konsideruar se ka të drejtë të ushtrojë kontroll dhe të vlerësojë veprimtarinë e Presidentit në lidhje me: procesin kushtetues të vlerësimit dhe dekretimit për shpalljen ose kthimin e ligjeve; procesin e dhënies së shtetësisë shqiptare; procesin e dhënies së titujve/dekoratave; mënyrën se si përcjell Presidenti mesazhet e tij; mënyrën e ushtrimit të kompetencës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare; veprimtaritë protokollare, vizitat, takimet e organizuara nga Institucioni i Presidentit me individë, institucione ose subjekte të ndryshme, ku Presidenti ka qenë i pranishëm.

27.10 Përgjatë gjithë veprimtarisë së tij në ushtrim të funksionit dhe rolit kushtetues, Presidenti ka bërë të gjitha përpjekjet për krijimin e një klime të konkurrimit të ndershëm politik me pjesëmarrjen e të gjithë spektrit politik në

zgjedhjet e datës 25.4.2021; për të ruajtur balancat dhe klimën konsensuale ndërmjet palëve në këtë proces zgjedhor, ndërkohë që institucionet e tjera rezultuan se nuk vepruan në kohë për të parandaluar dhe ndëshkuar krimet zgjedhore; për të ndërgjegjësuar të gjithë që të denonconin çdo veprim të kundërligjshëm që cenonte të drejtën e votës me qëllim ruajtjen e legjitimitetit të procesit zgjedhor dhe njohjen e rezultatit që do të dilte nga një proces zgjedhor i lirë, i ndershëm, i pandikuar dhe demokratik; për të kundërshtuar çdo veprimtari të shumicës për kapjen e shtetit dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë prej saj; për të ruajtur të pacenuar integritetin e vendit, interesat kombëtare të shqiptarëve kudo ndodhen, interesat e shtetit dhe të shtetasve nga ndërhyrjet, veprimet ose vendimmarrjet në kundërshtim me Kushtetutën të shumicës qeverisëse. Presidenti ka përcjellë pranë institucioneve ligjzbatuese, prokurorisë, si dhe partnerëve ndërkombëtarë çdo informacion të administruar për veprime ose fenomene që mund të përbënin krime apo shkelje të rregullave zgjedhore.

27.11 Qëndrimet e Presidentit bazohen në kontekstin e zhvillimeve politike-shoqërore përgjatë Legjislaturës IX të Kuvendit, që përfshijnë: shkeljet e konstatuara gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të datës 25.6.2017; zhvillimet në vend lidhur me krimet zgjedhore; dorëzimin në bllok të mandateve nga deputetët e opozitës; procedurën antikushtetuese dhe antiligjore për zëvendësimin e menjëhershëm të tyre; përbërjen e Kuvendit me 122 deputetë, pasi 18 mandate mbetën të paplotësuara për shkak të shterimit të listave shumëemërore të kandidatëve; zhvillimin e zgjedhjeve vendore të vitit 2019 pa pjesëmarrjen e opozitës dhe pa garë, pa mundësi zgjedhjeje dhe alternativash konkurruese, e konstatuar edhe nga OSBE/ODIHR-i; mungesën e funksionalitetit të Gjykatës Kushtetuese në atë kohë, për rrjedhojë Presidenti mbeti i vetmi institucion kushtetues funksional që kishte përgjegjësinë dhe mundësinë për të ndërhyrë me qëllim ruajtjen e unitetit të popullit dhe pluralizmit politik; miratimin e rezolutës së datës 13.6.2019 nga Kuvendi dhe ngritjen e komisionit hetimor; bllokimin e KED-së nga shumica qeverisëse për periudhën 2017-2018, me qëllim që të mos plotësoheshin vendet bosh në Gjykatën Kushtetuese; denoncimet publike të vazhduara dhe ato në Prokurorinë e Posaçme ndaj kryetarit të KED-së, ministres së Drejtësisë dhe disa funksionarëve të tjerë; miratimin nga Kuvendi të rezolutës së datës 15.11.2019, ku i kërkonte Gjykatës Kushtetuese të mos respektonte dekretin e Presidentit për emërimin e anëtarëve të saj dhe zgjerimi i objektit të veprimtarisë së komisionit hetimor, i shoqëruar me një propozim për disa ndryshime në ligjin nr. 8577/2000 për procedurën e betimit të gjyqtarit kushtetues; krijimin e kuorumit të nevojshëm për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në fund të dhjetorit 2020; miratimin e ligjeve të kthyera nga Presidenti; prishjen e marrëveshjes politike të datës 5.6.2020 dhe miratimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor në datën 5.10.2020 në mënyrë të njëanshme dhe pa konsensus gjithëpërfshirës; procedurën dhe shkeljet në veprimtarinë e Kuvendit përgjatë kësaj legjislature.

27.12 Veprimtaria e Presidentit përgjatë kësaj periudhe, veçanërisht gjatë procesit zgjedhor të zhvilluar më 25.4.2021, ka synuar: ruajtjen e dialogut të qëndrueshëm midis forcave politike; sensibilizimin dhe/ose trajtimin e çdo fakti ose rrethane që lidhej me përmirësimin e kushteve për respektimin e barazisë së votës; heqjen e çdo pengese për të marrë pjesë në votime; denoncimin e ndërhyrjeve të paligjshme në procesin zgjedhor; denoncimin e çdo veprimtarie të ndaluar përgjatë procesit parazgjedhor; denoncimin e çdo veprimi që përbënte krim zgjedhor, me qëllim mbrojtjen dhe respektimin e parimeve kushtetuese dhe ruajtjen e integritetit të këtij procesi.

27.13 Legjislaturës IX i ka përfunduar mandati më 9.9.2021 dhe Legjislatura X ka filluar ushtrimin e mandatit në datën 10.9.2021, ora 10:00, me përbërje dhe përfaqësim politik sipas vullnetit të shprehur në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25.4.2021. Kuvendi ka paraqitur pretendime shtesë të nënshkruara nga Kryetarja e re e tij, zonja Lindita Nikolla, pa i shoqëruar me ndonjë akt për të provuar mënyrën e formalizimit të tyre.

27.14 Edhe pse është njohur me prapësimet e Presidentit që në datën 7.7.2021, Kuvendi nuk ka paraqitur asnjë material, pretendim ose qëndrim deri në datën 9.9.2021, që përkon edhe me

përfundimin e mandatit të tij. Kuvendi nuk e shfrytëzoi këtë mundësi, por e humbi përfundimisht atë, pasi Gjykata nuk arriti ta shqyrtonte kërkesën deri në datën që atij i përfundoi mandati. Kuvendi ka shkelur edhe afatin e caktuar nga Gjykata, datën 5.11.2021, për paraqitjen e argumenteve shtesë. Legjitimimi i shkeljes së afateve të vendosura prej Gjykatës do ta vendoste Presidentin në pozita të pabarabarta në këtë gjykim.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për përjashtimin e gjyqtarëve

28. Përfaqësuesit e Presidentit në seancën plenare të datës 1.2.2022 kanë parashtruar kërkesë paraprake për përjashtimin e gjyqtarëve nga gjykimi i kësaj çështjeje, bazuar në këto shkaqe:

28.1 Gjykata përbëhet nga 7 gjyqtarë, 6 prej të cilëve janë zgjedhur nga institucionet e përfshira në konflikt, ndërsa Kryetarja është zgjedhur nga të dyja këto organe. Gjykata u bë funksionale me 7 gjyqtarë vetëm në fund të muajit dhjetor 2020, proces gjatë të cilit organet e emërtesës nuk ushtruan në mënyrë të plotë të drejtën për të zgjedhur ndërmjet tre kandidatëve, për shkak të mungesës së këtyre të fundit.

28.2 Kryetarja është duke ushtruar detyrën përtej mandatit kushtetues, në pritje të gjyqtarit pasardhës. Edhe pse Kushtetuta lë hapësirë për qëndrimin në detyrë të gjyqtarit kushtetues deri sa të zëvendësohet, ajo nuk mund të shfrytëzohet pa kufi. Sipas ligjit nr. 8577/2000 procedurat për emërimin e gjyqtarit pasardhës duhet të përfundojnë para mbarimit të mandatit të gjyqtarit në detyrë, ndërkohë që Kryetarja ka konsumuar më shumë se gjysmën e mandatit të gjyqtarit të ri. Kjo bie në kundërshtim me qëllimin e normës kushtetuese dhe vë në dyshim pavarësinë, si dhe paanshmërinë e gjyqtarit kushtetues. Gjithashtu, Kryetarja është propozuar nga Presidenti në datën 5.11.2018 si kandidate për Kryetare të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por propozimi nuk u pranua nga Kuvendi me argumentin se largimi i saj do të bllokonte veprimtarinë e Gjykatës.

28.3 Tre gjyqtare janë emëruar në nëntor të vitit 2019 (dy nga Legjislatura IX e Kuvendit dhe një nga Presidenti), pra në periudhën kur në marrëdhëniet mes këtyre organeve ka pasur tension e konflikt, të shkaktuara nga shumica qeverisëse, që kanë çuar deri në hetimin e Presidentit për shkak të këtij emërimi. Për këtë arsye, emërimi i gjyqtarëve kushtetues nga këto dy organe nuk është ideal për të siguruar pavarësinë e tyre.

28.4 Presidenti i ka përcjellë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të dhëna dhe prova të mjaftueshme për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit relator në çështjen e zgjedhjeve vendore të vitit 2019, të cilat lidhen me procedurën e shortit të ndjekur nga Gjykata për caktimin e relatorit, si dhe dokumentimin e kësaj procedure e të pyetjeve drejtuar Komisionit të Venecies. Ky hetim mund të shtrihet edhe ndaj gjyqtarëve të tjerë kushtetues.

28.5 Për dy gjyqtarë të tjerë Gjykata ka deklaruar përfundimin e mandateve të tyre, respektivisht në datat 8.4.2022 dhe 2.5.2022, dhe organet e emërtesës kanë shpallur hapjen e procedurave të aplikimit për këto vakanca. Njëri prej tyre në datën 24.12.2021 ka publikuar një shkrim në një media elektronike, disa paragrafë të të cilit ngrenë dyshime për paanshmërinë e tij, pasi vlerësohen si thirrje për Kuvendin për të shqyrtuar mundësinë e zgjatjes së mandatit në kohën që ky organ ka në procedurë parlamentare disa ndryshime kushtetuese.

28.6. Vendimi nr. 55/2021 i Kuvendit është depozituar në Gjykatë në datën 14.6.2021 dhe shqyrtimi paraprak është përfunduar në datën 15.10.2021, pra tej afatit 3-mujor të parashikuar nga nenet 47, pika 1 dhe 62, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000. Sipas vendimit nr. 8, datë 28.7.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, për çështjen konkrete nuk ka pasur vendim pezullimi të posaçëm, por vetëm një vendim të përgjithshëm me efekt për të gjitha dosjet në shqyrtim në Gjykatë. Përmes këtij vendimi Gjykata duket se ka krijuar një normë të re që lidhet me kryerjen e lejes vjetore, të pambështetur në ligjin nr. 8577/2000, me qëllim ndërprerjen e ecjes së afateve, duke marrë atributet e ligjvënësit. Ky vendim nuk është botuar dhe nuk u është komunikuar palëve në këtë gjykim, për pasojë nuk ka vlerë juridike dhe nuk mund të ketë efekt pezullimi për çështjen në proces.

28.7. Caktimi i gjyqtarit relator në çështjen në shqyrtim është bërë pa u respektuar procedura e parashikuar në nenin 27, pika 6, të ligjit nr. 8577/2000.

29. Sipas Kuvendit, kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve është e pabazuar, pasi nuk ekziston asnjë prej shkaqeve që parashikon ligji organik i Gjykatës, por nëpërmjet saj synohet të shtyhet ky proces e të orientohet drejt diskutimeve procedurale. Pretendimet për mbarimin e mandatit janë të pabazuara dhe Gjykata ka praktikë të konsoliduar në lidhje me vlefshmërinë e mandateve të gjyqtarëve referuar natyrës së punës dhe kompetencave të tyre. Kërkesa paraprake për përjashtimin e gjyqtares ndaj së cilës është kërkuar fillimi i procedimit disiplinor është abuzive. Sipas dispozitave kushtetuese që rregullojnë procedurat disiplinore të anëtarëve të Gjykatës, organi që e kryen këtë procedurë është Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe nuk ka asnjë informacion që ky procedim të ketë filluar. Për më tepër, pretendimet e Presidentit kanë të bëjnë me një proces tjetër që nuk ka lidhje me atë në shqyrtim. Për sa u përket pretendimeve që lidhen me shortin ose me afatin 3-mujor, këto çështje janë rregulluar në mënyrë të qartë në parashikimet e ligjit organik të Gjykatës. Afati i parashikuar në nenin 47 të këtij ligji është organizativ dhe jo prekluziv, ndaj ai nuk prodhon ndonjë pasojë. Kalimi i këtij afati nuk ka ndonjë ndikim në proces dhe në këtë rast i vetmi pretendim që mund të kërkohej do të ishte e drejta e dëmshpërblimit financiar, sipas nenit 71/c të ligjit nr. 8577/2000. Duke qenë në një gjykim të posaçëm, afati organizativ nuk mund të prevalojë mbi qëllimin e vërtetë të këtij lloj gjykimi, që në fokus kryesor ka rëndësinë e çështjes, kompleksitetin e saj, gjykimin e drejtë, dhënien kohë palëve të njihen me pretendimet dhe dhënien kohë Gjykatës që të shqyrtojë çështjen. Edhe shkaqet e tjera, si shprehja e opinioneve, botimet ose qëndrimet e caktuara të gjyqtarëve në kuadër të veprimtarisë së tyre, nuk qëndrojnë dhe nuk gjejnë mbështetje në nenet 36 dhe 37, të ligjit nr. 8577/2000.

30. Gjykata, pasi mori në shqyrtim veçmas secilën kërkesë për përjashtim, vendosi rrëzimin e tyre dhe në kushtet kur shumica e pretendimeve janë të njëjta për secilin gjyqtar, vlerëson t'u japë atyre përgjigje në mënyrë të përbashkët.

31. Gjykata thekson, së pari, se bazuar në nenin 124, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 ajo gëzon pavarësi të plotë organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të caktuara në Kushtetutë dhe ligjin organik. Kjo pavarësi nuk është thjesht një privilegj, por një prerogativë e vërtetë dhe e domosdoshme, e cila i jep më shumë siguri, qëndrueshmëri dhe efikasitet në ushtrimin e detyrave të saj si organ kushtetues *(shih vendimet 9, datë 1.3.2021; nr. 19, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Pavarësia organizative, si një prej elementeve të qenësishme të pavarësisë së Gjykatës, gjen shprehje edhe në të drejtën për të hartuar e caktuar vetë, veç të tjerash, edhe rregullat e brendshme të organizimit e funksionimit, strukturën dhe organikën e saj. Në këtë kuptim, ligji nr. 8577/2000, në nenin 13, shkronja "d", i ka njohur të drejtën Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës që të miratojë rregullat e brendshme për procedurat gjyqësore të gjykimit kushtetues dhe të veprimtarisë së administratës së saj. Bazuar në këto parashikime, Gjykata ka kompetencë të gjerë vetërregulluese në drejtim të rregullave procedurale, ku përfshihen rregullat për shqyrtimin e çështjeve dhe ndarjen e tyre me short, si dhe procesi i shqyrtimit/vendimmarrjes. Për rrjedhojë, në qoftë se nuk provohet shkelja e standardeve kushtetuese për nga mënyra se si është rregulluar ose zbatuar procedura e gjykimit kushtetues, asnjë institucion nuk mund të ndërhyjë ose të vërë në dyshim legjitimitetin e vendimmarrjes për çështje që bien brenda fushës së kompetencës vetërregulluese të Gjykatës.

32. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet për përjashtimin e gjyqtarëve kushtetues për shkak të mënyrës së organizimit të shortit, afateve për shqyrtimin paraprak të çështjes dhe vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për ndërprerjen e afateve procedurale gjatë lejes vjetore, për të cilën neni 18, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 përcakton shprehimisht se bëhet gjatë muajve gusht-shtator, në thelb, kanë të bëjnë me mënyrën se si Gjykata e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me parimin e pavarësisë organizative.

33. Gjykata thekson se, në parim, caktimi i gjyqtarit relator në gjykimin e kësaj çështjeje nuk

ndikon në pavarësinë e Gjykatës, pasi në ndryshim nga procedurat e tjera, për shkak të natyrës së veçantë të çështjes dhe të këtij lloj gjykimi, ligji ka parashikuar se në çdo fazë të saj, përfshirë shqyrtimin paraprak, ajo shqyrtohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve. Megjithatë, në çështjen në shqyrtim, për caktimin e gjyqtarit relator janë ndjekur kriteret dhe zbatuar rregullat në fuqi në kohën e regjistrimit të kërkesës, të njëjta me ato të rasteve të tjera, duke pasur parasysh vjetërsinë e gjyqtarëve në detyrë, fushën e ekspertizës së secilit, ngarkesën e çështjeve.

34. Në lidhje me pretendimet për mënyrën e emërimit të gjashtë gjyqtarëve të rinj kushtetues, Gjykata vlerëson se këto procedura janë kryer në përputhje me formulën kushtetuese të parashikuar në nenin 125 të Kushtetutës, sipas ndryshimeve kushtetuese të miratuara në vitin 2016, zbërthyer më tej në dispozitat e ligjit nr. 8577/2000.

35. Për sa i takon pretendimit për përjashtimin e Kryetares së Gjykatës për shkak të kohës së qëndrimit të saj në detyrë përtej mandatit kushtetues, Gjykata vëren se neni 125, pika 7, i Kushtetutës në mënyrë të shprehur ka parashikuar qëndrimin në detyrë të gjyqtarit kushtetues deri në zgjedhjen e gjyqtarit pasardhës. Funksionimi i një organi kushtetues, siç është Gjykata Kushtetuese, ka rëndësi, pasi ajo shërben për respektimin e shtetit të së drejtës. Ky rregull ka për qëllim garantimin, mbi të gjitha, të funksionimit normal të Gjykatës në rast të krijimit të vendeve vakante si pasojë e mosveprimit të ndonjërit prej organeve, të cilave Kushtetuta u njeh një rol të veçantë në këtë moment për zëvendësimin e gjyqtarëve të vjetër me gjyqtarë të rinj. Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim do të kishte pasoja në funksionimin e Gjykatës (*shih vendimet nr. 55, datë 27.7.2016; nr. 24, datë 9.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, Gjykata vlerëson se qëndrimi në detyrë i gjyqtarit kushtetues është në përputhje me dispozitat kushtetuese në fuqi dhe jurisprudencën kushtetuese, të cilat synojnë të garantojnë vazhdimësinë institucionale dhe ushtrimin e funksioneve, me qëllim mbrojtjen e vlerave dhe parimeve që qëndrojnë në themel të shtetit të së drejtës.

36. Në lidhje me pretendimin për kërkesën e Presidentit për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit relator në gjykimin kushtetues për zgjedhjet vendore të vitit 2019, që, sipas tij, mund të shtrihet edhe ndaj gjyqtarëve të tjerë kushtetues, Gjykata vlerëson se, në thelb, edhe ky shkak ka të bëjë me pavarësinë organizative të saj. Nga ana tjetër, kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor, edhe kur bëhet nga një institucion shtetëror, siç është në këtë rast Presidenti, nuk përbën shkak për përjashtimin e gjyqtarit nga shqyrtimi i çështjes, për sa kohë që nuk ka filluar procedim disiplinor ndaj gjyqtarit kushtetues.

37. Për sa i përket pretendimit se për dy gjyqtarë është deklaruar me vendim mbarimi i mandatit dhe janë shpallur vakancat nga organet e emërtesës, bazuar edhe në arsyetimin e mësipërm, Gjykata thekson se këta gjyqtarë janë duke ushtruar veprimtarinë brenda mandatit të tyre kushtetues, sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000. Kurse në lidhje me pretendimin se njëri nga këta gjyqtarë ka bërë disa deklarime në një artikull të botuar në median elektronike, nga përmbajtja e këtij shkrimi nuk rezulton që ai të ketë shprehur ndonjë qëndrim publik në lidhje me çështjen në shqyrtim, që, në kuptim të nenit 36 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vinte në dyshim paanshmërinë e tij. Gjykata ka vendosur mbarimin e mandatit të këtij gjyqtari në datën 8.4.2022 dhe ka njoftuar organin e emërtesës, Presidentin, i cili ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimit për këtë vend vakant dhe Kuvendi nuk ka ndërmarrë ndonjë nismë në lidhje me ndryshimin e Kushtetutës për zgjatjen e mandatit në fjalë.

38. Bazuar në argumentet e mësipërme, në kushtet kur asnjë nga pretendimet e parashtruara nga Presidenti nuk është i tillë që të vërë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve kushtetues, Gjykata vlerëson se asnjëri prej tyre nuk ka pengesë ligjore për të shqyrtuar dhe vendosur për çështjen objekt gjykimi.

B. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

39. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit ajo zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe i

nënshtrohet vetëm kësaj të fundit. Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është ndër funksionet më të rëndësishme të kësaj Gjykate, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 36, datë 4.11.2021; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Një prej çështjeve që shqyrton Gjykata, bazuar edhe në normat e tjera kushtetuese, është shkarkimi i Presidentit, i cili renditet në shkronjën "dh" të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës dhe gjen rregullim të posaçëm në nenin 90 të saj. Kjo dispozitë në pikën 1 të saj përcakton se Presidenti nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij, kurse në pikën 2 se ai mund të shkarkohet nga Kuvendi për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Në këtë rast, propozimi për shkarkim mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij. Vendimi i Kuvendit i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, e cila sipas pikës 3 të nenit 90, kur vërteton fajësinë e Presidentit, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.

41. Dispozitat kushtetuese për kompetencën e Gjykatës për të vendosur për shkarkimin e Presidentit janë zbërthyer më tej në parashikimet e ligjit organik, nenet 61–63 të tij. Më konkretisht, sipas nenit 61 të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vihet në lëvizje me vendimin e Kuvendit që ka vendosur shkarkimin nga detyra të Presidentit, i cili duhet të përmbajë një përshkrim të argumentuar të shkeljes së rëndë të Kushtetutës ose të krimit të rëndë, si dhe të shoqërohet me provat përkatëse. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se në rast se Kuvendi merr vendim për shkarkimin e Presidentit, ka detyrimin ta dërgojë atë në Gjykatë dhe është pikërisht ky vendim që shërben për fillimin e gjykimit kushtetues.

42. Neni 62, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se kalimi i çështjes në seancë plenare vendoset me shumicën e të gjithë anëtarëve të Gjykatës. Seanca plenare është publike dhe në të ftohet të marrë pjesë Presidenti, i cili mund të përfaqësohet nga një mbrojtës i zgjedhur, Kuvendi dhe, nëse është rasti, edhe persona të tjerë të thirrur nga Gjykata (pika 2). Mungesa në seancë plenare e Presidentit ose përfaqësuesit të tij pa arsye, nuk përbën shkak për moszhvillimin e gjykimit (pika 3). Sipas nenit 63, pika 3, dorëheqja e Presidentit nga detyra ose përfundimi i mandatit të tij, pas fillimit të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit të çështjes. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata deklaron shkarkimin e Presidentit nga detyra nëse arrin në përfundimin se ka shkelur rëndë Kushtetutën ose ka kryer një krim të rëndë, ndërsa kur nuk arrin në përfundimin se Presidenti ka shkelur rëndë Kushtetutën ose ka kryer një krim të rëndë, ajo vendos shfuqizimin e vendimit të Kuvendit (pikat 1 dhe 2 të nenit 63).

43. Kushtetuta ka parashikuar vetëm dy organe që kanë kompetenca të përcaktuara në procedurën e shkarkimit: Kuvendin, si inicues i saj dhe Gjykatën, që vërteton përfundimisht (pa)fajësinë e Presidentit. Në këtë kuptim, duke iu referuar organit kompetent, procedura e shkarkimit zhvillohet në dy faza me natyrë të ndryshme, në atë parlamentare dhe në gjykimin kushtetues.

44. Për sa i përket së drejtës së Kuvendit për të vendosur për shkeljet e kryera nga Presidenti, kjo kompetencë lidhet me një nga funksionet e këtij organi, atë të kontrollit parlamentar, që nënkupton si kusht *sine qua non* për realizimin efektiv të tij, dhe të drejtën e marrjes së sanksioneve, duke mos përjashtuar edhe shkarkimin nga detyra. Përndryshe roli i Kuvendit, organ i vetëm ligjvënës dhe mbajtës i sovranitetit, do të mbetej ai i një vëzhguesi përpara një gjendjeje të krijuar, me pasoja të rënda për shtetin dhe shoqërinë (*shih vendimin nr. 12, datë 28.10.1992, të Gjykatës Kushtetuese*). Në parim, për shkak të pozicionit kushtetues të Kuvendit, si organi përfaqësues i popullit, kontrolli parlamentar i referohet gjithë aktivitetit shtetëror dhe të gjitha autoriteteve publike. Por, një kompetencë e tillë nuk e transformon Kuvendin në një super organ shtetëror dhe kontrolli parlamentar nuk mund të përdoret tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i ka njohur atij. Një interpretim ndryshe i kësaj kompetence kontrolli do të çonte në mohimin e parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve *(shih vendimet nr.*

22, datë 5.5.2010; nr. 20, datë 4.5.2007; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese).

45. Funksioni që kryen Kuvendi në rastet e verifikimit të shkaqeve për shkarkim të funksionarëve të lartë ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si organ që miraton ligje. Kontrolli në rastet e shqyrtimit të këtyre shkeljeve është i ngjashëm me procedurat hetimore administrative, i cili ka parimet e veta, që lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e shkaqeve konkrete që kanë shërbyer për të marrë masën e shkarkimit. Megjithatë, Kuvendi në një procedurë shkarkimi nuk ushtron pushtet gjyqësor, por një pushtet tjetër e të ndryshëm, që në mënyrë ekskluzive i është deleguar atij (*shih vendimet nr. 21, datë 1.10.2008; nr. 75, datë 19.4.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në përputhje me parimet e gjykimit kushtetues, i gjithë procesi i zhvilluar nga Kuvendi, si institucion i natyrës politike, kontrollohet nga Gjykata, si organ i veshur me pushtet gjyqësor, që ka kompetencën ekskluzive për të deklaruar përfundimisht shkarkimin kur vërteton se veprimet ose mosveprimet e Presidentit, të kryera me faj, përbëjnë shkelje të rënda të Kushtetutës ose krim të rëndë. Gjykimi kushtetues i shkarkimit është garanci juridike që përgjegjësia kushtetuese e Presidentit të mos përcaktohet nën efektin dhe ndikimin e shumicave politike, bazuar në argumente politike ose arbitrare. Në këtë mënyrë, gjykimi kushtetues përbën instrumentin vendimmarrës në kuadrin e dualitetit të procesit politiko-juridik që shoqëron, si rregull, procesin e shkarkimit nga detyra të Presidentit.

47. Gjykata thekson se në këtë lloj gjykimi ajo ushtron kontroll konkret dhe zgjidh një mosmarrëveshje kushtetuese, në kuptim të neneve 124 dhe 90 të Kushtetutës, midis Kuvendit, në rolin e organit kushtetues që ka ushtruar funksionin parlamentar të kontrollit, nga njëra anë, dhe Presidentit, organ kushtetues për të cilin vihet në dyshim përmbushja e rolit të përcaktuar nga Kushtetuta, nga ana tjetër.

48. Për sa u takon kufijve të shqyrtimit të çështjes, në kushtet kur neni 90, pika 3, i Kushtetutës i jep kompetencën për të deklaruar shkarkimin e Presidentit nga detyra, pas shqyrtimit të vendimit të Kuvendit, i cili zhvillon një proces parlamentar *impeachment* të natyrës kushtetuese dhe politike, Gjykata kontrollon procedurën e ndjekur nga Kuvendi, shkaqet e shkarkimit dhe fajësinë e Presidentit. Në këtë lloj gjykimi ajo ka në objekt verifikimin e fakteve të cilat i ngarkohen Presidentit, nëse ato përbëjnë shkelje të rëndë kushtetuese ose krim të rëndë sipas nenit 90, pika 2, të Kushtetutës, por edhe vërtetimin e fajësisë së Presidentit në kryerjen e tyre sipas nenit 90, pika 3, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në këtë lloj gjykimi, Gjykata merr në shqyrtim prova, jo vetëm ato që detyrimisht duhet t'i bashkëngjiten vendimit të Kuvendit për shkarkim, sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, por edhe ato që paraqiten nga vetë Presidenti për të mbështetur prapësimet e tij, si dhe çdo provë tjetër që ajo e çmon të nevojshme.

49. Gjykata është e kufizuar në shkaqet e shkarkimit të deklaruara në vendimin e Kuvendit, prandaj asnjë shkak tjetër për shkarkim, përveç atyre të përcaktuara në të, nuk përfshihet në objektin e çështjes që shqyrtohet në procedurën e gjykimit të shkarkimit. Nga ana tjetër, Gjykata nuk është e detyruar të bazohet në "përcaktimin juridik" të shkeljes së pretenduar në vendimin e Kuvendit për shkarkim, por ajo mund t`i përcaktojë faktet që kanë çuar në shkarkim bazuar në dispozita kushtetuese të ndryshme nga ato të referuara prej Kuvendit. Me të njëjtin arsyetim, Gjykata nuk është e detyruar të ndjekë të njëjtën strukturë të shkaqeve të shkarkimit, që ka ndërtuar dhe përdorur Kuvendi në vendimin e tij të shkarkimit.

C. Për legjitimimin e Kuvendit

50. Gjykata vëren se shkarkimi i Presidentit është vendosur nga Legjislatura IX dhe çështja në shqyrtim është regjistruar në Gjykatë në datën 14.6.2021, në bazë të vendimit nr. 55/2021 të Kuvendit, të paraqitur nga Kryetari i asaj legjislature. Pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të datës 25.4.2021, në datën 10.9.2021 ka filluar mandati i Legjislaturës X dhe gjatë kohës në të cilën gjykimi kushtetues ishte në proces, Kuvendi ka paraqitur parashtrime në lidhje me këtë gjykim kushtetues të nënshkruara nga Kryetarja e re e tij.

51. Në këto rrethana, Presidenti ka ngritur pretendime si për legjitimimin formal të Legjislaturës X, ashtu edhe legjitimitetin substancial të Legjislaturës IX të Kuvendit.

C.1. Për legjitimimin formal të Kuvendit

52. Presidenti ka parashtruar se për sa kohë Legjislatura IX nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim deri në datën 9.9.2021, që shënonte përfundimin e mandatit të saj, ajo e ka humbur përfundimisht këtë mundësi. Po ashtu, sipas tij, nuk provohet se si janë formalizuar parashtrimet shtesë të nënshkruara nga Kryetarja e Legjislaturës X, të paraqitura pas datës 9.9.2021, të cilat, për më tepër, janë paraqitur përtej afatit të caktuar nga Gjykata.

53. Sipas Kuvendit, në përputhje me parimin e vazhdimësisë institucionale, vendimet e miratuara nga legjislatura e mëparshme nuk e humbasin fuqinë e tyre juridike, përveç rasteve kur ka një procedurë parlamentare ose një proces tjetër ligjor që ka ndryshuar një akt të caktuar. Materiali i titulluar "Parashtrime shtesë" nuk është vendimmarrje e re e këtij organi, por një material mbrojtës për vendimmarrjen e Kuvendit të materializuar me vendimin nr. 55/2021, objekt i këtij gjykimi. Në përputhje me nenin 76, pika 1, të Kushtetutës Kryetari përfaqëson Kuvendin në marrëdhënie me të tjerët, që do të thotë se përfshihet në detyrat e tij funksionale si nënshkrimi i autorizimit të përfaqësuesve, ashtu edhe i parashtrimeve shtesë.

54. Gjykata rithekson se pa ekzistencën dhe funksionimin demokratik të Kuvendit, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit, nuk është i mundur realizimi i plotë dhe pa të meta i demokracisë (*shih vendimin nr. 25, datë 24.9.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas nenit 64 të Kushtetutës Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional, me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar. Kurse sipas nenit 65, pika 1, të Kushtetutës Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet. Mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e parë të tij pas zgjedhjeve dhe përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë dhe në çdo rast ai qëndron në detyrë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri të zgjedhur. Funksionimi i pandërprerë i Kuvendit, madje edhe në rastet kur zhvillohen zgjedhjet për Kuvendin e ri, është i domosdoshëm dhe jetik për qeverisjen e vendit. Vazhdimësia institucionale formale është e garantuar pikërisht nga neni 65 i Kushtetutës, i cili e shtrin mandatin e Kuvendit deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri për të mos lejuar boshllëkun institucional. Edhe pse mandati i Kuvendit, sipas nenit 65, pika 1, të Kushtetutës, është 4 vjet, ai asnjëherë nuk pushon së ekzistuari si i tillë, pasi edhe kur i ka mbaruar ky afat quhet ende funksional deri ditën që mblidhet Kuvendi i ri. Gjykata ka vlerësuar se mandati kohor 4-vjeçar i Kuvendit lidhet me përtëritjen e përbërjes së tij periodikisht nëpërmjet zgjedhjeve të drejtpërdrejta dhe nuk ndikon në llojin e akteve që ai miraton ose shfuqizon (*shih vendimin nr. 59, datë 23.12.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Gjykata vëren se procedura parlamentare për shkarkimin nga detyra të Presidentit ka nisur dhe është përfunduar nga Legjislatura IX, e cila ka marrë vendimin për shkarkim dhe ka vënë në lëvizje edhe gjykimin kushtetues, ndërsa disa aspekte procedurale të procesit kushtetues janë kryer edhe pas përfundimit të mandatit të asaj legjislature. Gjykata, referuar normave kushtetuese dhe atyre ligjore që rregullojnë këtë lloj gjykimi, thekson: *së pari*, se në këtë gjykim zgjidhet mosmarrëveshja në të cilën njëra prej palëve është Kuvendi, si organ kushtetues që ka vendosur shkarkimin e Presidentit dhe kontrolli i Gjykatës kryhet mbi procedurën dhe aktet e miratuara nga ky organ deri në vendimmarrjen për shkarkimin e Presidentit, për rrjedhojë periudha e ushtrimit të veprimtarisë nuk ka rëndësi në këtë drejtim; *së dyti*, Gjykata kontrollon në themel procedurën dhe aktet që kanë vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, në funksion të të cilave ajo merr në shqyrtim edhe argumentet ose prapësimet e palëve në proces. Për rrjedhojë, në të tilla raste Gjykata niset nga parimi i vazhdimësisë funksionale të organit kushtetues dhe nuk vë në dyshim vullnetin e formalizuar prej tij në aktet që janë objekt i këtij gjykimi. Nuk ka ndonjë detyrim kushtetues ose ligjor sipas të cilit legjislatura vijuese e organit përfaqësues duhet të miratojë ose konfirmojë veprimtarinë ose aktet e miratuara nga legjislatura e mëparshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë parlamentare. Një qëndrim i kundërt do të cenonte dhe deformonte vullnetin e formalizuar nga Kuvendi.

56. Për sa më sipër, përfaqësimi i Legjislaturës X në këtë gjykim është bërë edhe në përputhje me parashikimet e nenit 76, pika 1, të Kushtetutës, sipas të cilit Kryetari i Kuvendit, që

sipas nenit 75, pika 1, zgjidhet nga Kuvendi, e përfaqëson atë edhe në marrëdhëniet me të tjerët, në rastin konkret para Gjykatës.

C.2. Për legjitimitetin substancial të Kuvendit

57. Presidenti ka pretenduar se Kuvendi nuk gëzonte legjitimitet për të shqyrtuar dhe vendosur për këtë çështje, për shkak të dorëzimit në bllok të mandateve nga deputetët e opozitës, çka solli një krizë përfaqësimi në parlament, duke i munguar legjitimiteti për të realizuar nisma thelbësore legjislative pa konsensusin gjithëpërfshirës të opozitës reale që ndodhej jashtë Kuvendit dhe për të ngritur komisione hetimore. Sipas Presidentit, shumica qeverisëse brenda 2 vjetësh ka filluar për të tretën herë një proces të pambështetur në Kushtetutë dhe ligje për ta hetuar atë, si i vetmi autoritet dhe organ kushtetues që i ka dalë përballë veprimeve të kësaj shumice në shkelje të Kushtetutës dhe ligjeve, për të frenuar paligjshmërinë në mbrojtje të interesit publik dhe kombëtar.

58. Sipas Kuvendit, legjitimiteti i tij nuk mund të vihet në dyshim nga dorëheqja e disa deputetëve, në kushtet kur dorëheqja është një akt individual, për rrjedhojë nuk mund të vlerësohet nga asnjë institucion, përfshirë Presidentin dhe Kuvendin. Jo vetëm që në traditën shqiptare parlamentare ka pasur raste kur organi nuk ka funksionuar me përbërje të plotë, por edhe Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR-i i kanë dhënë përgjigje kësaj çështjeje. Legjislatura IX e Kuvendit ka pasur kuorumin kushtetues të nevojshëm për miratimin e vendimit nr. 55/2021. Edhe Presidenti, me sjelljen e tij, e ka njohur legjitimitetin e këtij institucioni, pasi gjatë kësaj periudhe ka shpallur shumë ligje të miratuara nga Kuvendi dhe ka kthyer disa të tjera, por në asnjë rast nuk është përdorur si argument mungesa e legjitimitetit të tij. Në procedurat për shkarkim të zhvilluara në periudhën 2019–2020, Presidenti, i ftuar nga komisioni hetimor, është paraqitur dhe ka dhënë shpjegimet e tij, edhe pse bëhej fjalë për të njëjtin Kuvend, me të njëjtën përbërje. Presidenti, gjithashtu, po gjatë asaj legjislature ka administruar edhe betimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese të zgjedhur nga Kuvendi.

59. Gjykata vëren se Legjislatura IX e Kuvendit është konstituuar në përputhje me parashikimin kushtetues dhe përbëhej nga 140 deputetë. Pas një krize politike që pasoi me dorëzimin në muajin shkurt të vitit 2019 të mandateve nga deputetët e partive politike të opozitës dhe pas zëvendësimit të tyre me deputetë nga listat shumemërore të po atyre partive politike, në mbyllje të saj Legjislatura IX përbëhej nga 122 deputetë, ndërkohë që një pjesë e mandateve të dorëzuara mbetën të pazëvendësuara, për shkak të shterimit të listave të deputetëve zëvendësues.

60. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se demokracia përfaqësuese, e konceptuar si formë e zakonshme qeverisjeje, mundëson shfaqjen e vullnetit të shumicës në formën e një akti që do t'i shërbejë interesit të përgjithshëm (*shih vendimin nr. 31, datë 19.11.2003, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga parimi i demokracisë përfaqësuese rrjedh detyrimi i deputetit që mandatin e besuar nga zgjedhësit ta ushtrojë realisht. Vetëm duke qenë plotësisht efektiv, pra i përfaqësuar tërësisht me të gjithë anëtarët e tij, parlamenti mund të realizojë funksionin e tij demokratik. Koncepti i mandatit parlamentar përmban detyrimin e përfaqësimit real të zgjedhësve. Mandati i deputetit duhet të kuptohet, së pari, si një akt përfaqësimi individual që lidhet me deputetin si individ dhe më pas me partinë politike ku ai bën pjesë. Nëse një deputet, për arsye të ndryshme, ndalohet ose pengohet të ushtrojë funksionin e tij si pjesë e parlamentit, atëherë cenohet parimi i përfaqësimit, si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim në parlament gjatë gjithë legjislaturës (*shih vendimin nr. 44, datë 7.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se pavarësia e mandatit të deputetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, i shërben forcimit të statusit përfaqësues parlamentar, duke garantuar edhe të drejtat e pakicës parlamentare brenda sistemit të vendimmarrjes me shumicë. Deputeti është i lirë të ushtrojë funksionin e tij në mënyrën më të mirë të mundshme të zgjedhur prej tij. Nga tërësia e karakteristikave që mbart në vetvete mandati parlamentar, është e qartë se deputeti gjatë ushtrimit të detyrës së tij nuk u nënshtrohet urdhrave, ndryshe nga pjesa tjetër e punonjësve ose nëpunësve të shërbimit civil. Ai pranon në mënyrë krejtësisht të lirë mandatin e tij dhe vendos me përgjegjësinë e tij të plotë për

mënyrën e ushtrimit të mandatit. Veprimtaria e tij si deputet duhet të përshkohet gjatë gjithë kohës që ai ushtron këtë funksion nga përgjegjshmëria, ndershmëria dhe korrektesa (*shih vendimin nr. 44, datë 7.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Gjykata vlerëson se dorëzimi në bllok i mandateve parlamentare, në kuadrin e një krize besimi të ndërsjellë midis aktorëve politikë, deformon konceptin e mandatit përfaqësues dhe cenon parimin e përfaqësimit të zgjedhësve në parlament. Në këtë këndvështrim, duhet theksuar se mjedisi thellësisht i polarizuar politik, mungesa e dialogut dhe e dëshirës së aktorëve politikë për të punuar së bashku me të gjitha pjesët e shoqërisë, kthehen në faktorë që prekin cilësinë e veprimtarisë parlamentare, pengojnë realizimin e vlerave kushtetuese dhe thyejnë besimin publik, në dëm të integrimit social dhe zhvillimit kombëtar.

62. Megjithatë, në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete, për të vlerësuar legjitimitetin e Legjislaturës IX të Kuvendit, Gjykata vëren se procedura e zëvendësimit të mandateve nga listat shumemërore prej dorëzimit në bllok të tyre, si dhe vlefshmëria e mandateve zëvendësuese nuk janë kundërshtuar në rrugë institucionale nga asnjë subjekt, për rrjedhojë nuk ka ndonjë vendim administrativ të organeve shtetërore kompetente ose vendim gjyqësor që të ketë vendosur për parregullsinë e procedurave, pavlefshmërinë e mandateve ose papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të deputetëve. Me fjalë të tjera, argumenti për mungesën e legjitimitetit të Legjislaturës IX, për shkak se numri i deputetëve të Kuvendit mbeti i paplotë, mbetet në kuadrin e pretendimit të pambështetur ligjërisht.

63. Gjykata vëren se përgjatë kësaj periudhe Kuvendi ka vijuar të ushtrojë veprimtarinë parlamentare duke pasur çdo lloj kuorumi që kërkon Kushtetuta për ushtrimin e kompetencave të tij. Edhe Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR-i janë shprehur, se: "*fakti se Parlamenti nuk përbëhet nga numri i plotë i deputetëve nuk është në vetvete problematik në kuptim të standardeve ndërkombëtare, duke qenë se ai funksionon në përputhje me kuorumin e përcaktuar nga Kushtetuta*" (*shih opinionin e përbashkët CDL-AD(2020)036, datë 11.12.2020, paragrafi 12*). Gjykata mban në konsideratë, gjithashtu, edhe tërësinë e akteve të miratuara nga Legjislatura IX, ku përfshihen miratimi i disa ndryshimeve kushtetuese, miratimi i ligjeve, si dhe ngritja dhe funksionimi i komisioneve të ndryshme hetimore, akte që janë botuar, kanë hyrë në fuqi dhe kanë prodhuar edhe efekte juridike.

64. Në përfundim, duke iu referuar momentit të konstituimit të Kuvendit, procedurave për zëvendësimin e deputetëve, numrit të përgjithshëm të deputetëve në këndvështrim të kuorumit të vendimmarrjes, mungesës së vendimeve të organeve kompetente për të deklaruar parregullsinë ose pavlefshmërinë e zëvendësimit të mandateve dhe mundësisë së asaj legjislature për të arritur të gjitha kuorumet e nevojshme, si dhe tërësisë së ligjeve dhe vendimeve të miratuara, Gjykata vlerëson se edhe pse kjo situatë ka treguar një krizë përfaqësimi, që nuk përputhet me mënyrën se si ushtrohet demokracia në një shtet të së drejtës, Legjislatura IX e Kuvendit ka pasur legjitimitet substancial.

C.3. Për afatin e paraqitjes së kërkesës dhe të shqyrtimit paraprak të çështjes

65. Në lidhje me afatin e paraqitjes së kërkesës, Gjykata vëren se vendimi i Kuvendit, objekt shqyrtimi, është marrë në datën 9.6.2021 dhe i është dërguar kësaj Gjykate nga Kryetari i Kuvendit në datën 14.6.2021, pra brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 112, pika 4, paragrafi i fundit, i Rregullores së Kuvendit, prandaj Kuvendi legjitimohet edhe në këtë drejtim.

66. Për sa i takon pretendimit të Presidentit për mosshqyrtimin e kësaj çështjeje nga Gjykata brenda afatit të mbarimit të Legjislaturës IX, që përkon me afatin e parashikuar nga neni 47, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, Gjykata thekson se afati 3-mujor lidhet me shqyrtimin paraprak të çështjes, jo me themelin e saj dhe se asnjë normë e ligjit organik nuk parashikon ardhjen e ndonjë pasoje në lidhje me gjykimin kushtetues ose (pa)vlefshmërinë e akteve objekt i këtij gjykimi (në këtë rast vendimi i Kuvendit që e ka vënë atë në lëvizje), si dhe nuk sjell asnjë pasojë negative për të drejtat e Presidentit. Për më tepër, vendimi i Kuvendit që ka vendosur shkarkimin nuk ka asnjë efekt pezullues ose pengues për qëndrimin

në detyrë të Presidentit ose vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së tij kushtetuese.

67. Për sa i përket pretendimit tjetër se parashtrimet shtesë janë paraqitur nga Kuvendi tej afatit të caktuar nga Gjykata, Presidenti nuk ka paraqitur argumente në lidhje me pasojën që ka ardhur në të drejtat e tij prej kësaj vonese të pretenduar. Ai është njohur me ato parashtrime dhe ka pasur mundësi e kohë të mjaftueshme për t'i kundërshtuar dhe paraqitur prapësimet përkatëse.

Ç. Për themelin e kërkesës

68. Gjykata vëren se instituti kushtetues i shkarkimit (*impeachment*) ka për qëllim realizimin e parimit të shtetit të së drejtës, i cili kërkon sundimin e ligjit, në kuptimin që askush të mos jetë mbi ligjin dhe Kushtetuta të mbrohet në çdo rast. Për këtë shkak, gjykimi për shkarkimin e Presidentit është një procedurë kushtetuese që mbron rendin kushtetues, që në rast se përfundon me vërtetimin e fajësisë për shkelje të rëndë të Kushtetutës ose kryerjen e një krimi të rëndë, e zhvesh këtë funksionar të lartë publik nga detyrat dhe autoriteti. Në këtë këndvështrim, objekti i procedurës kushtetuese është mbrojtja e rendit kushtetues nga abuzimi i funksionarit kushtetues dhe jo përcaktimi i të drejtave kushtetuese të individit që ushtron detyrën e Presidentit. Vendimi për shkarkimin në këtë lloj procedure nuk shtrihet përtej largimit të Presidentit nga funksioni publik, edhe pse kjo nuk e përjashton atë nga përgjegjësia penale (neni 135 i Kushtetutës). Për rrjedhojë, procedura kushtetuese e shkarkimit ka natyrë të ndryshme nga procedurat penale ose procedurat disiplinore, pasi kur vërtetohet fajësia e tij për shkelje të rënda kushtetuese ose krim të rëndë bëhet fjalë për përgjegjësi kushtetuese të Presidentit, me pasojë shkarkimin nga detyra.

69. Nga ana tjetër, instituti kushtetues i *impeachment* udhëhiqet nga parimet themelore të shtetit të së drejtës, të cilat kërkojnë që organet kushtetuese të ngarkuara për kryerjen e procedurës së shkarkimit të jenë të paanshme dhe të pavarura, që ato të hetojnë si duhet rrethanat e çështjes dhe të miratojnë një vendim të drejtë për përgjegjësinë kushtetuese të Presidentit. Në këtë kuptim, e drejta e individit për të marrë pjesë dhe për t'u mbrojtur gjatë procedurës në të cilën vendoset përgjegjësia kushtetuese e tij nuk mund të vihet në diskutim, sikundër organet shtetërore, veprimtaria e të cilave bazohet në të drejtën dhe kufizohet prej saj, kanë detyrimin të arsyetojnë vendimmarrjen e tyre.

70. Duke iu referuar kufijve të shqyrtimit të çështjes të analizuara më lart (*shih paragrafët 48 dhe 49 të vendimit*), Gjykata do të kontrollojë, fillimisht, procedurën e ndjekur në rastin konkret në drejtim të periudhës së ngritjes së komisionit hetimor, garantimit të së drejtës së Presidentit për t'u dëgjuar, caktimit të seancës plenare, si dhe të detyrimit për arsyetimin e akteve të procedurës parlamentare. Më tej, Gjykata do të analizojë shkaqet konkrete të shkarkimit të Presidentit dhe vërtetimin e fajësisë, në kuptim të parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 90 të Kushtetutës.

71. Për sa i përket pretendimit të Presidentit për krijimin e një mosmarrëveshjeje kompetencash dhe për ndërhyrjen e Kuvendit në ushtrimin e kompetencave të tij kushtetuese në kundërshtim me nenin 7 të Kushtetutës, Gjykata nuk e vlerëson si kërkim më vete, por do ta konsiderojë në funksion të kontrollit që ajo ushtron ndaj veprimtarisë së Kuvendit, në aspektin procedural dhe material, në kuptim të nenit 90 të Kushtetutës.

Ç.1. Për procedurën parlamentare

Ç.1.1 Për periudhën e ngritjes së komisionit hetimor

72. Presidenti ka pretenduar se neni 90, pika 2, i Kushtetutës, i konkretizuar në nenin 112 të Rregullores, nuk mund të lexohet i shkëputur nga neni 77, pika 3, i Kushtetutës, që kërkon që komisioni hetimor të veprojë sipas procedurës së parashikuar me ligj. Në këtë kuptim, veprimtaria hetimore parlamentare është realizuar në periudhën 4-mujore të përfundimit të mandatit të Kuvendit, gjë që bie në kundërshtim me nenin 4, pika 6, të ligjit nr. 8891/2002, me pasojë pavlefshmërinë e akteve të këtij organi.

73. Kuvendi ka prapësuar se komisioni hetimor ka pasur si bazë ligjore nenin 90 të Kushtetutës dhe jo nenin 77 të saj, pasi në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një funksion ligjvënës të Kuvendit, por me një funksion disiplinor. Në rastet e shkarkimit të Presidentit Kuvendi vepron nëpërmjet Rregullores së tij, kurse dispozitat e ligjit nr. 8891/2002 shërbejnë si norma plotësuese dhe zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren.

Për komisionet hetimore të kësaj natyre nuk ka ndalim kohor për ngritjen dhe funksionimin e tyre. Por, referuar edhe përmbajtjes së nenit 4, pika 6, të ligjit nr. 8891/2002, nëse një komision i tillë hetimor është ngritur, nuk ka asnjë parashikim ndalues për funksionimin e tij.

74. Nisur nga prapësimi i Kuvendit se në procedurën e shkarkimit të Presidentit nuk gjen zbatim neni 77 i Kushtetutës, për rrjedhojë as ndalimi kohor "4 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit", i parashikuar në nenin 4, pika 6, të ligjit nr. 8891/2002, Gjykata vlerëson të ndalet fillimisht në përcaktimin e bazës kushtetuese që rregullon mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të komisionit hetimor në këtë procedurë të veçantë dhe nëse dispozitat përkatëse kushtetuese delegojnë elemente të saj në ligj ose në Rregulloren e Kuvendit. Më konkretisht, ajo do të analizojë nëse në rastin konkret, për shkak të delegimit kushtetues të nenit 77, pika 3, të Kushtetutës, zbatohen parashikimet e ligjit nr. 8891/2002, përfshirë ndalimin e shprehur në nenin 4, pika 6 të tij, për të mos ngritur komisione hetimore gjatë 4 muajve përpara mbarimit të mandatit të Kuvendit dhe, më tej, nëse ky ndalim përfshin vetëm ngritjen apo edhe funksionimin e komisioneve hetimore.

75. Gjykata vëren se neni 90 i Kushtetutës, me përjashtim të kuorumit të propozimit dhe të vendimmarrjes, nuk parashikon në mënyrë të shprehur procedurën që ndjek Kuvendi për shkarkimin nga detyra të Presidentit e në këtë drejtim as caktimin ose ngritjen e ndonjë komisioni hetimor. Kjo procedurë është përcaktuar në mënyrë të posaçme në nenin 112 të Rregullores së Kuvendit, i cili në pikat 2 dhe 3 të tij parashikon mundësinë e ngritjes nga ana e Kuvendit (nëse pranon nëpërmjet votimit raportin dhe propozimin e Komisionit të Ligjeve) të komisionit hetimor për këtë çështje, i cili në përfundim të hetimit duhet t'i paraqesë Kuvendit raport të arsyetuar me shkaqet për shkarkimin e Presidentit, nëse ekzistojnë të tilla.

76. Nga ana tjetër, në Kushtetutë komisionet parlamentare, përfshirë ato hetimore, janë të parashikuara nga neni 77 i saj, i cili në pikën 1 të tij sanksionon se Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme. Në lidhje me këto të fundit, në pikën 2 të këtij neni parashikohet si e drejta e Kuvendit të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë, ashtu dhe detyrimi i Kuvendit të ngrejë komisione hetimore kur kjo kërkohet nga një e katërta e të gjithë anëtarëve të tij. Kurse në pikën 3 të nenit 77 është përcaktuar në mënyrë të shprehur delegimi për ligjvënësin e zakonshëm për rregullimin me ligj të procedurës për funksionimin e komisioneve hetimore, çka është realizuar nëpërmjet ligjit nr. 8891/2002.

77. Refe**ruar nenit 1 të ligjit nr**. 8891/2002, ai rregullon mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të komisioneve hetimore të Kuvendit, sipas parimeve të parashikuara në nenin 77 të Kushtetutës, por nuk bën dallim në lidhje me rregullat dhe procedurat që gjejnë zbatim në varësi të objektit të këtij komisioni. **Edhe në kuptim të n**enit 3 të këtij ligji, komisionet hetimore të Kuvendit krijohen: për të hetuar çështje të veçanta, sipas nenit 77, pika 2, të Kushtetutës; për të hetuar zyrtarë me imunitet që kanë lidhje me çështjen që është objekt i hetimit; sa herë që fillon procedura kushtetuese e shkarkimit të zyrtarëve të lartë, ku përfshihet edhe ajo e parashikuar në nenin 90, pika 2, të Kushtetutës.

78. Në lidhje me natyrën dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve hetimore, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se në aspektin kushtetues këto komisione parlamentare janë të vetmet organe që kanë kompetenca të njohura me ligj për të hetuar nëpërmjet mbledhjes së fakteve dhe provave dhe për të zhvilluar procedura *quasi gjyqësore,* pavarësisht qëllimit dhe objektit të hetimit për të cilin ngrihen (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

79. Nisur nga sa më lart, Gjykata thekson se Kuvendi ka pavarësi vetërregulluese për mënyrën e organizimit të tij dhe ushtrimit të veprimtarisë parlamentare e administrative, e cila shprehet në kompetencën që i është dhënë nga Kushtetuta për miratimin e rregullave të brendshme, që zbërthejnë më hollësisht duke shpjeguar mënyrën se si ushtrohen kompetencat e parashikuara në dispozitat kushtetuese. Në këtë kuptim, në kushtet kur neni 90 nuk ka parashikuar ngritjen e komisionit hetimor për procedurën e shkarkimit të Presidentit, neni 112 i Rregullores përbën trajtim të hollësishëm jo vetëm të kompetencës

kushtetuese të parashikuar në nenin 90 të Kushtetutës, por edhe zbatim të nenit 77 të saj.

80. Bazuar në këtë arsyetim, Gjykata thekson se përveç rregullimeve që përmban neni 112 i Rregullores së Kuvendit, në rastin konkret gjejnë zbatim edhe standardet e parashikuara nga ligji për komisionet hetimore, të cilat nuk përjashtojnë, por plotësojnë parashikimet e Rregullores, duke përforcuar standardet dhe garancitë e kësaj procedure. Edhe Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se prerogativat si të Kuvendit në paraqitjen e propozimit për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu edhe ajo e Presidentit për të dekretuar shkarkimin e tij, të parashikuara në nenin 149 të Kushtetutës, realizohen nëpërmjet një procedure që disiplinohet edhe nga ligji nr. 8891/2002, nga Rregullorja e Kuvendit dhe nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese)*. Madje edhe vetë Kuvendi në përmbajtjen e të gjitha dokumenteve parlamentare të kësaj procedure, si të raportit hetimor, ashtu edhe të vendimit nr. 55/2021, i është referuar ligjit nr. 8891/2002 për mënyrën e funksionimit të komisionit hetimor.

81. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se parashikimi i nenit 4, pika 6, të ligjit nr. 8891/2002 zbatohet edhe për komisionet hetimore që ngrihen në kuadër të procedurës së shkarkimit të Presidentit.

82. Në lidhje me qëllimin e ndalimit të ngritjes së komisioneve hetimore gjatë 4 muajve para mbarimit të mandatit të Kuvendit, të parashikuar në nenin 4, pika 6, të ligjit nr. 8891/2002, Gjykata rithekson se Kuvendi vepron sipas parimit të vazhdimësisë institucionale mes legjislaturave të tij (*shih paragrafin 55 të vendimit*), megjithatë zbatimi i këtij parimi mbart në vetvete specifika që lidhen me përbërjen, konfigurimin e tij politik dhe përtëritjen me zgjedhje të përgjithshme periodike, specifika të cilat kanë bërë të nevojshëm parashikimin e rregullave që garantojnë, nga njëra anë, shmangien e abuzimit me pushtetin në fund të mandatit dhe, nga ana tjetër, autonominë e nevojshme për legjislaturën vijuese. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se krahas ndalimit kohor të ngritjes së komisioneve hetimore me ligj (neni 4, pika 6, i ligjit nr. 8891/2002), Kushtetuta ka përcaktuar ndalimin e Kuvendit për të nxjerrë ligje gjatë periudhës 60-ditore përpara mbarimit të mandatit (neni 65, pika 4, i Kushtetutës). Për të garantuar autonominë e vullnetit politik të legjislaturave, edhe në nenin 87/1 të Rregullores përcaktohet se me mbarimin/mbylljen e legjislaturës së punimeve, Kuvendi i kthen nismëtarit projektaktet e depozituara për shqyrtim e miratim, pjesë e programit të punimeve të tij, që për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të miratohen në seancë plenare.

83. Në vijim të këtij arsyetimi, për të kuptuar nëse ndalimi në përmbajtjen e nenit 4, pika 6, të ligjit nr. 8891/2002 ka të bëjë vetëm me ngritjen e komisioneve apo dhe me funksionimin e tyre, Gjykata i referohet formulimit të nenit 77 të Kushtetutës, që në tekstin e tij përmban termat "caktimit të komisionit" dhe "veprimit të tij sipas ligjit", që dallojnë mes tyre në kuptimin literal dhe duket që në ligj janë transpozuar me termat "ngritje" dhe "funksionim".

84. Duke iu referuar më tej ligjit nr. 8891/2002, ku është zbërthyer dispozita kushtetuese, neni 2 përcakton, se "komision" është komisioni hetimor i Kuvendit, i ngritur sipas rregullave të këtij ligji, kurse "hetime" janë veprimet procedurale që ndërmerren nga komisioni për të sqaruar një çështje të veçantë, por pa marrë të pandehur dhe pa ngritur akuzë penale. Sipas pikës 1 të nenit 4, komisionet hetimore ngrihen dhe funksionojnë mbi bazën e parimeve kushtetuese dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj, kurse sipas pikës 4 të po këtij neni, komisionet organizohen dhe funksionojnë sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj. Referuar strukturës së ligjit nr. 8891/2002, në kreun II janë rregulluar procedurat e krijimit të komisioneve hetimore, ku përfshihen nisma për këtë qëllim dhe mënyra e ushtrimit të saj, si dhe detyrimet e Kryetarit dhe të Kuvendit, kurse në kreun III janë rregulluar aspektet e organizimit dhe funksionimit të komisioneve hetimore, ku përfshihen përbërja e komisionit, drejtimi dhe kompetencat, thirrja e tij dhe zhvillimi i mbledhjeve, si dhe marrja e vendimeve.

85. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se ngritja dhe funksionimi janë jo vetëm terma të ndryshëm nga pikëpamja gjuhësore, por edhe dy aspekte të ndryshme të procesit, që edhe pse lidhen me njërin-tjetrin, nuk mund të

interpretohen në mënyrë të njëjtë. Në këtë kuptim, me termin "ngritje" nënkuptohet elementi kohor që lidhet me caktimin e komisionit hetimor, që përfshin përcaktimin e objektit, qëllimin e hetimit, përbërjen e komisionit dhe afatin për përfundimin e veprimtarisë. Gjykata thekson se komisionet hetimore, si komisione të posaçme në kuptim të përmbajtjes së nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, dallojnë nga komisionet e përhershme edhe në kuptim të natyrës së tyre të përkohshme, që do të thotë se ato e ushtrojnë veprimtarinë vetëm brenda afatit të caktuar nga Kuvendi dhe përfundojnë së ekzistuari me përfundimin e këtij afati, me kryerjen e plotë të veprimtarisë për të cilën janë ngritur dhe paraqitjen e raportit dhe në çdo rast me përfundimin e mandatit të legjislaturës ose kur Kuvendi pushon veprimtarinë e tyre për shkak të ndryshimit të konfigurimit të përbërjes politike, në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 8891/2002.

86. Për rrjedhojë, përdorimi i pjesëzës mohuese "nuk" në pikën 6 të nenit 4 të ligjit nr. 8891/2002 përcakton një ndalim të shprehur vetëm për ngritjen e komisionit hetimor përtej këtij elementi kohor. Për sa kohë që ligjvënësi nuk ka përfshirë në këtë dispozitë edhe funksionimin e tij, nuk ka pasur për qëllim të parashikojë ndalim të shprehur edhe për këtë aspekt të veprimtarisë. Edhe në praktikën e mëparshme parlamentare ky nuk është rasti i vetëm kur komisioni hetimor është ngritur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 6, të ligjit nr. 8891/2002, por ka funksionuar përtej afatit ligjor 4-mujor (shih procedurën e ndjekur nga Kuvendi për ngritjen e komisionit hetimor "Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës" me vendimin nr. 249, datë 23.4.2009).

87. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Presidenti ka dekretuar thirrjen e mbledhjes së parë të Legjislaturës IX të Kuvendit më 9.9.2017 dhe referuar përmbajtjes së nenit 65, pika 1, të Kushtetutës, mandati i asaj legjislature përfundonte më 9.9.2021. Për rrjedhojë, Kuvendi kishte të drejtën e ngritjes së komisioneve hetimore deri më 9.5.2021. Ndërkohë, komisioni hetimor për hetimin e shkeljeve të rënda të kryera nga Presidenti është ngritur me vendimin e Kuvendit të datës 7.5.2021, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 4, pika 6, i ligjit nr. 8891/2002, si dhe ka funksionuar e ushtruar veprimtarinë e tij brenda kësaj legjislature.

Ç.1.2. Për të drejtën e Presidentit për t'u dëgjuar

88. Presidenti ka pretenduar se në procedurën e zhvilluar nga Kuvendi nuk është respektuar detyrimi për ta dëgjuar atë, i sanksionuar në nenin 112 të Rregullores. Njoftimi i Komisionit të Ligjeve për mbledhjen e datës 5.5.2021 nuk jepte asnjë sqarim për arsyet, qëllimin, caktimin urgjent të mbledhjes në më pak se 24 orë dhe çfarë kërkohej nga Presidenti. Njoftimi nuk ishte ftesë për pjesëmarrje dhe nuk tregonte nëse Presidenti mund të kërkonte të ishte i pranishëm për të dhënë shpjegimet e tij. Edhe pse Presidenti, duke mbajtur parasysh volumin e informacionit që duhej diskutuar, shprehu gatishmërinë për t'u takuar, diskutuar e shprehur në komision në datën 10.5.2021, që përkonte me Ditën e Drejtësisë, Komisioni i Ligjeve e rinjoftoi për pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të datës 6.5.2021. Pavarësisht se Presidenti iu përgjigj njoftimit, duke u shprehur se koha prej 24 orësh nuk ishte e mjaftueshme dhe se agjenda e tij e paracaktuar nuk i mundësonte zhvillimin e takimit në atë datë, duke kërkuar sërish të dëgjohej në datën 10.5.2021, Komisioni i Ligjeve vijoi veprimtarinë dhe hartoi raportin e datës 6.5.2021, duke i rekomanduar seancës plenare ngritjen e komisionit hetimor. Në këtë mënyrë, Kuvendi ka shkelur nenin 112, pika 2, të Rregullores, ku përcaktohet detyrimi për ta dëgjuar Presidentin përpara hartimit të raportit nga Komisioni i Ligjeve, por dhe përpara se Kuvendi të shprehet për miratimin e tij dhe ngritjen e komisionit hetimor.

89. Kuvendi ka prapësuar se këto pretendime janë të pabazuara. Presidenti e ka shfaqur qëndrimin e tij në lidhje me propozimin e grupit nismëtar për shkarkim dhe i ka kthyer përgjigje negative ftesës së kryetarit të Komisionit të Ligjeve për të qenë i pranishëm në mbledhjen e këtij komisioni, duke shprehur qëndrimin e tij në lidhje me kërkesën e grupit nismëtar. Në përputhje me nenin 89, shkronja "b", të Kodit të Procedurave Administrative, duke qenë se Presidenti e ka paraqitur paraprakisht qëndrimin e tij me shkrim në lidhje me propozimin e grupit

nismëtar, e drejta e tij për t`u dëgjuar në këtë fazë të procedurës është respektuar dhe zhvillimi i një seance dëgjimore do të ishte e pakuptimtë në këtë rast.

90. Gjykata vëren se neni 112 i Rregullores së Kuvendit ka parashikuar të drejtën e Presidentit për t'u dëgjuar në disa faza të procedurës parlamentare. Sipas pikës 2 të këtij neni Komisioni i Ligjeve është i detyruar të dëgjojë Presidentin, në rast se prej tij kërkohet që të shprehet, duke i lënë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe dhënien e sqarimeve. Ky detyrim është parashikuar edhe për komisionin hetimor, i cili është i detyruar të thërrasë dhe të dëgjojë mendimin e Presidentit në lidhje me propozimin e paraqitur (pika 3). Në të njëjtën mënyrë, në pikën 4 të këtij neni parashikohet se Kuvendi, i mbledhur në seancë plenare për shqyrtimin e raportit të komisionit hetimor, është i detyruar ta dëgjojë Presidentin në rast se kërkohet nga ky i fundit.

91. Duke vlerësuar zbatimin e detyrimit të parashikuar nga neni 112 i Rregullores së Kuvendit në këndvështrim të fakteve të rezultuara gjatë këtij gjykimi, Gjykata konstaton se në përputhje me pikën 1 të nenit 112 të Rregullores, në datën 4.5.2021 Kryetari i Kuvendit ka vënë në dijeni menjëherë Presidentin për kërkesën e deputetëve dhe ia ka përcjellë atë Komisionit të Ligjeve. Brenda ditës Kuvendi ka njoftuar Presidentin se ky komision do të mblidhej të nesërmen, më 5.5.2021. Pas këtij njoftimi Presidenti i ka shprehur komisionit gatishmërinë për të diskutuar e për t'u dëgjuar, duke përcaktuar datën 10.5.2021 si të përshtatshme për këtë qëllim. Pas këtij njoftimi të Presidentit komisioni e ka njoftuar për zhvillimin e seancës dëgjimore *online* në datën 6.5.2021. Për shkak të agjendës së paracaktuar të kësaj date Presidenti ka kërkuar sërish zhvillimin e takimit për t'u dëgjuar në datën 10.5.2021. Pavarësisht kërkesave të Presidentit, komisioni, në mbledhjen e datës 6.5.2021, ka vijuar me rendin e ditës dhe ka miratuar raportin që do t'i paraqitej Kuvendit, duke propozuar ngritjen e një komisioni hetimor për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti (*shih për rrethanat paragrafët 9–13 të vendimit).*

92. Sipas pikës 2 të nenit 112 të Rregullores, Komisionit të Ligjeve i është lënë një afat 15-ditor, nga momenti i përcjelljes së kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese, për shqyrtimin e saj dhe përgatitjen e raportit e të propozimit përkatës. Pavarësisht këtij afati, në rastin konkret kjo çështje është shqyrtuar në komision brenda 2 ditëve, çka tregon një nxitim nga ana e kësaj strukture për zhvillimin dhe përfundimin sa më të shpejtë të çështjes. Megjithatë, kjo mënyrë e të vepruarit në vetvete nuk është e mjaftueshme për të konsideruar se procesi nuk ka qenë i rregullt nga pikëpamja kushtetuese.

93. Gjykata vëren se në këtë fazë të procedurës Presidenti ka marrë dijeni për shkaqet për të cilat është kërkuar fillimi i procedurës për shkarkim dhe se Komisioni i Ligjeve ka shqyrtuar nëse plotësoheshin kërkesat për ngritjen e një komisioni hetimor për zhvillimin e hetimit parlamentar, por nuk ka marrë në shqyrtim shkeljet e pretenduara dhe bazueshmërinë e tyre. Në shkresat e tij drejtuar komisionit Presidenti ka dhënë argumente në lidhje me shkaqet që e ndalonin Kuvendin të ngrinte një komision të tillë hetimor.

94. Gjykata vlerëson se edhe në rastin e procedurës kushtetuese të shkarkimit, pavarësisht qëllimit të ndryshëm kushtetues që ajo ndjek, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, sikurse u përmend më lart, nuk mund të vihet në dyshim. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur *nuk nënkupton vetëm atë për t'u paraqitur personalisht para organit administrativ, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi* komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim gjatë kësaj procedure (*shih vendimin nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Duke iu referuar rrethanave konkrete, Gjykata vlerëson se pavarësisht kohës së shkurtër që ka pasur në dispozicion, Presidenti e ka realizuar të drejtën për t'u dëgjuar në procedurën e zhvilluar në Komisionin e Ligjeve n*ëpërmjet komunikimit me shkrim që ka pasur me këtë të fundit, ku ka parashtruar të gjitha argumentet e tij në lidhje me shkaqet që nuk lejonin vijimin e procedurës dhe ngritjen e një komisioni hetimor për hetimin e shkeljeve të pretenduara të kryera prej tij sipas kërkesës së deputetëve.*

95. Në lidhje me procedurën e zhvilluar nga komisioni hetimor, Gjykata vëren se në datën 14.5.2021 komisioni e ka njoftuar Presidentin për thirrjen e tij në seancën dëgjimore të datës

18.5.2021, për t'u dëgjuar në lidhje me rrethanat që kanë të bëjnë me objektin e hetimit. Me shkresën nr. 1651, datë 16.5.2021, Presidenti i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit, duke e konsideruar antikushtetues dhe fiktiv këtë proces, si dhe duke parashtruar edhe qëndrimin në lidhje me veprimtarinë e Kuvendit, mungesën e legjitimitetit për ngritjen e komisionit hetimor dhe pamjaftueshmërinë e kohës për të përmbyllur procesin përkatës brenda afateve ligjore. Ndër të tjera, ai është shprehur se në datën 17.5.2021 do të ishte i pranishëm në një takim zyrtar jashtë vendit, të njoftuar paraprakisht. Në datat 18.5.2021 dhe 21.5.2021 komisioni hetimor e ka rithirrur Presidentin në seancë dëgjimore, duke i dhënë mundësinë të caktonte ditën dhe orën që do të konsideronte të përshtatshme. Në përgjigje Presidenti ka mbajtur qëndrimin e tij sipas shkresës së mëparshme nr. 1651 prot. Pas miratimit të raportit përfundimtar nga komisioni hetimor dhe dërgimit të tij Kuvendit për miratim, ky i fundit ia ka përcjellë Presidentit dhe e ka njoftuar për zhvillimin e seancës plenare në datën 9.6.2021, duke e vënë në dijeni për të drejtën për t'u dëgjuar. Edhe pse ka konfirmuar marrjen dijeni, Presidenti i ka përcjellë sërish Kuvendit shkresën nr. 1651 prot., ku sipas tij ishin parashtruar në mënyrë shteruese argumentet në lidhje me procesin e zhvilluar nga Kuvendi. Në seancën plenare të datës 9.6.2021 Kuvendi ka vendosur shkarkimin nga detyra të Presidentit për shkelje të rënda të Kushtetutës (*shih për rrethanat paragrafët 16-22 të vendimit)*.

96. Bazuar në rrethanat si më sipër, Gjykata vëren se komisioni hetimor është ngritur në datën 7.5.2021 dhe në datën 28.5.2021 ka miratuar raportin e tij përfundimtar, periudhë gjatë së cilës ai ka hetuar të gjithë veprimtarinë e Presidentit sipas objektit të hetimit dhe i ka propozuar Kuvendit shkarkimin e tij nga detyra. Në datën 9.6.2021 është përmbyllur e gjithë procedura e zhvilluar nga Kuvendi, duke u miratuar edhe vendimi për shkarkimin nga detyra të Presidentit. Gjykata vëren se Presidenti nuk ka marrë pjesë në asnjë nga seancat dëgjimore të zhvilluara nga komisioni hetimor në të cilat është thirrur për t'u dëgjuar dhe as në seancën plenare ku është marrë në shqyrtim raporti për propozimin e shkarkimit të tij nga detyra. Gjykata konstaton se as në raportin e komisionit hetimor, as në vendimin nr. 55/2021 të Kuvendit nuk janë pasqyruar shkaqet e mosparaqitjes së Presidentit dhe mënyra se si janë vlerësuar ato nga Kuvendi.

97. Procedura kushtetuese e gjykimit të vendimit të Kuvendit për shkarkimin e Presidentit përfaqëson një garanci të posaçme në interes të moscenimit të pavarësisë së këtij organi. Parlamenti në një procedurë shkarkimi nuk ushtron pushtet gjyqësor, por një pushtet tjetër e të ndryshëm, me karakter politiko-administrativ, që në mënyrë ekskluzive i është deleguar atij. Prandaj, ky organ mund t'i zbatojë disa nga parimet e procesit të rregullt në një mënyrë tipike kushtetuese, domethënë për aq sa nuk e pengon të ushtrojë kompetencat e veta për të nxjerrë një akt administrativ që ka njëkohësisht edhe një natyrë kushtetuese (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

98. Nisur nga sa më lart, edhe pse Kuvendi ka vepruar me nxitim për ngritjen e komisionit hetimor, në vlerësimin e Gjykatës, në procesin e zhvilluar prej tij, Presidentit nuk i është mohuar e drejta për t'u njohur me aktet dhe për të paraqitur provat e pretendimet e tij. Konkretisht, sikurse u theksua edhe më sipër, Presidenti është njohur që në datën 4.5.2021 me shkaqet për të cilat ishte paraqitur kërkesa e një grupi deputetësh për fillimin e procedurës së shkarkimit. Përgjatë gjithë periudhës kohore që është zhvilluar kjo procedurë në Kuvend, mes palëve ka pasur një korrespondencë të gjatë e të vazhduar në rrugë shkresore, ku Presidenti në mënyrë të përsëritur ka parashtruar qëndrimin e tij në lidhje me legjitimitetin e procesit dhe antikushtetutshmërinë e tij. Edhe pse atij i është dhënë mundësia dhe është thirrur disa herë për t'u paraqitur në seancë dëgjimore në komisionin hetimor, ai ka vijuar të shprehë të njëjtin qëndrim. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se Presidenti është thirrur në përputhje me nenin 112 të Rregullores së Kuvendit dhe ka parashtruar me shkrim argumentet e tij në lidhje me procedurat parlamentare.

99. Bazuar në sa më sipër, Gjykata, referuar akteve të administruara në këtë gjykim, vlerëson se në tërësinë e tij ky proces nuk paraqet probleme kushtetutshmërie në drejtim të së drejtës së Presidentit për t'u dëgjuar.

Ç.1.3 Për thirrjen e seancës plenare të datës 7.5.2021

100. Presidenti ka parashtruar se procedura për thirrjen e seancës plenare së datës 7.5.2021 për ngritjen e komisionit hetimor dhe përcaktimi i rendit të ditës së saj është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, pasi nuk është respektuar afati 48 orë. Sipas tij, bashkëlidhur parashtrimeve të datës 4.2.2022, Kuvendi ka paraqitur një kopje të urdhrit të Kryetarit nr. 19 që mban datën 5.5.2021, ndërkohë që deri në këtë fazë të procedurës ai është referuar me datën 6.5.2021. Mes këtij dokumenti dhe atij të publikuar në faqen zyrtare ka ndryshime në formë dhe përmbajtje, çka vë në dyshim vërtetësinë e kësaj prove. Në seancën e datës 7.5.2021 është miratuar edhe vendimi nr. 45/2021 për ngritjen e komisionit hetimor, çështje që nuk ishte e përcaktuar në rendin e ditës dhe nga shqyrtimi i praktikës parlamentare nuk rezulton asnjë kërkesë e paraqitur ose e shqyrtuar për ndryshimin e tij.

101. Kuvendi ka prapësuar se kërkesa për shkarkimin e Presidentit është parashikuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 4 maj-21 maj, të miratuar me vendimin nr. 5, datë 3.5.2021 të Konferencës së Kryetarëve. Urdhri i Kryetarit të Kuvendit për rendin e ditës në faqen *online* mban datën 6.5.2021, që përkon me datën kur është protokolluar në zyrën e protokollit të Kuvendit dhe është kjo data kur ka hyrë në fuqi. Në këtë rast ndodhemi para procedurës së veçantë të normuar nga neni 112, pika 3, i Rregullores që parashikon shqyrtimin në seancë brenda 7 ditësh. Miratimi i raportit të Komisionit të Ligjeve sjell automatikisht zhvillimin e procesit të votimit për ngritjen e komisionit hetimor dhe në kuptim të nenit 112 të Rregullores, Kuvendi ka të drejtë që t'ia nënshtrojë vendimmarrjes ngritjen e komisionit hetimor edhe menjëherë pas miratimit të raportit, pa qenë e nevojshme kërkesa për ndryshim të rendit të ditës. Caktimi i rendit të ditës dhe përgatitja e seancës nuk janë çështje të nivelit kushtetues, por çështje të brendshme organizative të Kuvendit dhe nuk rezulton që ndonjë deputet të ketë ngritur pretendime për procedurën e ndjekur.

102. Gjykata konstaton se me vendimin nr. 5, datë 3.5.2021 të Konferencës së Kryetarëve është miratuar kalendari i punimeve të Kuvendit për periudhën 4.5.2021–21.5.2021, ku shqyrtimi i kërkesës për shkarkimin e Presidentit është parashikuar për shqyrtim në seancën plenare të datës 7.5.2021. Më tej, në bazë të urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr. 19, datë 6.5.2021, në rendin e ditës të datës 7.5.2021 është përfshirë edhe shqyrtimi i projektvendimit për miratimin e raportit dhe propozimit të Komisionit të Ligjeve për ngritjen e komisionit hetimor.

103. Në ndryshim nga organet kushtetuese, organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohet me ligje të veçanta të miratuara me shumicë të cilësuar (nenet 6 dhe 81, pika 2, shkronja "a", të Kushtetutës), Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve të tij (neni 75, pika 2, i Kushtetutës). E drejta e Kuvendit për të miratuar rregullat e organizimit dhe të funksionimit të tij ka të bëjë me autonominë procedurale (normative dhe organizative) të parlamentit, që është një parim themelor në shumicën e sistemeve kushtetuese (*shih opinionet e Komisionit të Venecies CDL-AD(2017)026, datë 9.10.2017, paragrafët 22–23 dhe CDL-AD(2010)025, datë 15.11.2010, paragrafi 94),* sipas të cilit parlamenti duhet të ketë të drejtën ekskluzive për të rregulluar organizimin e tij, rolin e deputetëve, strukturën dhe procedurat e brendshme.

104. Duke respektuar parimin e vetërregullimit të Kuvendit, Gjykata vlerëson se në parim Rregullorja e tij nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues nga Gjykata. Rregullorja e Kuvendit është një akt juridik që ka si qëllim të vendosë rregulla për veprimtarinë dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit. Mosrespektimi i saj e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues, që gjejnë pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera Rregullorja e Kuvendit nuk mund të jetë objekt kontrolli kushtetues (*shih vendimin nr. 35, datë 10.1.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata rithekson se Kuvendi është organi që me rregullore interpreton jo vetëm normat kushtetuese, por edhe normat e tjera të rregullores së tij në praktikën e rasteve konkrete. Në rastet kur Kuvendi ka bërë vetë interpretim të normave të rregullores së tij dhe kur këto norma nuk janë të parashikuara drejtpërdrejt nga

Kushtetuta, por u takojnë interpretimeve e diskrecionit të atij organi, Gjykata Kushtetuese nuk mund të arrijë në konkluzione të ndryshme (*shih vendimet nr. 44, datë 7.10.2011; nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 21, datë 1.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

105. Sikurse u theksua më sipër, rregullimet e posaçme të nenit 112 të Rregullores së Kuvendit përbëjnë detajim të nenit 90 të Kushtetutës, ndaj Gjykata e analizon procedurën e ndjekur nga Kuvendi vetëm në lidhje me pretendime të nivelit kushtetues, duke mos u ndalur në aspektet e tjera me natyrë të përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë e brendshme parlamentare.

106. Për sa më sipër, pretendimet e Presidentit me natyrë procedurale për kohën e thirrjes së seancës plenare për ngritjen e komisionit hetimor dhe datën e urdhrit të Kryetarit të Kuvendit për thirrjen e saj, për të cilin përfaqësuesi i Kuvendit u shpreh para Gjykatës se ka të bëjë me mënyrën se si zbardhen aktet parlamentare dhe me procedurat e brendshme të këtij organi, duke mos e vënë në diskutim datën 6.5.2021 si datë të këtij urdhri, Gjykata vlerëson se nuk mund të jenë objekt i kontrollit të saj, për sa kohë nuk është provuar cenimi që i kanë sjellë procesit në thelbin e tij në aspektin kushtetues.

Ç.1.4 Për arsyetimin e akteve të procedurës parlamentare

107. Presidenti ka pretenduar se në dokumentet parlamentare (kërkesa e deputetëve për shkarkim, raporti i komisionit hetimor dhe vendimi nr. 55/2021 i Kuvendit) nuk është parashtruar asnjë dispozitë kushtetuese ose një akt i Presidentit që mund të ketë shkelur ndonjë dispozitë kushtetuese, për rrjedhojë procesi është ngritur dhe ka funksionuar në mungesë të lëndës dhe shkaqeve kushtetuese. Po ashtu, mënyra se si ka vepruar Kuvendi, që ka nisur procesin hetimor pa pasur një çështje të veçantë për të hetuar, por duke e zgjeruar atë në të gjithë veprimtarinë e Presidentit, përbën shkelje të nenit 7 të Kushtetutës.

108. Kuvendi ka prapësuar se Presidenti nuk ka asnjë të drejtë procedurale dhe legjitimitet për të zgjeruar periudhën ose sjelljet që duhet të merren në shqyrtim në këtë fazë. Në vendimin për ngritjen e komisionit hetimor janë përcaktuar tri çështje, që kanë të bëjnë me hetimin dhe verifikimin e veprimeve të Presidentit para dhe gjatë procesit zgjedhor, verifikimin e pasojave të tyre dhe verifikimin e akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të Presidentit në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese. Aktet e Kuvendit janë hartuar në përputhje me standardet e vendosura për funksionimin e komisioneve hetimore, por duke pasur parasysh edhe natyrën teknike të punës së komisionit dhe formimin profesional të anëtarëve të tij, këto akte nuk hartohen si vendime tipike të organeve të specializuara.

109. Gjykata, bazuar në parimin *iura novit curia,* duke pasur parasysh natyrën e organit, të procedurës që zhvillohet në këtë rast, si dhe përbërjen e komisionit hetimor, vlerëson se detyrimi për arsyetimin e këtyre akteve do të analizohet në kontekstin e detyrimit të parashikuar në nenin 112 të Rregullores së Kuvendit për aktet e procedurës parlamentare, si dhe atë të parashikuar në nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 për vendimin e Kuvendit.

110. Gjykata vëren se në kërkesën e paraqitur nga 49 deputetë të Kuvendit për shkarkimin e Presidentit, drejtuar Kryetarit të tij, janë parashtruar, në kuptim të nenit 112, pika 1, të Rregullores, aktet e kryera nga Presidenti, të cilat i referohen periudhës para dhe gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021, që përbëjnë shkelje të rënda të Kushtetutës, duke referuar në dispozitat kushtetuese që përcaktojnë rolin dhe detyrimet kushtetuese të Presidentit. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa për shkarkim e paraqitur nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit është paraqitur në formën e parashikuar nga Rregullorja dhe përmban në mënyrë të motivuar dhe konkrete shkeljen e rëndë të Kushtetutës, duke plotësuar edhe kërkesën për arsyetimin e saj.

111. Në seancën e datës 7.5.2021, me vendimin nr. 44/2021, Kuvendi ka vendosur miratimin e raportit dhe propozimit të Komisionit të Ligjeve për ngritjen e një komisioni hetimor dhe me vendimin nr. 45/2021, ka vendosur ngritjen e komisionit hetimor "Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë", me qëllim verifikimin e mënyrës së ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga ana e Presidentit gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në

ditën e heshtjes zgjedhore dhe me objekt të punës: a) hetimi dhe verifikimi nëse aktet e kryera dhe deklaratat e dhëna nga Presidenti gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021 përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës; b) verifikimi i pasojave të këtyre akteve në raport me parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të vendit, si dhe marrëdhënieve me partnerët strategjikë të Shqipërisë; c) verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

112. Gjykata vëren se edhe pse objekti i hetimit nuk përputhet tërësisht me planin e veprimit të tij, komisioni hetimor, në përfundim të veprimtarisë së tij hetimore, ka analizuar dhe arsyetuar në raportin e tij përfundimtar veprimet dhe mosveprimet e Presidentit, duke arritur në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e tij. Në të njëjtën mënyrë, edhe vendimi i Kuvendit nr. 55/2021, me të cilin është vënë në lëvizje gjykimi kushtetues, plotëson kërkesën e të qenit i arsyetuar, në kuptim të përmbajtjes së nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, pasi përmban përshkrimin e fakteve dhe argumentet në lidhje me shkeljen e rëndë të Kushtetutës, si dhe është shoqëruar me provat përkatëse.

113. Po në këtë drejtim, Gjykata do të verifikojë edhe pretendimin e ngritur nga Presidenti në seancë plenare për caktimin e njërit prej përfaqësuesve të Kuvendit në këtë gjykim kushtetues, i cili ka qenë njëkohësisht edhe ekspert ligjor i caktuar pranë komisionit hetimor.

114. Presidenti ka pretenduar se bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8891/2002 funksioni i ekspertit të thirrur nga komisioni hetimor është i njëjtë me atë të ekspertit sipas Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), i cili kërkon që ai të jetë i paanshëm. Sipas ligjit nr. 8891/2002 komisioni hetimor mund të caktonte ekspertë, por jo ekspertë ligjorë, që sipas pikës 6 të nenit 2 duhej të ishin persona që emërohen pranë Kuvendit. Raporti i këtij eksperti përbën një akt të formuar në konflikt të hapur interesi, të diktuar, rrjedhimisht të pavlefshëm.

115. Kuvendi ka prapësuar se ky ekspert ligjor kishte si detyrë të paraqiste elementet kryesore të doktrinës dhe jurisprudencës kushtetuese të krahasuar. Raporti i hartuar prej tij paraqet vetëm disa njohuri juridike, por nuk mund të klasifikohet si provë. Eksperti i caktuar sipas pikës 6 të nenit 2 të ligjit nr. 8891/2002 vihet në dispozicion të Kuvendit dhe është i ndryshëm nga ai i thirrur sipas pikës 5 të po këtij neni, i cili është i njëjtë me atë të parashikuar në KPP.

116. Gjykata vëren se me vendimin e ndërmjetëm nr. 5, datë 14.5.2021 të komisionit hetimor janë caktuar dy ekspertë ligjorë, njëri prej të cilëve është autorizuar nga Kryetarja e Kuvendit edhe si përfaqësues i këtij subjekti në këtë gjykim kushtetues. Sipas nenit 41 të Rregullores së Kuvendit, komisionet ose këshillat mund të caktojnë specialistë/ekspertë të përkohshëm për realizimin e detyrave të tyre, kur Kuvendi nuk zotëron ekspertizën e nevojshme për një çështje të caktuar. Caktimi i specialistëve/ekspertëve të jashtëm të përkohshëm bëhet me vendim të Byrosë së Kuvendit, mbi bazën e propozimit të komisionit ose këshillit përkatës. Referuar vendimit të ndërmjetëm të komisionit hetimor për zgjedhjen e dy ekspertëve ligjorë, ai është mbështetur në pikën 6 të nenit 2 të ligjit nr. 8891/2002, sipas të cilit "ekspert ligjor" është personi me njohuri në fushën e hetimit, i cili emërohet pranë Kuvendit dhe vihet në dispozicion të komisionit.

117. Për sa më sipër, ekspertët ligjorë nuk mund të caktoheshin nga komisioni hetimor, por vetëm mbi bazën e propozimit të këtij të fundit. Megjithatë, Gjykata vëren se pavarësisht se emërimi i këtij eksperti nuk është bërë në përputhje me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, detyrat e ngarkuara atij kanë qenë me natyrë ligjore dhe nuk rezulton që ai të ketë arritur në përfundime në lidhje me objektin e hetimit të komisionit hetimor, pra për ekzistencën e shkeljeve konkrete dhe rëndësinë e tyre. Për rrjedhojë, ajo vlerëson se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe nuk është i tillë që të vërë në dyshim procesin e zhvilluar nga Kuvendi, parë edhe në këndvështrim të detyrimit për arsyetimin e akteve të procedurës parlamentare. Po ashtu, pjesëmarrja e këtij eksperti si përfaqësues në gjykimin kushtetues nuk është provuar se në

çfarë mënyre ka cenuar të drejtat e Presidentit në këtë gjykim.

118. Në këndvështrim të detyrimit për arsyetim, të përcaktuar në nenin 112 të Rregullores së Kuvendit, Gjykata rithekson se si komisioni hetimor në raportin e tij, ashtu edhe Kuvendi në vendimin nr. 55/2021, duhej të kishin parashtruar shkaqet për mosparaqitjen e Presidentit në seancat dëgjimore dhe të pasqyronin qëndrimin dhe argumentet e tyre në lidhje me mënyrën se si është analizuar dhe vlerësuar kjo sjellje. Gjithsesi, Gjykata thekson se ndikim të drejtpërdrejtë në proces kanë vetëm ato parregullsi që kanë sjellë pasoja në drejtim të garantimit të të drejtave ose respektimit të parimeve të nivelit kushtetues. Bazuar në këtë standard, por edhe duke pasur parasysh përfundimin e arritur prej saj se në procesin e zhvilluar nga Kuvendi nuk është cenuar e drejta e Presidentit për t'u dëgjuar, Gjykata vlerëson se kjo e metë në arsyetimin e akteve parlamentare nuk është e tillë që të ndikojë në këtë proces në tërësinë e tij.

119. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa e deputetëve për shkarkim, raporti i komisionit hetimor të Kuvendit dhe vendimi i tij nr. 55/2021 janë arsyetuar në përputhje me parashikimet e nenit 112 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

120. Në përfundim, Gjykata, pasi verifikoi procedurën e ndjekur nga Kuvendi për ngritjen e komisionit hetimor, garantimin e së drejtës së Presidentit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, mënyrën e thirrjes së seancës plenare dhe detyrimin për arsyetimin e akteve parlamentare, në tërësi konstatoi se nuk ka pasur shkelje kushtetuese në këtë procedure.[1]

Ç.2. Për shkaqet e shkarkimit

Ç.2.1. Përgjegjësia kushtetuese e Presidentit

121. Neni 90 i Kushtetutës parashikon: "*Presidenti i Republikës nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij. 2. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij. 3. Vendimi i Kuvendit i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, e cila, kur vërteton fajësinë e Presidentit të Republikës, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.".*

122. Gjykata vlerëson të analizojë, fillimisht, kuptimin e përmbajtjes së nenit 90 të Kushtetutës, duke u ndalur te përgjegjësia e Presidentit, qëllimi i procesit të shkarkimit dhe shkelja e rëndë e Kushtetutës.

123. Paraprakisht analizës së këtyre koncepteve kushtetuese, Gjykata vëren se për sa u takon akteve të kryera në ushtrim të detyrës prej Presidentit (neni 90, pika 1, i Kushtetutës), bëhet fjalë për çdo shfaqje vullneti prej tij në ushtrimin e veprimtarisë për përmbushjen e kompetencave, që, si rregull, bëhet duke nxjerrë dekrete, por edhe në forma të tjera, siç mund të jenë mesazhet drejtuar Kuvendit, kërkimi i mendimit dhe të dhënave me shkrim nga institucionet shtetërore, vënia në lëvizje e gjykimit kushtetues ose drejtimi i Forcave të Armatosura.

124. Në vijim, Gjykata konstaton se neni 90, pika 1, i Kushtetutës përcakton se Presidenti nuk mban përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrimin e detyrës. Dhënia e këtij imuniteti Kryetarit të Shtetit ka për qëllim që, nga njëra anë, të theksohet dinjiteti, pesha dhe rëndësia e funksionit publik dhe, nga ana tjetër, t'i krijohen mundësitë për të përmbushur me kurajon e duhur detyrën e tij. Në këtë pikëpamje, bëhet fjalë për mbrojtjen që Kushtetuta i ka dhënë Presidentit, masa e së cilës përcaktohet në katër drejtime: mbrojtja ofrohet për individin që ushtron detyrën e Presidentit *(ratione personae);* kjo mbrojtje shtrihet përgjatë kohës së ushtrimit të detyrës, që nënkupton se përfundon kur mbaron mandati i Presidentit, por vepron pa afat për çdo akt të kryer në detyrë *(ratione temporis);* mbrojtja i ofrohet në çdo vend, brenda ose jashtë zyrës së tij, kur bëhet fjalë për akte presidenciale, sikundër kjo mbrojtje nuk ekziston as në zyrën e tij nëse Presidenti kryen akte që nuk kanë lidhje me detyrën e tij *(ratione loci);* kjo mbrojtje mbulon vetëm aktet që Presidenti kryen në ushtrim të detyrës, që përfshin çdo akt për përmbushjen e

[1] Gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja vlerësuan se vendimi i Kuvendit duhet shfuqizuar edhe për shkak të mosrespektimit substancial të procedurës parlamentare në aspektet e kohës së ngritjes së komisionit hetimor dhe të votimit me 2/3-at të Kuvendit pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare.

kompetencave të dhëna nga Kushtetuta dhe ligji *(ratione materiae)*.

125. Gjykata vlerëson se parashikimi kushtetues i mosmbajtjes përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës nuk është absolut. Ai mund të kufizohet në rrethana të veçanta, të përcaktuara në mënyrë të shprehur nga pika 2 e nenit 90 të Kushtetutës, që janë *shkelja e rëndë* e Kushtetutës ose *kryerja e një krimi të rëndë*. Thënë ndryshe, përgjegjësia kushtetuese e Presidentit, pavarësisht nëse aktet janë kryer ose jo në ushtrim të detyrës, është rast përjashtimor, i cili rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe ai i ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

126. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parashikimi i përgjegjësisë për Presidentin si Kryetar i Shtetit, e diktuar për arsye të veçanta, tregon rëndësinë që ka detyra e respektimit të Kushtetutës dhe vendin që zë në një shtet demokratik ruajtja dhe mbrojtja e saj. Kjo përgjegjësi vepron ndaj të gjithëve dhe, sidomos, ndaj atyre që janë të ngarkuar me funksione të rëndësishme shtetërore (*shih vendimin nr. 2, datë 14.2.1996, të Gjykatës Kushtetuese*).

127. Edhe nga diskutimet e hartuesve të Kushtetutës evidentohet se ata janë kujdesur që ajo të parashikojë ruajtjen e raportit të duhur midis paprekshmërisë së Presidentit dhe përgjegjësisë së tij. Sipas tyre, Presidenti në një republikë parlamentare, si rregull, është i imunizuar në një mënyrë të tillë që e përjashton atë nga përgjegjësia. Ndonëse mbrojtja që i jepet nga Kushtetuta është e fuqishme, pasi shkarkimi ose vënia e tij nën akuzë kërkon një shumicë prej 2/3-ve të të gjithë anëtarëve të Parlamentit dhe, më tej, vendimi përkatës i shkarkimit i përcillet për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, ajo nuk e bën të paprekshëm. Në këtë kuptim, edhe Presidenti duhet të përgjigjet për pasojat që mund të vijnë nga aktet e tij (*shih Debati Kushtetues, Vëllimi II, faqet 156 dhe 317*).

128. Ndërtimi i shtetit të së drejtës, demokratik e social, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është përcaktuar si aspiratë dhe vendosmëri e sovranit që në Preambulën e Kushtetutës dhe përçohet në tërësinë e dispozitave kushtetuese, ku përfshihen edhe ato që përcaktojnë rolin dhe funksionin e Presidentit. Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se në një shtet të së drejtës, Presidenti, si edhe organet e tjera, ka detyrimin të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre (*shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 15, datë 15.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

129. Gjykata vlerëson se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, ndërvepron edhe me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të përcaktuar nga neni 7 i Kushtetutës, duke diktuar kufizimin dhe kontrollin e pushteteve, përfshirë funksionarët që i ushtrojnë ato, që do të thotë se asnjë prej tyre nuk mund të jetë i pakontrollueshëm.

130. Duke qenë se Kushtetuta e ka veshur Presidentin me kompetenca të gjera, atëherë ai, si çdo funksionar tjetër, duhet të mbajë përgjegjësi në rast se përbën kërcënim për shtetin e së drejtës dhe rendin kushtetues. Siç ka theksuar Gjykata, çdo organ kushtetues dhe pjesë përbërëse të tij kanë detyrimin t'i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve të vendit. Nga ky rregull rrjedh, gjithashtu, detyrimi që të gjitha organet gjatë ushtrimit të detyrës duhet të mbajnë përgjegjësinë që u takon në çdo aspekt të veprimtarisë së tyre dhe, në këtë kuptim, kushdo që ushtron një funksion publik nuk është i përjashtuar nga përgjegjësia. Për të realizuar efektivisht këtë aspekt të zbatimit të parimeve të shtetit të së drejtës, kuadri normativ i një shteti parashikon edhe rastet ekstreme të përgjegjësisë, pra rastet kur funksionari mund të shkarkohet për shkak të mosushtrimit të përgjegjshëm të detyrës me të cilën është ngarkuar (*shih vendimin nr. 23, datë 24.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese).*

131. Gjykata çmon se qëllimi i nenit 90, pika 2, të Kushtetutës, që përcakton se Presidenti i nënshtrohet përgjegjësisë, është mbrojtja e kushtetutshmërisë, e cila ka epërsi mbi garancitë e dhëna atij. Përgjatë procedurës së shkarkimit, neni 90 i Kushtetutës, i zbërthyer më tej në nenet 61–63 të ligjit nr. 8577/2000, i jep garanci të shprehura Presidentit, duke parashikuar: i. një kuorum prej të paktën 1/4-ën e anëtarëve të Kuvendit për paraqitjen e propozimit për shkarkim; ii. një shumicë të cilësuar prej 2/3-ve të anëtarëve të Kuvendit për të vendosur shkarkimin e tij; iii. kufizimin e shkarkimit vetëm në rast të *shkeljes së rëndë* të Kushtetutës ose të kryerjes së një *krimi të rëndë*; iv. caktimin e

Gjykatës Kushtetuese si organin që vendos përfundimisht në lidhje me shkarkimin nga detyra; v. deklarimin e shkarkimit kur vërtetohet fajësia; vi. shqyrtimin paraprak të çështjes jo nga kolegjet, por nga Mbledhja e Gjyqtarëve; vii. kur vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, atëherë ajo është publike; viii. vijimin e ushtrimit të detyrës prej Presidentit deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

132. Duke analizuar përmbajtjen e nenit 90, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ndonëse të dyja shkaqet e shkarkimit janë bashkuar me lidhëzën "dhe", kjo nuk duhet interpretuar sikur *shkelja e rëndë* e Kushtetutës dhe *krimi i rëndë* duhet të verifikohen së bashku, pra që Presidenti shkarkohet kur ai kryen *shkelje të rëndë* bashkë me një *krim të rëndë* dhe as sikur këto dy hipoteza duhet të jenë shkak-pasojë të njëra-tjetrës. Një qëndrim i kundërt do të ngushtonte qëllimin e normës kushtetuese, duke e mbrojtur Kushtetutën vetëm kur ajo cenohet nga krimi i rëndë dhe duke e kufizuar përgjegjësinë kushtetuese të Kryetarit të Shtetit vetëm për shkelje të natyrës penale, për rrjedhojë duke e barazuar përgjegjësinë e tij kushtetuese me atë penale.

133. Në fakt, shkarkimi i Presidentit është proces kushtetues, që merr në mbrojtje Kushtetutën kur ai kryen me faj akte antikushtetuese, të cilat materializohen në *shkelje të rëndë* të Kushtetutës ose *krim të rëndë*. Në këtë këndvështrim, ky proces kushtetues ka si objekt verifikimin e fakteve që cilësohen akte antikushtetuese njëkohësisht me fajësinë kushtetuese të Presidentit dhe kur vërtetohet kjo e fundit, atëherë procesi përfundon me shkarkimin e tij. Edhe pse neni 90, pika 3, i Kushtetutës parashikon se Gjykata vërteton fajësinë, kjo nuk nënkupton fajësinë si element i së drejtës penale, por fajësinë si koncept kushtetues, që do të thotë se Presidenti i vetëdijshëm për rëndësinë e autoritetit shtetëror që mbart dhe të rolit përfaqësues që duhet të luajë, si dhe duke parashikuar dëmin që shkakton, kryen akt antikushtetues duke cenuar vlerat themelore, të cilat rendi kushtetues ka detyrë t'i mbrojë.

134. Kërkesa për vërtetimin e fajësisë, që përcaktohet në pikën 3 të nenit 90, është tregues se shkarkimi i Presidentit nuk është sanksion kushtetues që zbatohet duke u nisur vetëm nga përcaktimi i fakteve të shkeljes, pra nëse faktet përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose krim të rëndë. Ndonjëherë të njëjtat veprime ose mosveprime mund të pasjellin jo vetëm përgjegjësinë kushtetuese, por edhe përgjegjësi të tjera ligjore, siç është përgjegjësia penale për kryerjen e një krimi. Për këto raste, sistemi ynë juridik ka parashikuar se nga veprimet e kundërligjshme të Presidentit mund të cenohen jo vetëm marrëdhëniet kushtetuese, që i japin shkak procesit kushtetues të shkarkimit të tij sipas nenit 90, pika 2, por edhe marrëdhënie të tjera juridike që mbrojnë rendin juridiko-kushtetues, që i japin shkak ngritjes së akuzës penale kundër Presidentit, për të cilën organizohet procesi penal nga prokuroria dhe gjykata e posaçme, sipas neneve 135, pika 2 dhe 148, pika 4, të Kushtetutës.

135. Nga sa më lart, në procedurën e shkarkimit Kuvendi dhe, më pas, Gjykata Kushtetuese vendosin vetëm për përgjegjësinë kushtetuese të Presidentit. Efekti i një procedure të tillë sipas nenit 90 të Kushtetutës, shkarkimi nga detyra, është një sanksion kushtetues i posaçëm, pra nuk është zbatimi i një përgjegjësie penale edhe pse si bazë e tij mund të jetë një krim i rëndë. Për rrjedhojë, shkelja e rëndë e Kushtetutës dhe kryerja e krimit të rëndë nuk janë shkaqe të ndërvarura nga njëra-tjetra, ato nuk barazohen me njëra-tjetrën dhe secila prej tyre përbën bazë të mjaftueshme për përgjegjësinë kushtetuese të Presidentit. Renditja e tyre në tekstin e nenit 90, pika 2, me lidhëzën "dhe" është tregues i rëndësisë së njëjtë që secili shkak mbart për përgjegjësinë kushtetuese të Kryetarit të Shtetit, në kuptimin e vlerës kushtetuese që cenohet nga secili prej tyre.

136. Gjykata vëren, gjithashtu, se norma kushtetuese nga pikëpamja gjuhësore përdor njëjësin *shkelje e rëndë*, që do të thotë se mjafton një akt i vetëm që cenon Kushtetutën për t'i dhënë shkas fillimit të procedurës kushtetuese të shkarkimit. Nga ana tjetër, përdorimi i numrit njëjës nuk përjashton kryerjen njëkohësisht të disa shkeljeve, ku secila prej tyre të jetë e tillë që të konsiderohet njëlloj "e rëndë", prandaj mjafton edhe një shkelje e vetme e Kushtetutës për të legjitimuar fillimin e procedurave të shkarkimit. Shkalla e shkeljes nuk ka të bëjë me

shpeshtësinë e kryerjes ose karakterin vazhdues të saj, pasi mjafton edhe vetëm një veprim ose mosveprim që të justifikojë zhvillimin e procedurës kushtetuese të shkarkimit.

137. Gjykata thekson, gjithashtu, se dispozita kushtetuese ka përcaktuar në mënyrë të qartë se shkak për shkarkim mund të jenë vetëm shkeljet e rënda të Kushtetutës dhe jo shkelje të tjera të saj, ndaj faktet dhe rrethanat e veprimeve të Presidentit, në përmbajtjen e tyre, duhet të shqyrtohen në këtë drejtim.

138. Në jurisprudencën e deritanishme kushtetuese është interpretuar koncepti *shkelje e rëndë* në kontekstin e neneve 128, 140 dhe 149, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilave *shkelja e rëndë* ka të bëjë me akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit e të prokurorit, si dhe shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve nga Prokurori i Përgjithshëm, duke u pohuar se ajo duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi, bazuar në disa faktorë. Këto veprime ose mosveprime, që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe dëmeve që i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura ose që mund të vinin nga shkelja, frekuencën e shkeljes, kohëvazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur (*shih vendimin nr. 75, datë 19.4.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

139. Në rastin e procedurës së shkarkimit të Presidentit, Gjykata vëren se neni 90, pika 2, i Kushtetutës nuk e vendos "shkeljen e rëndë të Kushtetutës" në kontekstin e diskreditimit të figurës dhe pozitës së funksionarit kushtetues dhe as në kontekstin e shkeljeve etiko-profesionale, por ashtu siç u theksua në paragrafin 135, e barazon për nga rëndësia me krimin e rëndë. Ky parashikim kushtetues nuk është rastësor, ai lidhet jo vetëm me faktin se republika, në ndryshim nga gjyqtarët dhe prokurorët, ka vetëm një president që kryen këtë funksion kushtetues, por, mbi të gjitha, lidhet me faktin se përgjegjësia kushtetuese dhe shkarkimi i Presidentit synon mbrojtjen e Kushtetutës dhe të vlerave themelore të saj.

140. Për sa më lart, Gjykata çmon se *shkelja e rëndë* përmbledh vetëm *aktet e rënda*, në kuptimin e gjerë që ky koncept ka në teorinë dhe praktikën e së drejtës. Nga pikëpamja juridike, një akt cilësohet i rëndë kur cenon një normë, e cila ka për objekt mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të rëndësishme. Në shtesë të këtij elementi, akti është i rëndë edhe në raport me pasojën që ka ardhur ose mund të vijë prej tij, së bashku me rrethanat konkrete të kryerjes, pamundësinë e riparimit të dëmit kushtetues të shkaktuar, në kuptimin që shkarkimi nga detyra mbetet e vetmja mundësi, si dhe me momentin subjektiv që lidhet me qëndrimin që mban Presidenti, në veçanti qëllimin që ai ka ndjekur.

141. Duhet theksuar se aktet që përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës mund të jenë veprime, përfshirë akte vendimmarrëse, që shkelin detyrimet në formë *ndalimi* në Kushtetutë, pra nëpërmjet ushtrimit të kompetencës në kundërshtim me normën kushtetuese. Po ashtu, aktet që përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës mund të jenë edhe mosveprime, si mund të jenë rastet kur Presidenti nuk merr vendime ose nuk kryen veprime konkrete, ndonëse ka detyrimin kushtetues për të vepruar. Për rrjedhojë, shkelja e rëndë konsiderohet njësoj e kryer, si nga veprimi, ashtu dhe nga mosveprimi për ushtrimin e kompetencave në mënyrën që përcakton Kushtetuta. Në thelb, këto lloj aktesh përbëjnë shkelje të rëndë, sepse me anë të tyre pengohet funksionimi i organeve të pushtetit publik, shkelen ose cenohen të drejtat dhe liritë themelore të individëve, dëmtohet struktura e rendit kushtetues ose synohet ndryshimi i rendit kushtetues, si dhe çdo akt tjetër i kësaj natyre me efekte të ngjashme të dëmshme ndaj Kushtetutës dhe vlerave që ajo sanksionon. Në këtë kuptim bëhet fjalë për akte të cilat nuk janë thjesht jo në përputhje me Kushtetutën, por që haptazi bien ndesh me të, pra për akte antikushtetuese që vënë në dyshim rregullsinë e rendit kushtetues dhe për këtë shkak ato cilësohen *shkelje e rëndë e Kushtetutës* ose *krim i rëndë*, me pasojë përgjegjësinë kushtetuese të Presidentit.

142. Gjykata thekson, gjithashtu, se në kontekstin e *shkeljes së rëndë të Kushtetutës*, aktet e

Presidentit duhet të jenë reale, pra të jenë konkrete dhe jo hipotetike, në atë masë që të diktojnë shkarkimin e tij nga detyra, me qëllim rivendosjen e rendit kushtetues dhe rikthimin e besimit publik te Kushtetuta dhe institucioni i Presidentit.

143. Nisur nga sa më lart dhe meqenëse neni 90, pika 2, i Kushtetutës nuk përkufizon *shkeljen e rëndë të Kushtetutës*, Gjykata çmon se përmbajtja e tij nuk mund të zhvillohet duke parashikuar një për një të gjitha rastet që mund të përfshihen në grupin e shkaqeve kushtetuese. Për rrjedhojë, Gjykata do të përcaktojë kriteret që nevojitet të analizohen për të arritur në përfundimin nëse faktet që i ngarkohen Presidentit nga Kuvendi mund të cilësohen si shkelje të rënda të Kushtetutës.

144. *Si kriter i parë* Gjykata çmon se duhet të shërbejë përcaktimi nëse akti i Presidentit ka shkaktuar cenimin e një marrëdhënieje, vlere ose çështjeje që mbrohet në mënyrë të shprehur nga Kushtetuta. Thënë ndryshe, sipas këtij kriteri duhet të identifikohet dispozita kushtetuese e shkelur nga akti i Presidentit (i konstituar me veprim ose mosveprim) dhe pesha/rëndësia që ajo ka në tërësinë e normave të Kushtetutës, në drejtim të përmbajtjes substanciale të kësaj dispozite. Kjo nënkupton që Gjykata duhet të kontrollojë nëse në vendimin e Kuvendit parashtrohet se cili është akti i Presidentit dhe pse ai bie ndesh me Kushtetutën, me qëllim që të evidentohet se Presidenti ka shkelur një rregull të përcaktuar shprehimisht (në mënyrë eksplicite) në një normë të Kushtetutës. Në përcaktimin e normës kushtetuese që ka shkelur Presidenti përfshihen jo vetëm ato dispozita që përcaktojnë rolin dhe funksionin e tij kushtetues dhe në mënyrë të shprehur kompetencat e tij të posaçme, por edhe dispozitat që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e rendit kushtetues ose liritë dhe të drejtat themelore. Me fjalë të tjera, shkelja e kryer duhet të jetë e nivelit kushtetues. Megjithatë, Gjykata rithekson se, pavarësisht cilësimit juridik që u jep Kuvendi fakteve që qëndrojnë në themel të shkeljeve të rënda të Presidentit, ajo ka të drejtë t'u japë atyre një cilësim të ndryshëm ose të identifikojë një dispozitë kushtetuese të ndryshme nga ajo e përcaktuar në vendimin e shkarkimit.

145. Sidoqoftë, jo çdo shkelje e Kushtetutës është në vetvete *shkelje e rëndë*. Ndaj, *kriteri i dytë* që verifikon Gjykata janë *pasojat* e ardhura prej saj, në kuptimin që akti i Presidentit të ketë dhënë efekte reale në jetën publike. Me fjalë të tjera, shkelja e rëndë duhet të jetë e një rëndësie të tillë që të prekë thelbin e të drejtave dhe lirive të garantuara në Kushtetutë, rregullsinë e rendit kushtetues dhe, për rrjedhojë, të minojë besimin tek institucioni. Në këtë kontekst shkelja vlerësohet në raport me pozitën e Presidentit, i cili, si zyrtari më i lartë i shtetit, ka detyrimin të garantojë Kushtetutën dhe të promovojë unitetin kombëtar, duke mbrojtur rendin kushtetues, paqen, stabilitetin, mirëqenien e vendit dhe sovranitetin shtetëror.

146. Duke pasur parasysh se Kushtetuta nuk ka përcaktuar si shkak për përgjegjësinë kushtetuese çdo shkelje ligjore, por vetëm shkeljen e dispozitave kushtetuese, e cila, nga ana tjetër, duhet të konsiderohet *e rëndë*, Gjykata çmon se krahas peshës që mbart në vetvete dispozita kushtetuese e shkelur, duhet që edhe pasoja të jetë domethënëse në atë masë që të justifikohet sanksioni kushtetues i shkarkimit të Presidentit. Shkarkimi i Presidentit për *shkelje të rëndë* të Kushtetutës u referohet situatave të cenimit të aktit themelor në mënyrë të dukshme dhe brutale, për rrjedhojë një president që shkel rëndë Kushtetutën nuk mund të përfaqësojë unitetin e popullit dhe as të jetë garant i mbrojtjes së kushtetutshmërisë.

147. *Kriteri i tretë* që shërben për të përcaktuar shkeljen e rëndë në kuadrin e procesit të shkarkimit të Presidentit lidhet me natyrën e pakthyeshme të shkeljes, në kuptimin që dëmi kushtetues që është shkaktuar nga shkelja nuk mund të riparohet përveçse me shkarkimin e tij nga detyra. Në lidhje me këtë kriter, Gjykata thekson se në parim shkarkimi i Presidentit, si një ngjarje përjashtimore, ndërhyn në mënyrë të pazakontë në funksionimin e rendit kushtetues në drejtim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke krijuar pasoja në jetën publike dhe për këtë arsye vendimmarrja duhet të udhëhiqet nga maturia. Edhe Komisioni i Venecias, teksa ka pohuar diskrecionin e Kuvendit për të vendosur në instancë të parë shkarkimin e Presidentit, ka evidentuar se në këtë lloj procedure duhet vlerësuar "*nëse shkarkimi do të*

ulte apo rriste tensionet dhe nëse, në analizë të fundit, do t'i shërbente ose do të pengonte kontrollin dhe balancimin e ndërsjellë" dhe *"nëse ndjekja e opsionit të shkarkimit do t'i shërbente unitetit të popullit"* (*shih opinionin CDL-AD (2019) 019, paragrafët 81 dhe 93*).

148. Duke ritheksuar se procedura e shkarkimit synon mbrojtjen e Kushtetutës, nëse shkelja e rëndë e saj ka dëmtuar rendin kushtetues në atë masë që tejkalon efektet në jetën publike nga shkarkimi i Presidentit, atëherë përfitimet e mbrojtjes së Kushtetutës kanë epërsi mbi humbjen që do të shkaktonte shkarkimi i tij. Me fjalë të tjera, që të ndodhë shkarkimi i Presidentit, përfitimet në drejtim të mbrojtjes së Kushtetutës prej aktit antikushtetues të Presidentit duhet të tejkalojnë humbjet e mundshme që mund t'i vijnë vendit nga shkarkimi i tij. Korniza kushtetuese padyshim është udhëhequr nga nevoja për të lejuar një instrument kushtetues që të mundësojë shkarkimin nga detyra e Presidentit të një personi, i cili, përmes veprimeve të tij, ekstreme dhe për rrjedhojë antikushtetuese, rrezikon dhe dhunon vetë themelet e shtetit.

149. Përveç tri kritereve të mësipërme për përcaktimin e shkeljes së rëndë të Kushtetutës, nevojitet përmbushja edhe i një tjetër *kriteri (i katërt)*, i cili është formuluar shprehimisht edhe në Kushtetutë - vërtetimi i fajësisë e Presidentit për shkeljet e rënda, që është analizuar në paragrafin 133 të këtij vendimi. Bëhet fjalë për atë që Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj e ka shprehur si qëndrim subjektiv që mban autori i shkeljes, që në këtë rast është subjekt i posaçëm, Presidenti, ndaj saj dhe pasojës së ardhur.

150. Në këtë vështrim, Gjykata do të analizojë faktet dhe shkaqet e paraqitura në çështjen konkrete, duke i kaluar ato në filtrin e kritereve të mësipërme që janë kumulative, prandaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që shkelja e Kushtetutës të mos konsiderohet e rëndë.

Ç.2.2 Shkeljet e Presidentit

151. Gjykata vëren se vendimi i Kuvendit nr. 55/2021 për shkarkimin e Presidentit është strukturuar duke grupuar 3 kategori shkeljesh, të cilat përfshijnë faktet dhe provat përkatëse.

152. Sipas Kuvendit, Presidenti me anë të deklaratave dhe qëndrimeve zyrtare të tij, të shprehura në intervista në media dhe rrjete sociale, përpara dhe gjatë procesit zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25.4.2021 si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore ka shkelur: i. detyrimet kushtetuese në lidhje me nenin 86, pika 1 dhe nenin 89 të Kushtetutës; ii. detyrimet që lidhen me nenin 88, pika 3 të Kushtetutës; iii. detyrimin e përcaktuar në nenin 94 të Kushtetutës për të mos ushtruar kompetenca të tjera përveç atyre të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë.

153. Për të përcaktuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës, Kuvendi ka marrë në analizë këta faktorë: i. qëllimin e veprimeve/akteve që përbëjnë shkelje; ii. rëndësinë e së drejtës së shkelur; iii. vazhdimësinë e shkeljes; iv. pasojën që sjell shkelja; v. qëndrimin e subjektit ndaj shkeljes.

154. Kuvendi ka vlerësuar se *qëllimi* i Presidentit nuk ka qenë legjitim, pasi atij nuk i është dashur të rivendosë ndonjë shkelje të Kushtetutës apo ligjit nga të tjerët. Veprimet e tij kanë cenuar marrëdhënie shoqërore dhe politike që mbrohen nga Kushtetuta, Kodi Zgjedhor dhe Kodi Penal dhe që lidhen me të drejtat e njeriut, rendin e sigurinë, marrëdhëniet me jashtë, pavarësinë e institucioneve dhe funksionimin e shtetit demokratik. Për sa i përket *vazhdimësisë* së shkeljes, qëndrimet e tij janë shprehur në rreth 19 emisione televizive, 9 deklarata për mediet dhe rreth 45 postime në rrjetet sociale, si dhe në disa shkresa drejtuar institucioneve të pavarura në mënyrë të përsëritur. Në lidhje me *pasojat,* përfshirja e Presidentit në fushatën zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare të datës 25.4.2021, duke u pozicionuar kundër një pjese të caktuar të popullit, ka cenuar rolin e tij si përfaqësues i unitetit të popullit. Gjithashtu, qëndrimet dhe sjelljet apo retorikat që evokojnë dhunën në vend të mjeteve që ofron shteti i së drejtës kanë dëmtuar besimin e publikut në veprimtarinë e organeve të shtetit. Në drejtim të veprimtarisë së organeve të shtetit, shkresat ose deklaratat e Presidentit drejtuar disa organeve kushtetuese kanë ndikuar në zbehjen e punës së tyre. Imazhi i vendit është cenuar edhe nga qëndrimi publik që Presidenti ka shfaqur për ambasadoren e SHBA-së, si dhe akuzat për përfaqësues të trupit diplomatik. Përveç këtyre, me qëndrimin jo neutral gjatë fushatës zgjedhore, deklaratat pro dhunës, ushtrimin e presionit ndaj organeve

kushtetuese, si edhe funksionarëve të tyre, është cenuar edhe vetë pozita e Presidentit si Kryetar i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit. Në aspektin e perceptimit, referuar raporteve të OSBE/ODHIR-it dhe të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (*KRIIK*) për zgjedhjet parlamentare, rezulton qartë se impakti është negativ si për imazhin e vendit, ashtu dhe për imazhin e vetë institucionit të Presidentit.

155. Nga ana e tij, Presidenti ka prapësuar se ka bërë përpjekje të vazhdueshme për: krijimin e një klime konkurrimi të ndershëm politik në zgjedhjet e datës 25.4.2021, ndërkohë që institucionet e tjera nuk kanë vepruar në kohë për të parandaluar dhe ndëshkuar krimet zgjedhore; ndërgjegjësimin e të gjithëve për denoncimin e çdo veprimi që cenonte të drejtën e votës; ruajtjen e legjitimitetit të procesit zgjedhor dhe njohjen e rezultatit që do të dilte nga një procesi zgjedhor i lirë, i ndershëm, i pandikuar dhe demokratik; kundërshtimin e çdo veprimtarie të shumicës për kapjen e shtetit dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë prej saj; ruajtjen të pacenuar të integritetit të vendit, interesave të shtetit dhe të shtetasve nga ndërhyrjet, veprimet apo vendimmarrjet antikushtetuese të shumicës qeverisëse në 3 vjetët e fundit; përcjelljen institucioneve ligjzbatuese, si dhe partnerëve ndërkombëtarë të çdo informacioni të administruar për veprime ose dukuri që mund të përbënin krime ose shkelje të rregullave zgjedhore.

156. Në vijim, Gjykata do të analizojë secilën shkelje të pretenduar bazuar në kriteret si më sipër, duke vlerësuar faktet dhe pasojat e veprimeve/mosveprimeve për të arritur në përfundimin nëse përbëjnë shkelje të Kushtetutës dhe nëse ato janë të rënda në kuptim të parashikimit kushtetues të nenit 90, pika 2, të Kushtetutës.

Ç.2.2.1 Shkelja e nenit 86, pika 1 dhe nenit 89 të Kushtetutës

157. Sipas Kuvendit, Presidenti ka shkelur detyrimet kushtetuese që përcaktohen në nenet 86, pika 1 dhe 89 të Kushtetutës, që sanksionojnë rolin e tij si Kryetar i Shtetit, me pozitë neutrale, i cili nuk përfshihet në "*lojën politike*", por qëndron mbi palët, si përfaqësues i unitetit kombëtar, dispozita që nuk mund të analizohen në mënyrë të veçuar nga njëra-tjetra, pasi ndalimet e nenit 89 janë në funksion të parashikimit të nenit 86, pika 1, të Kushtetutës. Faktet ku bazohet kjo shkelje lidhen me deklaratat e Presidentit në media, konferenca për shtyp dhe rrjete sociale *(Facebook* dhe *Twitter),* para dhe gjatë fushatës zgjedhore të prillit 2021, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Nga këto deklarata del qartë se Presidenti është pozicionuar dhe ka marrë pjesë aktivisht në fushatë kundër qeverisë, shumicës që përfaqësohet nga subjekti zgjedhor PS, përfaqësuesve të saj, por edhe forcave të tjera politike, duke e bërë të qartë qëndrimin e tij politik. Duke vepruar në këtë mënyrë ai është pozicionuar edhe kundër një pjese të caktuar të popullit dhe në favor të një pjese tjetër, duke mos përfaqësuar më unitetin e popullit, pra tërësinë e tij.

158. Kuvendi parashtron se qasja e Presidentit ka qenë në dy drejtime. Në një pjesë të deklaratave, duke iu referuar zgjedhjeve të përgjithshme të datës 15.4.2021, ai i bën thirrje popullit për: *të shkuar me qetësi dhe vendosmëri drejt 25 prillit, i cili është një referendum popullor e historik për vendosjen e demokracisë dhe rrëzimin e sistemit oligarkik, jo thjesht rotacion, për rikthimin e një sistemi demokratik institucional, për dhënien e përgjigjes më 25 prill dhe marrjen në dorë të fatit të tij*, ose bën thirrje të tilla, si: *Shqipëria e shqiptarëve, koha i thërret shqiptarët për t'u bashkuar, që të mprehin sfurqet dhe se një votë po u prek do pritet një dorë*. Nga ana tjetër, ai ka bërë deklarata haptazi ndaj Kryeministrit, njëkohësisht kryetar i PS-së, partisë qeverisëse dhe kandidatëve e mbështetësve të saj, me gjuhë të papërshtatshme, të ashpër, me epitete fyese, të cilat janë edhe më të papranueshme kur bëhet fjalë për një figurë të lartë shtetërore që simbolizon shtetin. Fjalë të tilla të përdorura janë: *kryepalaço, lidheni të marrin, karagjoz, me probleme të mëdha mendore dhe psikike, vagabondë, horra dhe gangsterë, çetë me banditë, oligarkë arrogantë, regjimi i fuksave, horra të korruptuar, shkelës të ligjit, taksidarë të biznesit kriminal të votës* etj. (*shih për më tepër paragrafët 46 dhe 53 të vendimit të Kuvendit nr. 55/2021*). Të gjitha këto veprime përbëjnë shkelje të neutralitetit në zgjedhje, pasi në të dyja rastet synohet goditja e një force politike në favor të forcave të tjera.

159. Sipas Kuvendit, Presidenti, në të gjitha daljet e tij publike, media ose rrjete sociale, ka

kryer aktivitet politik duke ftuar popullin për të treguar "*maturi*" dhe "*rrëzuar regjimin në fuqi*". Përdorimi i termave si "*banda në pushtet*" dhe "*banda e rilindjes*", etiketimi i përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave si "*përfaqësues i Ndranghetas*", cilësimi i nevojës për përdorim të votimit në datën 25 prill si ditë referendumi që "*përfundon bandën në pushtet*", që janë thirrje të hapura kundër shumicës qeverisëse, të ngjashme me ato të përdorura nga liderët e partive opozitare apo etiketimet ndaj figurave të larta shtetërore si Kryeministri, deputetë ose drejtues politikë të shumicës qeverisëse në qarqe të caktuara me mesazhe denigruese e intimiduese, tregojnë anësi të qartë politike. Me sjelljen e tij Presidenti dështoi që të jetë Kryetar i Shtetit që përfaqëson unitetin e popullit, pasi dukshëm ka shkelur asnjanësinë duke u përfshirë në fushatë zgjedhore me rol aktiv kundër shumicës, në kundërshtim me detyrimin kushtetues për të qenë faktor neutral që nuk përfshihet në lojën e përditshme politike, por qëndron mbi palët dhe siguron funksionimin demokratik të institucioneve. Me këto qëndrime Presidenti ka humbur edhe funksionin e të qenit faktor ekuilibri në jetën politike të vendit. Këto qëndrime joasnjanëse dhe të paekuilibruara të Presidentit u vunë re dhe u referuan edhe në raportet e vëzhgimit të zgjedhjeve, të cilat duke qenë publike si brenda dhe jashtë vendit, kanë ndikim negativ dhe në imazhin e atij institucioni, çka e bën shkeljen edhe më serioze.

160. Presidenti në parashtrimet me shkrim dhe në seancë ka prapësuar se angazhimi dhe veprimtaria e tij kanë synuar realizimin e një procesi zgjedhor të qetë dhe sipas standardeve evropiane, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe dhënien e kontributit të nevojshëm për të frenuar e denoncuar çdo fenomen negativ që mund të shfaqej përgjatë gjithë kësaj periudhe. Në periudhën që lidhet me zgjedhjet e 25 prillit, Presidenti ka qenë i vetmi aktor institucional që ka mbrojtur realizimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe jashtë çdo presioni të çfarëdolloj forme. Nisur nga historiku i problematikave që kanë shoqëruar proceset zgjedhore në Shqipëri dhe duke vlerësuar angazhimin e strukturave vendore dhe qendrore publike të pushtetit në shërbim të partisë qeverisëse, e kthyer në partishtet në këtë garë elektorale dhe përpjekjet e saj për të diktuar rezultatin zgjedhor, Presidenti, në përputhje me rolin dhe funksionin e tij kushtetues, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për ruajtjen e dialogut të qëndrueshëm midis forcave politike; sensibilizimin dhe/apo trajtimin e çdo fakti ose rrethane që lidhet me përmirësimin e kushteve për respektimin e barazisë së votës; heqjen e çdo pengese për pjesëmarrjen në votime; denoncimin e çdo paligjshmërie. Presidenti për çdo rast, fenomen ose ngjarje që tregonte rritje të konfliktit ka mbajtur qëndrime të prera, të menjëhershme dhe publike, me qëllim normalizimin e situatës dhe realizimin e një procesi zgjedhor sa më të qetë dhe në interes të qytetarëve shqiptarë.

161. Presidenti ka prapësuar, gjithashtu, se nuk ka mbështetur asnjë subjekt politik garues në zgjedhje dhe ka qenë shumë kritik si ndaj partisë në pushtet, ashtu dhe ndaj opozitës, veçanërisht për veprimet e gabuara të lidershipit të saj lidhur me praktikën e bojkotit në përgjithësi dhe atë të reformës në drejtësi në veçanti, sidomos për përgjegjësinë historike për djegien e mandateve të deputetëve ose për mosmarrjen pjesë në zgjedhjet vendore. Ai ka treguar në vijimësi një qëndrim shumë të qartë, të provuar, të statusit si moderues, paqtues dhe konstruktiv midis forcave politike, pa mbivlerësuar e nënvlerësuar asnjë subjekt politik, duke pasur si moto barazinë e tyre përpara ligjit dhe respektimin e parimeve të demokracisë dhe vlerave më të larta morale dhe shoqërore. Forma, argumentimi, toni, ngjyrimi individual ose emocional, janë padyshim të drejta të patjetërsueshme të ushtrimit të lirisë së fjalës, në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe atij kombëtar, si dhe respektit ndaj Kushtetutës dhe ligjit, të cilat kanë qenë dhe mbeten thelbi i përmbajtjes së çdo komunikimi publik të Presidentit. Thirrjet e Presidentit për mbrojtjen e votës lidhen me garantimin e votës së lirë dhe shmangien e rrezikut të shitblerjes së saj, si fenomene të rënda të së shkuarës në Shqipëri. Keqkuptimi, me ose pa dashje, i qëndrimeve të Presidentit vjen prej zhvendosjes së qëllimshme të disa termave nga konteksti i plotë i ngjarjeve dhe i rrethanave.

162. Sipas Presidentit, e rëndësishme dhe e domosdoshme është që vetëpërmbajtja e tij të udhëhiqet nga interesi më madhor i vendit,

mbrojtja e Kushtetutës, si edhe nga proporcionaliteti që diktohet nga rrethanat konkrete dhe sjelljet e aktorëve të tjerë. Vetëpërmbajtja dhe qëndrimi institucional kushtetues, si dhe baraslargimi nga forcat politike kanë qenë karakteristikat thelbësore të sjelljes së tij përballë një situate krize të njohur botërisht si anormale. Ka qenë Kryeministri ai që e ka përfshirë Presidentin në fushatë politike, siç është rasti kur gjatë fushatës ai ka vendosur kandidaten për deputete të PS-së përballë Presidentit, duke e konsideruar këtë të fundit si deputet ose kandidat për zgjedhje, ose rasti i përdorimit të materialeve propagandistike me përmbajtje fyese dhe përçmuese *(billborde),* që shfaqnin drejtuesit e opozitës dhe vetë Presidentin, të cilat u vendosën në vende publike në disa qytete, në kundërshtim me nenin 79 të Kodit Zgjedhor. Deklaratat dhe denoncimet publike e shkresore të Presidentit kanë qenë në përpjesëtim me situatën e rëndë parazgjedhore dhe në funksion të parandalimit të përshkallëzimit dhe daljes së saj jashtë kontrollit.

163. Gjykata vëren se neni 86, pika 1, i Kushtetutës parashikon se Presidenti është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit, kurse sipas nenit 89 të saj, ai nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private. Detyra e tij si përfaqësues i unitetit të popullit është të mbikëqyrë funksionimin normal të mekanizmave kushtetues, duke ndërhyrë për eliminimin e mangësive në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 64, datë 23.9.2015; nr. 10, datë 26.2.2015; të Gjykatës Kushtetuese*).

164. Kushtetuta, duke ndjekur modelin e republikës parlamentare, e ka konceptuar Presidentin me pozitë neutrale, mbi palët *(super partes)*, me rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, balancimin e pushteteve dhe kryerjen e funksioneve të tyre respektive, që lidhet edhe me procedurën e zgjedhjes së tij nga shumica parlamentare të nevojshme dhe përmes raundeve të votimit. Presidenti nuk duhet të investohet politikisht, ai nuk duhet të shihet as si pjesë e drejtpërdrejtë e ekzekutivit dhe as si pjesë e drejtpërdrejtë e partive politike, por si një arbitër kushtetues, i cili vetëm në këtë pozicion mund të zgjidhë krizat institucionale dhe të bëhet garant i Kushtetutës. Pavarësisht se nuk merr vendime politike, Presidenti ka ndikim në jetën politike të vendit, në përputhje me këtë rol që Kushtetuta i ka caktuar. Kështu, në rastet kur vendimet iniciohen nga organe të tjera kushtetuese, Presidenti, brenda parametrave kushtetues, bashkëvepron me këto organe dhe në raste të caktuara i nxit ato të reflektojnë për veprimet ose aktet e tyre (*shih vendimin nr. 26, datë 25.5.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

165. Gjykata konstaton se për përmbushjen e rolit të tij, Kushtetuta i ka atribuuar Presidentit një sërë kompetencash, të shpërndara në pjesë të ndryshme të saj, të cilat mbulojnë fusha të caktuara, me qëllim që t'i lejojnë të veprojë brenda sferës së këtyre kompetencave për garantimin e Kushtetutës dhe ekuilibrimin e pushteteve, në veçanti kur organet shtetërore nuk veprojnë ose kur përfshihen në situata konflikti. Në këto raste, ai nxit organet për marrjen e vendimeve në lidhje me një çështje konkrete ose zhbllokimin e situatës, pa i zëvendësuar ato, por duke mbështetur funksionet e tyre kushtetuese, në mënyrë që këto të fundit të ushtrohen normalisht.

166. Megjithatë, siç ka theksuar Komisioni i Venecias, atributet që Kushtetuta i jep Presidentit nuk nënkuptojnë që autoriteti i tij është mbi politikën. Ato më saktë nënkuptojnë se Presidenti duhet të mbetet jashtë politikës partiake, me qëllim që të sigurojë, ndër të tjera, një konkurrencë të ndershme midis palëve dhe funksionimin e rregullt të formës së qeverisjes dhe të veprimtarive të tjera të shtetit. Në sistemet parlamentare objektivat që Presidenti duhet të ndjekë perceptohen se qëndrojnë mbi ato të politikës. Nga kjo rezulton se, në ushtrimin e këtyre kompetencave, Presidenti jo vetëm që duhet të sillet në mënyrë të paanshme, por edhe duhet të shihet që sillet në këtë mënyrë (*shih opinionin e Komisionit të Venecias CDL-AD(2019)019, paragrafët 40-42 dhe 55).* Në shumicën e sistemeve parlamentare, Kryetari i Shtetit luan rolin e arbitrit ose të *pouvoir neutre*, pra i shkëputur nga politikat partiake. Ndërsa askush nuk mund ta pengojë Kryetarin e Shtetit të ketë pikëpamjet dhe simpatitë e veta politike, mandati i tij është i kufizuar (*shih opinionin e Komisionit të Venecies CDL-AD(2017)014, paragrafi 20).*

167. Duke iu referuar standardeve të mësipërme, nën dritën e përgjegjësisë kushtetuese të Presidentit, Gjykata çmon se për të përcaktuar rolin dhe pozicionin e Presidentit në procesin zgjedhor, duhet analizuar kuptimi i parashikimeve të nenit 86, pika 1, të Kushtetutës bashkërisht me parashikimet e nenit 89 të saj.

168. Neni 86, pika 1, i Kushtetutës përcakton pozicionin e Presidentit në strukturën kushtetuese. Ai simbolizon qytetarin e parë të vendit dhe i ushtron kompetencat e tij në mënyrë të tillë që të ndihmojë, nxisë, komunikojë dhe bashkëveprojë me organet dhe subjektet e ndryshme, të cilave Kushtetuta u beson funksionet e drejtimit politik ose të garancive kushtetuese, me qëllim që të respektohen dhe mbrohen vlerat e parashikuara në ligjin themelor sipas parimit se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit (neni 4 i Kushtetutës). Për sa i takon rolit përfaqësues të unitetit të popullit, Gjykata vëren se ai përmbledh detyra të Presidentit jo vetëm në drejtim të unitetit territorial të shtetit, që përcaktohet qartësisht në Kushtetutë (neni 1, pika 2, i saj), por sidomos në drejtim të strukturës së rendit kushtetues, si përfaqësues i vullnetit të popullit dhe i interesit të përgjithshëm të shtetit, në mënyrë që pushtetet të funksionojnë në mënyrë harmonike dhe në kohezion të plotë, pra të përmbushin përgjegjësitë dhe të mos tejkalojnë pushtetet e tyre e të mos veprojnë në mënyrë të plogësht. Thënë ndryshe, kur organet kushtetuese përfshihen në situata konfliktuale, që vënë në rrezik garancitë kushtetuese, Presidenti luan rol ekuilibrues dhe duhet të ndërhyjë, si organ moderues dhe nxitës i pushteteve, duke evidentuar dhe rekomanduar atyre parimet që mund të ofrojnë zgjidhje të pranueshme. Për këtë qëllim, krahas nxjerrjes së akteve formale në përmbushje të detyrës, Presidenti mund të kryejë edhe veprimtari informale, të tilla si takime dhe komunikime. Me anë të kësaj veprimtarie ai, në mënyrë diskrete, ushtron "influencën" e autoritetit të tij për të bindur organet kushtetuese të marrin masa konkrete, të cilat ndikojnë pozitivisht në marrëdhëniet ndërmjet pushteteve të shtetit, duke u dhënë zgjidhje ngërçeve ose bllokimeve që ndodhin në jetën politike e institucionale.

169. Në vijim, Gjykata vëren se neni 86, pika 2, i Kushtetutës si kushte ndalimi në procedurën e zgjedhjes së Presidentit nuk ka vendosur ushtrimin e funksionit politik, mbajtjen e pozicioneve drejtuese në parti politike (sikurse shprehimisht parashikohen për funksionarë të tjerë publikë në nenet 125, pika 5, 136, pika 4, 147, pika 3, 147/d, pika 3, 148/a, pika 3, 149, pika 3, të Kushtetutës, si dhe nenin C, pika 5, të Aneksit të saj) dhe as anëtarësinë e kandidatit për president në një parti politike. Për më tepër, duke iu referuar praktikës parlamentare, konstatohet se kandidatët e propozuar dhe të zgjedhur në detyrën e Presidentit kanë ardhur pothuajse në të gjitha rastet nga radhët e anëtarëve të partive politike, me profil politik të dallueshëm. Kjo është e shpjegueshme, pasi, siç është evidentuar edhe gjatë procesit të hartimit të Kushtetutës, zgjedhja e Presidentit nuk është një garë në të cilën shfaqen cilësitë personale të kandidatëve, por më tepër rezultat i negociatave partiake (*Debati kushtetues, Vëllimi I, faqe 341*).

170. Gjykata pranon se, në parim, ushtrimi nga Presidenti i një roli aktiv në jetën politike dhe shoqërore të vendit nuk mund të konsiderohet sjellje në kundërshtim me Kushtetutën. Mënyra e ushtrimit të funksionit varet edhe nga personaliteti, individualiteti i Presidentit, mënyra si ai e koncepton, interpreton dhe zgjedh ta ushtrojë atë, pra duke zgjedhur të ketë një qasje të përmbajtur ose aktive, gjithnjë brenda kuadrit të kompetencave të tij kushtetuese.

171. Megjithatë, pas marrjes së funksionit, Presidenti duhet të gjejë pozicionin që dikton Kushtetuta për rolin neutral, pasi ai nuk përfaqëson më interesat e partisë politike, anëtar i së cilës mund të ketë qenë, por interesat e përgjithshme të vendit. Është e logjikshme dhe e pritshme që qytetarët të besojnë se Presidenti i tyre, në rolin e Kryetarit të Shtetit dhe përfaqësuesit të unitetit të popullit, do t'i përfaqësojë të gjithë ata dhe jo vetëm pjesën që mbështet një fragment të caktuar politik partiak.

172. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Presidenti duhet t'i përmbahet parimit të neutralitetit, të qëndrojë mbi politikat partiake, pasi ai është Kryetari i Shtetit dhe përfaqëson interesat e përgjithshme të vendit dhe jo interesa partiake. Nga ana tjetër, ndalimi i parashikuar në nenin 89 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidenti

nuk mund të jetë anëtar partie politike, është i lidhur me rolin dhe pozicionin e tij, sepse reflekton kërkesën kushtetuese për të qenë mbi të gjitha palët, por, gjithashtu, edhe për të garantuar kushtetutshmërinë brenda kompetencave të veta kushtetuese. Në kontekstin e procesit zgjedhor, ai, duke ruajtur asnjanësinë politike, njëherazi nxit dhe moderon organet dhe subjektet e ndryshme që kanë funksione të caktuara në këtë proces, me qëllim realizimin e tij në përputhje me standardet kushtetuese. Vetëm duke respektuar ndalimin kushtetues "të mos jetë anëtar partie", Presidenti përmbush kërkesat për neutralitet të parashikuara nga Kushtetuta, që janë premisë që veprimtaria e tij të jetë në përputhje me interesin e përgjithshëm publik, jashtë linjave partiake.

173. Gjykata vëren se ndalimi për të qenë anëtar i një partie politike, në kuptimin substancial, e ndalon Presidentin të kryejë veprimtari në mbështetje të një partie të caktuar politike apo që gjatë fushatës zgjedhore të ndërhyjë dhe të deformojë formimin e opinionit publik, duke cenuar konkurrimin e ndershëm dhe vlerësimin e drejtë të partive politike dhe kandidatëve. Përndryshe, një veprimtari e tillë do të cenonte parimin themelor të qeverisjes në demokracinë tonë parlamentare, të sanksionuar nga neni 1, pika 3, i Kushtetutës, sipas të cilit qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike. Parimi i zgjedhjeve të lira nuk do të thotë vetëm se votuesit duhet të jenë në gjendje të votojnë pa pasur ndikim të detyruar ose të padrejtë nga shteti ose shoqëria, por, gjithashtu, që votuesit duhet të jenë në gjendje të gjykojnë dhe marrin vendimet e tyre në mënyrë të informuar, në një proces të lirë për të formuar opinionet e tyre. Ky parim, në kontekstin e rolit neutral të Presidentit, nënkupton detyrimin e tij për të ruajtur asnjanësinë politike, pra ndalimin e tij për të mbështetur ose kundërshtuar ndonjë parti ose përfaqësues të veçantë politik që garon si kandidat në zgjedhje.

174. Gjykata thekson se, në parim, funksionarët publikë, si çdo individ, gëzojnë lirinë e shprehjes të garantuar nga neni 22, pika 1, i Kushtetutës, që përfshin edhe të drejtën për të kritikuar institucionet shtetërore ose nëpunësit e tyre. Në këtë këndvështrim, opinionet, gjykimet vlerësuese ose deklaratat kritike të Presidentit, si mbajtës i funksionit më të lartë publik të shtetit, kur i drejtohen autoriteteve të tjera publike, mbeten në kufijtë e lirisë së shprehjes së opinioneve politike, me kufizimet e parashikuara nga Kushtetuta. Kjo e fundit i ka njohur Presidentit të drejtën të drejtojë mesazhe, me të cilat tërheq edhe vëmendjen e opinionit publik për çështje të caktuara, ose të kërkojë mendim e informacione nga institucionet shtetërore (neni 92, shkronjat "a" dhe "h" të Kushtetutës). Megjithatë, marrëdhëniet institucionale në jetën publike duhet të kryhen në forma të qytetëruara dhe me tone të moderuara, nga Presidenti dhe nga të gjithë pjesëmarrësit, në mënyrë që të sigurohet dinjiteti njerëzor, bashkëjetesa dhe mirëkuptimi, të cilat Kushtetuta në nenin 3 i përcakton si vlera themelore që duhen promovuar, në veçanti midis pjesëve të ndara të shoqërisë. Ligjërimi publik duhet të jetë i matur dhe i pranueshëm nga shoqëria, si dhe brenda disa kufijve, të cilët varen edhe nga shkalla e emancipimit të saj e nga konteksti historik në të cilin bëhet ai.

175. Bazuar në sa më sipër, duke analizuar veprimet e Presidentit gjatë procesit zgjedhor të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2021, Gjykata do të ndalet në vlerësimin nëse ato përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës, në kuptim të nenit 90, pika 2, të Kushtetutës.

176. Gjykata vëren fillimisht se Presidenti, në kuptimin e ngushtë të përmbajtjes së nenit 89 të Kushtetutës, gjatë ushtrimit të detyrës së tij nuk ka qenë formalisht anëtar i ndonjë partie politike, pasi ka hequr dorë prej saj kur u zgjodh dhe bëri betimin solemn para Kuvendit. Megjithatë, duke qenë se, siç arsyetohet më sipër, parashikimi kushtetues nuk nënkupton cilësinë formale të anëtarit partiak, por edhe ndalimin substancial, sipas të cilit Presidenti gjatë ushtrimit të detyrës nuk mund të kryejë veprimtari politike partiake, Gjykata vlerëson se premisa nga e cila duhet të niset për të arritur në një përfundim të drejtë në lidhje me këtë çështje është përmbajtja dhe konteksti i deklaratave dhe veprimeve të Presidentit. Për këtë, ajo do të analizojë nëse deklaratat e Presidentit kanë mbështetur ose favorizuar një parti ose forcë politike, të cilat të kryera gjatë procesit zgjedhor kanë ndikuar në fushatë dhe në rezultatin e zgjedhjeve në favor

dhe mbështetje të një partie ose kundër një partie tjetër.

177. Ndonëse Kuvendi në argumentimin e kësaj shkeljeje i është referuar akteve/qëndrimeve të Presidentit që lidhen me fushatën e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të datës 25.4.2021, e cila, siç edhe është evidentuar në rrethanat e kësaj çështjeje në hyrje të vendimit, është paraprirë nga një situatë krize politike dhe institucionale që ka shoqëruar Legjislaturën IX të Kuvendit përgjatë mandatit të saj, Gjykata vlerëson se situata ka qenë e karakterizuar nga një mjedis politik i polarizuar dhe me shfaqje të mungesës së besimit të ndërsjellë midis aktorëve politikë. Tensioni, veçanërisht mes Presidentit dhe Kuvendit, ka kulmuar me disa përplasje të ashpra publike dhe institucionale mes palëve gjatë gjithë kësaj periudhe, ndër të cilat mund të përmenden mosmarrëveshjet për shtyrjen nga ana e Presidentit të datës së zgjedhjeve vendore dhe për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që u shoqëruan me miratimin nga Kuvendi të rezolutave për secilin rast dhe të nismës për hetimin e Presidentit, si dhe vënien në lëvizje nga të dyja palët të Komisionit të Venecies.

178. Në vijim të kësaj klime, edhe fushata e zgjedhjeve parlamentare të përgjithshme të vitit 2021 u karakterizua nga shkëmbimi me nota të theksuara antagonizmi i mesazheve politike mes palëve politike dhe institucioneve. Misioni i kufizuar i OSBE/ODIHR-it, që vëzhgoi zgjedhjet parlamentare, evidentoi problematika në lidhje me përfshirjen në fushatë të ministrave, që i dha partisë në pushtet avantazh të konsiderueshëm; pretendimet shqetësuese për dhënie stimujsh dhe presione ndaj nëpunësve civilë; pretendimet për shitblerje të votave; rrjedhjen dhe shpërndarjen e të dhënave personale sensitive të shtetasve para zgjedhjeve, duke përfshirë edhe preferencat e tyre politike, që mund të dëmtojnë besimin e elektoratit edhe te fshehtësia e votës; urdhrin e ministrit të Shëndetësisë, për të cilin Avokati i Popullit rekomandoi shfuqizimin, pasi pamundësonte të drejtën e emigrantëve shqiptarë që banonin ose hynin nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia për të votuar, për shkak të COVID 19; procedimet penale për një sërë çështjesh që lidhen me presionin mbi subjektet zgjedhore, falsifikimin e materialeve zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve, shkeljen e fshehtësisë së votimit, shitblerjen e votës dhe korrupsionin; mungesën e thellësisë së diskutimeve në lidhje me problematikat e vendit; përdorimin e mesazheve publike që shpesh përqendroheshin te figura e liderëve kryesorë të partive; përdorimin e posterave/*billbordeve* me përmbajtje fyese dhe negative për të përçmuar liderët e opozitës, duke përfshirë edhe Presidentin; tonet konfrontuese dhe gjuhën agresive (*shih raportin përfundimtar të OSBE/ODHIR-it, faqet 2, 3, 16, 17, 19, 25 dhe 27*).

179. Në lidhje me aktet e Presidentit, në raportin përfundimtar për vëzhgimin e zgjedhjeve, OSBE/ODIHR-i ka konstatuar, ndër të tjera: "*Toni i gjuhës së përdorur gjatë fushatës nga disa udhëheqës partie dhe, në veçanti, nga Presidenti, ishte konfrontues. Ndonjëherë gjuhë agresive u përdor edhe në seksionet e komenteve në rrjetet sociale... Në cilësinë e tij zyrtare, Presidenti bëri fushatë kundër partisë në pushtet. Presidenti Meta, ish-kryetari i LSI-së, shfaqi një marrëdhënie të tensionuar publike me Kryeministrin Rama dhe ndërmori disa iniciativa lidhur me zgjedhjet dhe kritikoi publikisht qeverinë, duke përdorur një gjuhë të ashpër...*" (*shih faqet 3, 5 dhe 16*). Po në këtë drejtim, në deklaratën e gjetjeve paraprake për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të KRIIK-ut, teksa nga njëra anë pohohet se: "*Retorika e ashpër, gjuha denigruese ndaj kundërshtarit, akuzat dhe kundërakuzat për blerje vote karakterizuan fushatën në linjë me sjelljen e subjekteve zgjedhore në fushatën e parakohshme. Krijimi i këtij debati pa përmbajtje, gjatë fushatës elektorale, veçse solli anashkalimin e vëmendjes nga planet dhe programet konkrete të partive politike garuese në këtë proces, të cilat nga ana tjetër munguan dhe nuk u bënë formalisht publike*", konstatohet edhe se: "*Me një retorikë të ashpër në fushatën elektorale u përfshi edhe Presidenti i vendit, i cili u angazhua haptas në fushatë kundër shumicës aktuale dhe, personalisht, Kryeministrit Rama, duke u pozicionuar si një konkurrent elektoral dhe jo si një figurë mbi palët*" (*shih faqen 5).*

180. Gjykata konstaton se para dhe gjatë fushatës zgjedhore, Presidenti, në mënyrë të përsëritur, ka mbajtur qëndrim publik për procesin zgjedhor, që është materializuar, sipas vendimit nr. 55/2021 të Kuvendit, në rreth 19 emisione televizive, 9 deklarata për mediet dhe

45 postime në rrjetet sociale. Ky qëndrim ka në përmbajtje mesazhe publike të Presidentit me anë të të cilave i bën thirrje popullit të shkojë në votime që të ndodhë rotacioni i pushtetit qeverisës me anë të zgjedhjeve parlamentare, pasi, sipas tij, duhet të "*rikthehet sistemi demokratik institucional*".

181. Gjykata vëren se Presidenti ka filluar jetën politike prej vitit 1990 dhe përgjatë periudhës që ka ushtruar veprimtarinë politike ka mbajtur edhe pozicione drejtuese në parti politike (nënkryetar partie, themelues dhe kryetar i një partie politike), si dhe funksione politike në organet e pushtetit ekzekutiv dhe ligjvënës (sekretar shteti, ministër, zëvendëskryeministër, kryeministër, deputet në të gjitha legjislaturat që prej vitit 1992, si dhe Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë) dhe së fundi u zgjodh President, ndërkohë që ushtronte funksionin e Kryetarit të Kuvendit dhe njëherazi atë të kryetarit të një partie politike parlamentare.

182. Gjykata, duke analizuar qëndrimet e Presidentit, vlerëson fillimisht se qasja e tij në ushtrimin e këtij funksioni të lartë nuk ka qenë e përmbajtur, pasi ai ka ushtruar rol aktiv në jetën politike dhe shoqërore të vendit, në veçanti gjatë fushatës zgjedhore. Kjo lidhet edhe me personalitetin dhe të shkuarën politike të tij. Gjykata rithekson se Presidenti dhe çdo pjesëmarrës në jetën publike duhet të komunikojë me respekt të ndërsjellë, në mënyrë që të dëshmojë tek të gjithë qytetarët se vepron për të promovuar dinjitetin njerëzor, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin, si vlera themelore të shoqërisë.

183. Gjykata, nisur nga faktet e paraqitura, si dhe raportet e organizatave monitoruese të zgjedhjeve, vëren se në periudhën pararendëse dhe veçanërisht përgjatë fushatës zgjedhore gjuha e deklaratave të Presidentit ndaj Kryeministrit dhe shumicës qeverisëse ka qenë agresive dhe përmbante epitete fyese e metafora me frymë negative, si dhe fjalor të papërshtatshëm. Ajo vëren, gjithashtu, se kjo gjuhë agresive është përdorur gjatë fushatës edhe nga udhëheqës të tjerë partish në deklaratat dhe qëndrimet e tyre, dhe se figura e Presidentit është bërë objekt diskutimi me elektoratin në fushatë nga Kryeministri, njëkohësisht Kryetar i PS-së, duke e krahasuar me kandidatë për deputetë të kësaj partie, si dhe duke përcjellë mesazhe negative nëpërmjet materialeve zgjedhore (tabelave informuese), ku është përdorur edhe imazhi i tij, të vendosura nga subjekti zgjedhor PS në vende publike, në disa qytete.

184. Palët kanë treguar qasje dhe këndvështrime të ndryshme në lidhje me këtë veprimtari politike të Presidentit përgjatë procesit zgjedhor. Kuvendi, nga njëra anë, pretendon se ajo është e llojit partiak, pasi ai nuk është sjellë si përfaqësues i popullit, nuk ka qenë asnjanës dhe nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe me drejtuesit e partive të opozitës, përkundrazi, duke përdorur gjuhën e këtyre të fundit, veprimet/deklaratat e Presidentit janë drejtuar qartësisht kundër partisë në pushtet, drejtuesve e kandidatëve të saj, me synim ndikimin e rezultatit zgjedhor. Ndërsa Presidenti, nga ana tjetër, pretendon se ka vepruar në kontekstin e një krize të thellë politike, të kapjes së shtetit dhe mosfunksionimit të disa institucioneve kushtetuese, me synim ruajtjen e integritetit të zgjedhjeve dhe se ai i është kundërpërgjigjur Kryeministrit, që e ka përfshirë në fushatën zgjedhore, duke e paraqitur si pjesë të grupit të kandidatëve për deputetë dhe të drejtuesve politikë të opozitës.

185. Gjykata vëren se qëndrimet dhe deklaratat e Presidentit janë mbajtur në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të përgjithshme, të cilat kanë natyrë thellësisht politike, pasi përmes tyre materializohet demokracia e drejtpërdrejtë, si dhe përforcohet stabiliteti dhe legjitimiteti i qeverisjes. Me anë të zgjedhjeve, qytetarët ushtrojnë të drejtën për të votuar dhe zgjedhur përfaqësuesit politikë të tyre, bazuar në konkurrimin e drejtë dhe të barabartë të partive dhe programeve politike që ato ofrojnë.

186. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se, edhe në kontekstin e rolit aktiv që ka zgjedhur të mbajë Presidenti gjatë mandatit të tij kushtetues, qëndrimi i tij në ushtrim të detyrës, ndërkohë që ka qenë i veshur me petkun zyrtar të Kryetarit të Shtetit, i materializuar në deklarata dhe postime të shumta nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik dhe në përmbajtje me mesazhe politike, para dhe gjatë fushatës zgjedhore, përbën veprimtari me natyrë politike. Gjykata nuk mund të diktojë mënyrën se si duhet të sillet ose komunikojë Presidenti në një kontekst të caktuar

politik apo historik, por ajo thekson se teksti kushtetues, praktika kushtetuese e krijuar ndër vite që reflekton mënyrën se si është ushtruar ky funksion, pritshmëritë e popullit, të palëve dhe aktorëve politikë si dhe vetëdija e arsyeshme e vetë Presidentit në lidhje me rolin e tij, janë elementet që përcaktojnë mënyrën se si duhet të sillet, madje edhe si duhet të shihet ai.

187. Gjithsesi, Gjykata niset nga premisa se shkak për shkarkimin e Presidentit është shkelja e rëndë e Kushtetutës ose krimi i rëndë, e cila, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër (*shih paragrafët 144-149 të vendimit*), që të konsiderohet e tillë duhet jo vetëm të bjerë ndesh me një parashikim/ndalim kushtetues, për rrjedhojë të cenojë një marrëdhënie, vlerë ose çështje që mbrohet në mënyrë të shprehur nga Kushtetuta, por edhe të provohet në drejtim të pasojave dhe efekteve reale në jetën e vendit, si dhe të natyrës së pakthyeshme e pamundësisë së riparimit të dëmit kushtetues përveçse me shkarkimin e Presidentit nga detyra. Duke ritheksuar se shkarkimi i Presidentit ndërhyn në mënyrë të pazakontë në funksionimin e rendit kushtetues, si një ngjarje përjashtimore, që synon të mbrojë Kushtetutën në atë masë që përfitimet e mbrojtjes së saj të kenë epërsi mbi humbjen që do t'i shkaktonte vendit shkarkimi i tij, në rastin konkret veprimtaria e Presidentit me natyrë politike, pavarësisht nëse ka qenë ose jo edhe partiake[2], nuk rezulton të ketë sjellë pasoja dhe efekte reale në drejtim të cenimit të thelbit të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, veçanërisht atyre që zbatohen gjatë procesit zgjedhor, të rendit kushtetues ose funksionimit të institucioneve të shtetit, në përmasa të atilla që do të diktonin vënien para përgjegjësisë kushtetuese të Presidentit dhe do të justifikonin shkarkimin e tij nga detyra. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se veprimtaria politike e Presidentit para dhe gjatë fushatës zgjedhore nuk konsiderohet si shkelje e rëndë e Kushtetutës.

188. Kuvendi ka pretenduar, gjithashtu, se Presidenti ka ndërhyrë në procesin zgjedhor, duke shkelur nenin 15, pika 2, të Kushtetutës, pasi nuk ka respektuar të drejtën kushtetuese për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, të garantuar nga neni 45 i saj, si dhe ka shkelur edhe nenin 18, pika 2, të Kushtetutës, pasi ka shfaqur sjellje diskriminuese që lidhen me bindjet politike. Thirrjet drejtuar zgjedhësve në mesazhet e tij gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e heshtjes zgjedhore, në media ose rrjete sociale, nuk mund të mos ndikonin te votuesit në formimin e vullnetit të tyre. Artikulimi i Presidentit në mesazhet dhe deklaratat e tij ngjason me thirrjet që subjektet garuese, veçanërisht PD-ja dhe LSI-ja, kanë bërë gjatë fushatës zgjedhore kundër PS-së dhe shumicës në pushtet, edhe pse roli i tij kushtetues dhe pozicioni i tij neutral e ndalonin të përfshihej në këtë garë politike.

189. Presidenti ka prapësuar se e gjithë veprimtaria e tij ka qenë një dëshmi e qartë e qëndrimit mbi palët dhe ai jo vetëm publikisht, por me të gjitha instrumentet ligjore, ka sensibilizuar institucionet shtetërore dhe forcat politike për realizimin e një procesi zgjedhor të lirë, të ndershëm, të barabartë dhe pa presione. Angazhimi i Presidentit për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe parandalimin e ngjarjeve të rënda, për shkak të prekjes së votës, është i evidentuar dhe ai nuk ka pasur asnjë shqetësim nga asnjë organ, përfshirë KQZ-në, si institucioni që sipas Kodit Zgjedhor është administratori dhe realizuesi i vetëm i proceseve zgjedhore në Shqipëri. Për shkak të situatës në të cilën u zhvilluan zgjedhjet dhe problematikave të shfaqura në drejtim të cenimit të të drejtave të qytetarëve dhe pasojave të ardhura, të faktuara edhe nga OSBE/ODHIR-i, procesi zgjedhor e ka humbur legjitimitetin e tij.

190. Gjykata, duke ritheksuar se nuk është e detyruar t'i përmbahet strukturës së vendimit të Kuvendit që e ka vënë atë në lëvizje dhe as cilësimit juridik – "shkelje të detyrimeve që burojnë nga betimi mbi Kushtetutë, sipas nenit 88, pika 3 të saj", që ai u ka dhënë këtyre fakteve, i cilësoi ato si pjesë të detyrimeve kushtetuese të Presidentit që rrjedhin nga përmbajtja e neneve 86, pika 1 dhe 89 të Kushtetutës, të analizuara

[2] Mbajtën qëndrimin se veprimtaria politike e Presidentit është partiake, pra në *shkelje* të neneve 89 dhe 86, pika 1, të Kushtetutës gjyqtarët: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Altin Binaj dhe Përparim Kalo. Mbajtën qëndrimin se veprimtaria politike e Presidentit nuk është partiake, pra nuk ka *shkelje* të neneve 89 dhe 86, pika 1, të Kushtetutës gjyqtarët: Vitore Tusha, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja.

më lart. Në këtë pikëpamje, me të njëjtin arsyetim, Gjykata vlerëson se faktet që mbështesin pretendimet për cenimin e neneve 15, pika 2, 18, pika 2 dhe 45 të Kushtetutës gjatë procesit zgjedhor, që lidhen me të drejtën për të zgjedhur, si e drejtë kushtetuese e zgjedhësve, dhe atë për t'u zgjedhur, si e drejtë e subjekteve zgjedhore, si dhe parimin e barazisë ndërmjet subjekteve zgjedhore, nuk përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës.

191. Si përfundim, për sa më sipër, Gjykata vlerëson se faktet e paraqitura si shkelje të neneve 86, pika 1 dhe 89 të Kushtetutës nuk përbëjnë shkelje të rënda të Kushtetutës.

Ç.2.2.2 Shkeljet e nenit 88, pika 3, të Kushtetutës

192. Kuvendi ka parashtruar se Presidenti ka kryer shkelje të nenit 88, pika 3, të Kushtetutës, pasi nuk i është bindur Kushtetutës dhe ligjeve, nuk ka respektuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, si dhe nuk i ka shërbyer pavarësisë së Republikës së Shqipërisë dhe interesit të përgjithshëm të popullit. Presidenti në ushtrimin e veprimtarisë së tij i nënshtrohet parimit të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, i cili zbatohet edhe kur ai mban qëndrime publike në intervista, konferenca shtypi, publikime në media ose rrjete sociale. Edhe pse Presidenti, si çdo funksionar i lartë shtetëror, ka të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të kritikës, kur e ushtron atë duhet të jetë i vetëpërmbajtur e jokonfliktual me institucionet e tjera kushtetuese dhe ligjore. Për më tepër, gjuha e Presidentit, si faktor ekuilibri në jetën politike të vendit dhe përfaqësues i unitetit kombëtar, duhet të jetë korrekte, jodiskriminuese, të mos nxisë urrejtje, përçarje dhe, sidomos, të mos nxisë dhunë. Çdo sjellje e kundërt përbën shkelje të rolit të tij si përfaqësues i unitetit të popullit.

193. Presidenti ka prapësuar se nuk ka shkelur formulën e betimit, por ka respektuar Kushtetutën dhe të drejtat themelore të qytetarëve, pavarësinë e shtetit dhe interesin e përgjithshëm, parimet e shtetit të së drejtës dhe ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve dhe se pretendimet e Kuvendit janë ngritur me një objektiv të paravendosur, të paracaktuar dhe të paragjykuar. Qëndrimet e Presidentit janë diktuar nga kriza politike dhe situata në vend dhe kanë pasur qëllim mbrojtjen e së drejtës së votës dhe garantimin e standardeve të procesit zgjedhor. Edhe për metaforat e përdorura prej tij në shfaqjet publike, Presidenti ka argumentuar se janë bazuar në besimin e tij të shfaqur publikisht në shumë raste për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe ndalimin e cenimit të tyre nga organet e pushtetit. Ai është bazuar në kompetencën dhe detyrimin që i buron nga statusi kushtetues për të mbikëqyrur funksionimin e mekanizmave kushtetues dhe në të drejtën për të ndërhyrë, kur është e nevojshme, për të siguruar respektimin e Kushtetutës. Presidenti ka shprehur shqetësimet e tij, ndaj gjitha institucioneve shtetërore dhe subjekteve politike, sa herë ka konstatuar se me veprimtarinë e tyre kanë dalë jashtë kornizës kushtetuese dhe ligjore, veçanërisht gjatë periudhës së zgjedhjeve ku situata politike shoqërore u rëndua dukshëm.

194. Neni 88, pika 3, i Kushtetutës parashikon: "*Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i Presidentit që largohet. Presidenti bën këtë betim: "Betohem se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t'i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar.". Presidenti mund të shtojë edhe: "Zoti më ndihmoftë!"*".

195. Gjykata vlerëson të ndalet fillimisht te vlera kushtetuese që ka formula e betimit. Detyrimi për betim synon të përcaktojë momentin kur nis ushtrimi i funksionit të Presidentit dhe konfirmohet legjitimiteti i mandatit të tij. Kushtetuta në nenin 88, pika 3, e bën të qartë se betimi i Presidentit është parakusht për nisjen e ushtrimit të funksionit. Gjykata vëren se Kushtetuta nuk e përcakton shkeljen e betimit si shkak të veçantë për shkarkimin e Presidentit nga detyra, në ndryshim nga sisteme të tjera kushtetuese, siç është ai i Lituanisë, që referohet nga Kuvendi në vendimin e shkarkimit. Për më tepër, qasja për të pranuar shkeljen e betimit si shkak të mjaftueshëm për shkarkimin e Presidentit, do të passillte shkarkim të Presidentit nga detyra edhe nëse verifikohej shkelja e ligjeve prej tij, meqë në përmbajtje të betimit ai angazhohet për t'iu bindur jo vetëm Kushtetutës por edhe ligjeve. Gjykata çmon se shkelja e betimit nuk përbën shkak autonom të përgjegjësisë kushtetuese të Presidentit, që do të thotë se mundësia e shkeljes së betimit nga ana e

Presidentit lidhet me shkeljen e rëndë të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se betimi është një premtim publik solemn i Presidentit, se ai merr përsipër detyrën duke pranuar, njëkohësisht, me vetëdije të plotë se nuk është mbi Kushtetutën dhe ligjet, se do të veprojë për të promovuar liritë dhe të drejtat e qytetarëve, për të mbrojtur pavarësinë dhe shërbyer interesit dhe përparimit të përgjithshëm. Për rrjedhojë, kur Presidenti kryen akte antikushtetuese dhe vërtetohen kriteret e shkeljes së rëndë të Kushtetutës, betimi shërben si tregues i fortë i vetëdijes së Presidentit, pra i fajësisë së tij.

196. Gjykata vëren se pretendimi i Kuvendit sipas të cilit Presidenti ka shkelur rëndë Kushtetutën lidhet me detyrimet që përmban neni 88, pika 3, i Kushtetutës, më konkretisht: a) të drejtat në procesin zgjedhor; b) marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe marrëdhëniet me jashtë; c) pavarësinë e organeve të shtetit; ç) rendin dhe sigurinë. Duke mbajtur në konsideratë se pretendimet e Kuvendit për shkeljet që lidhen me të drejtat në procesin zgjedhor u trajtuan më sipër si pjesë e detyrimeve që burojnë nga nenet 86, pika 1 dhe 89 të Kushtetutës, Gjykata në vijim do të ndalet në analizën e fakteve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe ato ndërkombëtare, pavarësinë e organeve të shtetit dhe rendin e sigurinë në vend.

Ç.2.2.2.1 Shkeljet që lidhen me marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare

197. Kuvendi ka parashtruar se në disa intervista të tij Presidenti ka mbajtur qëndrime që kanë lidhje me marrëdhëniet me SHBA-në, duke u shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë për ambasadoren e tyre në Shqipëri, çka konsiderohen si sulme publike kundër tyre. Presidenti e ka akuzuar atë për ndërhyrje në punët e brendshme, për njëanshmëri dhe përfaqësim të interesave antishqiptare të shteteve të tjera, sikurse ka insinuar se SHBA-ja mund të kryejnë krime edhe kundër tij. Ai është shprehur publikisht edhe kundër përfaqësuesve të tjerë diplomatikë që punojnë në Shqipëri, por pa përmendur emra shtetesh, duke i konsideruar ata diplomatë të korruptuar ose duke u kërkuar llogari se si duhet të veprojnë në situata të caktuara. Ai u ka bërë thirrje ndërkombëtarëve të jenë më parimorë dhe të reagojnë në kohë dhe është shprehur, se: "*nuk pyet për diplomatë të korruptuar, se Ambasadorja e SHBA-së nuk i tregon dot se si të veprojë*" (*shih paragrafët nr. 46 dhe 82 të vendimit nr. 55/2021 të Kuvendit*). Duke mos respektuar nenet 2, 100 dhe 102 të Kushtetutës dhe duke vepruar në tejkalim të kompetencave të tij sipas nenit 92 të Kushtetutës, Presidenti ka shkelur edhe nenin 88, pika 3, të Kushtetutës, pasi ka vepruar në kundërshtim me detyrimet kushtetuese që përmban betimi në lidhje me mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, pjesë e të cilit janë, në veçanti, marrëdhëniet e mira me jashtë dhe veçanërisht me partnerin strategjik SHBA.

198. Në lidhje me pasojat e këtyre shkeljeve Kuvendi është shprehur se deklarimet publike të Presidentit kundër përfaqësueses së SHBA-së do të kishin dëmtuar rëndë marrëdhëniet me to si aleati ynë strategjik, nëse autoritetet e tyre kompetente nuk do ta kuptonin se këto qëndrime janë e kundërta e qëndrimit zyrtar të Republikës së Shqipërisë. Ndonëse Presidenti nuk i ka dëmtuar marrëdhëniet me partnerët strategjikë ose ato ndërkombëtare, ai ka dëmtuar rëndë autoritetin dhe prestigjin e institucionit të tij në marrëdhëniet me jashtë, të cilat, për këtë shkak nuk mund të riparohen dot prej tij, por vetëm nga Kuvendi. Autoriteti i institucionit është dëmtuar edhe nga qasja e Presidentit ndaj diplomatëve të tjerë në Shqipëri, pavarësisht se nuk ka përmendur emra personash ose shtetesh konkrete, çka mund të bëhej shkak për të krijuar kriza ose incidente diplomatike. Po ashtu, të gjitha delegacionet që kanë ardhur nga SHBA-ja në Shqipëri që pas vënies në lëvizje të kësaj Gjykate, nuk kanë zhvilluar takime zyrtare me Presidentin, ndërkohë që dhe ai ka udhëtuar në SHBA, por nuk është pritur zyrtarisht nga asnjë funksionar i lartë i atij vendi.

199. Presidenti në prapësimet e tij dhe gjatë seancës plenare ka argumentuar se veçanërisht gjatë periudhës zgjedhore ai ka pasur dhe vazhdon të ketë komunikim të shkëlqyer me misionet diplomatike dhe institucionet ndërkombëtare, i cili është ndërtuar gjithmonë mbi bazën e respektimit të plotë të Kushtetutës, të ligjeve në fuqi, të parimeve të sovranitetit e reciprocitetit dhe se nuk i është përcjellë ndonjë shqetësim zyrtar nga partnerët ndërkombëtarë

për sjelljet ose veprimet e tij. Ai nuk ka ndërhyrë asnjëherë në kompetencat e asnjë përfaqësie diplomatike dhe të asnjë vendi partner dhe as nuk ka pranuar ndërhyrje ose qëndrime publik nga diplomatë të veçantë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar kanë mbështetur shkeljet e Kushtetutës e të ligjit, si dhe të marrëveshjes për reformën zgjedhore, ose kanë marrë nën mbrojtje persona nën hetim ose që kanë cenuar integritetin e institucioneve të pavarura. Përballë qëndrimit parimor e të vendosur të Presidentit këta diplomatë janë tërhequr. Presidenti, shqetësimet e tij për sjellje jo korrekte të diplomatëve të caktuar ua ka shprehur atyre zyrtarisht, si dhe ka vënë në dijeni edhe vendet ose organizatat që ata përfaqësojnë. Edhe partnerët ndërkombëtarë janë informuar në kohë, zyrtarisht dhe shkresërisht për përpjekjet e qeverisë dhe shumicës qeverisëse për kapjen e sistemit të drejtësisë, e sidomos të Gjykatës Kushtetuese dhe në këtë drejtim Presidenti ka bërë gjithçka për të parandaluar konfliktet publike që ndodhën midis disa organeve shtetërore. Edhe nga Komisioni i Venecias veprimet e Presidentit janë vlerësuar të drejta, legjitime dhe të arsyeshme.

200. Gjykata vëren se dispozitat kushtetuese i njohin Presidentit rolin e përfaqësuesit më të lartë të shtetit në marrëdhëniet me jashtë, si dhe kompetenca specifike në fushën e politikës së jashtme. Kushtetuta, nga njëra anë, në nenin 92 të saj, i jep Presidentit kompetencën të emërojë dhe lirojë përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare me propozim të Kryeministrit (shkronja "dh"), të pranojë letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë (shkronja "e"), si dhe të lidhë marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit (shkronja "ë"). Nga ana tjetër, në kuptim të përmbajtjes së neneve 100, pika 1 dhe 102, pika 1, shkronja "b", të Kushtetutës, Kryeministri koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe Këshilli i Ministrave i përcakton ato.

201. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përcaktimi i thelbit të marrëdhënieve me jashtë bëhet nga ekzekutivi, i cili, në kuadër të realizimit të programit qeveritar, përcakton drejtimet kryesore të politikës së jashtme, ndërsa shfaqja e këtij vullneti jashtë vendit, në emër të Republikës, bëhet nga Presidenti, duke iu përmbajtur politikës së përcaktuar më parë nga qeveria dhe/ose Kuvendi, sipas rastit. Kryetari i shtetit ka kompetencë të ushtrojë *ius repraesentationis omni modae*, pra të bëjë të njohur ndërkombëtarisht vullnetin e brendshëm shtetëror dhe të përfaqësojë unitetin e shtetit në skenën ndërkombëtare *(shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 15, datë 15.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese)*. Mënyrat se si Presidenti e ushtron këtë funksion mund të jenë me pjesëmarrjen e vetë Presidentit në bërjen të njohur të qëndrimit politik të shtetit në marrëdhënie me jashtë ose me anë të transferimit të autoritetit përfaqësues – plotfuqisë – tek organet e tjera, kryesisht te qeveria (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese)*.

202. Gjykata vëren se harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve është ndër vlerat më të larta që njeh Kushtetuta jonë në Preambulën e saj. Kjo vlerë përshkon disa prej parimeve themelore të organizimit shtetëror, që lidhen me detyrimet e Republikës së Shqipërisë për të ruajtur paqen dhe interesat kombëtare, që mund të realizohet përmes pjesëmarrjes në sisteme kolektive (neni 2, pika 3), apo për të mbrojtur të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve dhe të drejtat e interesave të shtetasve shqiptarëve jashtë shtetit (neni 8). Në këtë kuptim, Presidenti, në rolin e tij të Kryetarit të Shtetit dhe përfaqësuesit të unitetit të popullit, duhet të veprojë për të respektuar dhe mbrojtur këtë vlerë themelore gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, në veçanti të atyre kompetencave që lidhen me politikën e jashtme.

203. Gjykata rithekson se, pavarësisht cilësimit juridik që u jep Kuvendi fakteve të paraqitura si shkak i shkeljeve të rënda të Kushtetutës nga Presidenti, ajo ka të drejtë t'u japë atyre një cilësim të ndryshëm ose të identifikojë dispozita të ndryshme nga ato të përcaktuara në vendimin e shkarkimit (*shih paragrafin 49 të vendimit*). Në këtë kuptim, si dhe në kushtet kur formula e betimit në vetvete nuk përbën shkelje të Kushtetutës dhe nuk është shkak i veçantë, autonom, për shkarkimin e Presidentit nëse nuk shoqërohet me shkeljen e

rëndë të detyrimeve të parashikuara nga norma të tjera kushtetuese, vlerësimi i fakteve të parashtruara nga Kuvendi duhet të bëhet në këndvështrim të përmbajtjes së nenit 92, shkronjat "dh", "e" dhe "ë" së bashku me nenet 100, pika 1 dhe 102, pika 1, shkronja "b", të Kushtetutës, si dhe të Konventës së Vjenës për Imunitetet dhe Privilegjet të vitit 1961.

204. Duke analizuar kriteret e shkeljes së rëndë dhe faktet e referuara nga Kuvendi në drejtim të dispozitave të mësipërme kushtetuese dhe konventore të identifikuara prej saj, si dhe të pasojave dhe efekteve reale ndaj vlerave e parimeve që sanksionojnë ato, që lidhen me unitetin kombëtar, rendin kushtetues, sovranitetin shtetëror, interesat e popullit dhe ato kombëtare, si dhe marrëdhëniet diplomatike të shtetit shqiptar, Gjykata arrin në përfundimin se Presidenti nuk ka ushtruar ndonjë kompetencë me natyrë vendimmarrëse në fushën e politikës së jashtme dhe Kuvendi nuk ka arritur të provojë se në ç'mënyrë ai ka cenuar/dëmtuar marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë dhe ato ndërkombëtare të shtetit tonë në këndvështrim të detyrimeve të tij si më sipër. Deklaratat e tij publike, që janë opinione të natyrës politike të Presidentit për një përfaqësues të një shteti tjetër, nuk prodhojnë domosdoshmërisht efekte në marrëdhëniet dypalëshe mes shteteve apo edhe në kuadër të marrëdhënieve shumëpalëshe dhe statusit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, që bazohen në konventa, traktate dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare në fuqi. Madje, në lidhje me marrëdhëniet dypalëshe mes Shqipërisë dhe SHBA-së, Gjykata vëren se jo vetëm nuk janë cenuar, por kanë njohur zhvillim pozitiv veçanërisht në fushën e mbrojtjes, drejtësisë dhe ekonomisë.

205. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se faktet e paraqitura si shkelje që lidhen me marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe ato ndërkombëtare nuk përbëjnë shkelje të Kushtetutës.

Ç.2.2.2.2 Shkeljet që lidhen me pavarësinë e organeve publike

206. Kuvendi ka parashtruar se Presidenti ka vepruar përtej kompetencave kushtetuese të tij dhe në shkelje të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. Në konfliktin midis bashkisë dhe FRD-së për selinë e kësaj të fundit, Presidenti ka ndërhyrë në çështje që përbëjnë thelbin e veprimtarisë së organeve të rendit dhe pushtetit vendor. Kjo konstatohet jo vetëm nëpërmjet sjelljeve dhe gjuhës së përdorur prej tij në atë konflikt, por edhe nëpërmjet shkresave që i ka dërguar Kuvendit, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe përfaqësuesve diplomatikë për situatën e ndodhur dhe për shkeljet që ai pretendon se ka kryer bashkia e Tiranës. Konflikti është shtruar për zgjidhje gjykatës së zakonshme dhe për të është paraqitur edhe kallëzim penal, pra palët kanë ndjekur mjetet ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

207. Sipas Kuvendit, Presidenti i ka dërguar shkresa Prokurorisë së Përgjithshme, SPAK-ut dhe KQZ-së për përcjellje informacionesh në lidhje me denoncime qytetarësh për fakte që pretendohen si krime zgjedhore, duke kërkuar trajtimin me përparësi të këtyre rasteve. Ai ka vënë në dispozicion të qytetarëve një mjet komunikimi elektronik, denonco@President.al dhe ka marrë përsipër të mbledhë denoncimet e qytetarëve, duke shkelur kështu jo vetëm nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës, por edhe nenin 148 të saj, që sanksionon parimin e pavarësisë së organit të prokurorisë. Përveç sa më sipër, ndërhyrje në veprimtarinë e prokurorisë përbën edhe qëndrimi i Presidentit për ngjarjen e Elbasanit. Presidenti nuk ka shfaqur vullnet për të ftuar palët të ndiqnin me vendosmëri rrugën ligjore për ngritjen e pretendimeve të tyre, por ka injoruar mekanizmat ligjorë dhe megjithëse prokuroria kishte filluar hetimet, ai zgjodhi të ishte protagonisti kryesor për të ndaluar rastet që për të përbënin krime zgjedhore. Në shumë nga deklaratat dhe qëndrimet e Presidentit vihet re edhe gjuhë e papërshtatshme në drejtim të institucioneve të pavarura dhe shtetërore, siç është rasti kur shprehet, se: "*prokurorët dhe gjyqtarët duhet të dëgjojnë mirë Presidentin dhe jo përfaqësuesin e Ndrangheta-s, Don Agaçion dhe se duhet të kenë frikë nëse derdhet qoftë dhe një pikë loti, se kriminelët më të rrezikshëm janë ata të veshur më uniformë, që gjenden brenda sistemit gjyqësore dhe prokurorisë*" ose kur i konsideron policët "*të korruptuar dhe i paralajmëron të zbatojnë ligjet*" (*shih paragrafin nr. 117 të vendimit nr. 55/2021 të Kuvendit*).

208. Sipas Kuvendit, ndërhyrje tjetër në pavarësinë e institucioneve kushtetuese konsiderohet shkresa e Presidentit drejtuar Gjykatës Kushtetuese në lidhje me një çështje konkrete të shqyrtuar prej saj, në të cilën ka bërë diferencim midis gjyqtarëve për profesionalizmin e tyre. Shprehjet e Presidentit në këtë shkresë përbëjnë kërcënim të anëtarëve të Gjykatës, ndërhyrje në çështje që përbëjnë thelbin e veprimtarisë së tyre dhe të njëjtën kohë qëndrime në shkelje të parimit kushtetues të parashikuar në nenet 7 dhe 124 të Kushtetutës (*shih paragrafët 107–111 të vendimit nr. 55/2021 të Kuvendit*).

209. Në lidhje me këto pretendime Presidenti ka prapësuar se, në përputhje me rolin dhe funksionin e tij kushtetues, ai ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për denoncimin e çdo paligjshmërie në procesin zgjedhor, të çdo veprimtarie të ndaluar përgjatë procesit parazgjedhor dhe të çdo veprimi që përbënte krim zgjedhor. Presidenti ka ndërtuar, në mënyrë kushtetuese, një marrëdhënie bashkëpunimi me pushtetet e tjera dhe ka qenë shembulli i vetëm i komunikimit institucional dhe respektit ndaj pavarësisë së tyre. Ai ka pasur komunikim të vazhdueshëm dhe intensiv me të gjitha institucionet e pushtetit ekzekutiv ose të sistemit të drejtësisë, për çështje që lidhen me respektimin e Kushtetutës dhe zbatimin e ligjit e në mënyrë të veçantë për problemet që lidhen me krimin zgjedhor dhe garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Në këtë kontekst, edhe KQZ-ja u ka njohur anëtarëve të kabinetit të Presidentit të drejtën për të marrë informacion për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në qendrat e votimit dhe vendet e numërimit të votave.

210. Në lidhje me konfliktin mes FRD-së dhe bashkisë së Tiranës, ai është shprehur se ka reaguar ndaj sulmit pa bazë ligjore ose shkak të ligjshëm të kryer në zyrat e këtij subjekti politik, në respektim të mënyrës së tij të veprimit, që mund të jetë me shkrim ose me praninë e tij të drejtpërdrejtë, që është ligjore dhe institucionale, pasi sulmi politik ndaj një partie politike nga policia, sidomos gjatë periudhës zgjedhore, cenon interesin publik. Kjo ngjarje e shëmtuar, e provokuar në mënyrë të paligjshme nga bashkia e Tiranës, është bërë në shenjë hakmarrjeje vetëm për faktin se ky subjekt politik ishte regjistruar në koalicionin opozitar.

211. Për sa i takon platformës për denoncimin e krimit të krijuar nga ky institucion, Presidenti ka prapësuar se nëpërmjet saj u është bashkuar përpjekjeve të aktorëve të ndryshëm të interesuar për të denoncuar krimin zgjedhor dhe ka zgjedhur këtë mundësi komunikimi që lehtësonte denoncimin për shkak të transparencës dhe besimit të krijuar tek institucioni i Presidentit. Kjo nismë krijoi një dritare të re komunikimi me opinionin publik, ndërkohë që çdo qytetar është i lirë të hapë faqe në rrjetet sociale ose të përdorë çdo formë të publikimit *online*. Bashkëpunimi me prokurorinë ka qenë kushtetues e i ligjshëm dhe shqetësimi madhor i Presidentit ka qenë hetimi me përparësi i krimeve zgjedhore, moscenimi i votës dhe dekurajimi i tensionimit në ekstrem të situatës. Në respekt të plotë të pavarësisë institucionale, ai ka komunikuar me organin e prokurorisë, veçanërisht për sa u takon krimeve zgjedhore dhe autorëve të tyre. Koha e kufizuar për shkak të afrimit të datës së zgjedhjeve diktonte përparësi në trajtimin e këtyre problematikave për parandalimin e kryerjes së tyre dhe pasojave nga veprat penale ose veprimtaria e paligjshme.

212. Në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, Presidenti ka prapësuar se ai ka zbatuar çdo vendim të kësaj Gjykate dhe se ka qenë konsekuent e parimor në qëndrimin e tij për një drejtësi larg presioneve politike duke i garantuar asaj mbështetjen në dhënien e drejtësisë kushtetuese. Edhe pse Gjykata Kushtetuese ka epërsi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se Shqipëria është anëtare e shumë konventave ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe u nënshtrohet detyrimeve ndërkombëtare dhe juridiksionit të gjykatave ndërkombëtare, çdo vendim i sistemit gjyqësor që dështon në dhënien e drejtësisë e shkakton pasoja serioze për shtetin e qytetarët, ngarkon me përgjegjësi edhe autoritetet që kanë shqyrtuar çështjet jashtë standardeve evropiane.

213. Gjykata vëren se, sipas nenit 7 të Kushtetutës, sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ky parim synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi ose të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete

rrezikun e shpërdorimit të tij. Në zbatim të parimit bazë të shtetit të së drejtës dhe atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, kushtetutëbërësi ka përcaktuar, për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete, kompetencat që i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij. Ky parim shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve ose institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 41, datë 16.5.2017; nr. 23, datë 24.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese).*

214. Balancimi i pushteteve, teksa kërkon ekuilibrim të kompetencave, nuk do të thotë që pesha dhe kompetenca e organeve është e njëjtë. Ai ka të bëjë me faktin se struktura institucionale shtetërore bazohet në ndarjen e kompetencave midis organeve të ndryshme, ndarje që tregon vendin që kushtetutëbërësi ka dashur t'i japë secilit prej tyre në përmbushjen e rolit përkatës. Nuk mund të pranohet që një organ t'i shtrijë kompetencat e tij në dëm të tjetrit. Pra, Kushtetuta ka krijuar një sistem për ndarjen e kompetencave midis organeve të ndryshme, i cili i cakton secilit rolin e tij në strukturën institucionale shtetërore dhe në realizimin e detyrave që i janë besuar (*shih vendimin nr. 26, datë 25.5.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

215. Gjykata, në analizë të fakteve të mësipërme, identifikon se dispozitat kushtetuese të zbatueshme në këtë rast janë neni 7 i Kushtetutës i parë së bashku me nenet 13, 124 dhe 148 të saj dhe është në kuptim të këtyre dispozitave kushtetuese, vlerave dhe parimeve që garantojnë e mbrojnë ato, që ajo verifikon kriteret e tjera që përcaktojnë shkeljen e rëndë të Kushtetutës.

216. Në lidhje me rastin e FRD-së, sipas nenit 13 të Kushtetutës, qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se thelbi i kësaj dispozite janë parimet e decentralizmit të pushtetit dhe autonomisë vendore. Parimi i decentralizmit të pushtetit, si parim thelbësor mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore, ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik *(shih vendimet nr. 4, datë 2.2.2015; nr. 29, datë 21.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

217. Gjykata vëren fillimisht se format e ndërhyrjes së Presidentit në konfliktin e lindur mes FRD-së dhe bashkisë së Tiranës, të shprehura me veprime konkrete (ndërhyrja drejtpërdrejt në selinë e saj dhe shkresat drejtuar disa institucioneve), si dhe nëpërmjet deklaratave publike, janë shoqëruar nga sjellje dhe gjuhë e papërshtatshme për lartësinë e detyrës si Kryetar i Shtetit. Ndonëse Gjykata nuk pajtohet me formulimin e akuzave dhe etiketimeve fyese ndaj përfaqësuesve të autoriteteve publike në lidhje me veprimtarinë e kryer prej tyre, ajo thekson se kritikat e shprehura publikisht ose vlerësimet negative ndaj veprimtarisë së institucioneve shtetërore nuk mund të konsiderohen, në vetvete, si diskreditim i autoritetit shtetëror. Në këto lloj situatash është e nevojshme të vlerësohen bashkërisht përmbajtja e kritikave, rrethanat në të cilat ato janë bërë publike dhe synimi që është kërkuar të arrihet përmes tyre.

218. Për sa më sipër, duke analizuar kriteret e shkeljes së rëndë dhe faktet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se veprimet e Presidentit nuk kanë sjellë ndikim ose efekt negativ në ushtrimin e veprimtarisë kushtetuese të organeve të pushtetit vendor dhe përmbushjen e detyrave të tyre në përputhje të plotë me dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore. Megjithatë, edhe pse Kushtetuta parashikon të drejtën e palëve në një mosmarrëveshje kompetencash kushtetuese, ku përfshihen edhe organet e qeverisjes vendore, për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e saj nuk rezulton që një konflikt i tillë të jetë ngritur formalisht, sikundër nuk u paraqitën prova që organet e pavarura kompetente të kenë marrë në shqyrtim dhe të

jenë shprehur në lidhje me këto pretendime të Kuvendit.

219. Për sa i përket marrëdhënies me prokurorinë, Gjykata thekson se pavarësia e këtij organi është sanksionuar në nenin 148 të Kushtetutës, sipas të cilit prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Si organ i pavarur ajo garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit. Prokuroria është organ që ka pavarësi në ushtrimin e funksioneve, duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimet nr. 43, datë 26.6.2015; nr. 26, datë 4.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

220. Në analizë të kritereve të shkeljes së rëndë dhe fakteve konkrete të referuara nga Kuvendi, Gjykata vlerëson se nuk është arritur të provohet ardhja e pasojave në drejtim të pavarësisë kushtetuese të prokurorisë, pra cili ka qenë ndikimi apo efekti negativ që ka ardhur nga veprimet e Presidentit në ushtrimin e veprimtarisë nga ky organ dhe përmbushjen e detyrave në përputhje të plotë me dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore. Pretendimi i Kuvendit se Presidenti ka shfaqur mungesë totale vullneti për të ftuar palët të ndiqnin me vendosmëri rrugën ligjore për ngritjen e pretendimeve të tyre dhe se ka injoruar mekanizmat ligjorë që ishin vënë me sukses në zbatim në këto zgjedhje me miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal, Kodin Zgjedhor e disa ligje të tjera, në kuadër të reformës zgjedhore, është i pabazuar.

221. Gjykata vlerëson se, nga njëra anë, Presidenti nuk është organ vendimmarrës dhe nuk ka ndonjë kompetencë për çështjet e mësipërme, dhe se, nga ana tjetër, nga faktet dhe provat e paraqitura nuk rezulton që ai të ketë penguar palët të ndiqnin rrugën ligjore ose të ketë ushtruar/marrë ndonjë kompetencë të organeve të zbatimit të ligjit. Gjykata, për sa i takon nismës së Presidentit për krijimin e portalit, për të cilin ai pretendon se ka pasur qëllim sensibilizues, vëren se të gjitha denoncimet e mbledhura në këtë portal i janë përcjellë për shqyrtim organit të prokurorisë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese. Gjykata, duke ritheksuar të njëjtin qëndrim mospajtues në lidhje me qasjen dhe gjuhën e përdorur nga Presidenti ndaj organeve të rendit publik dhe atyre të sistemit të drejtësisë, vlerëson se edhe në këtë rast, në kuptim të neneve 148 dhe 145 të Kushtetutës, Presidenti nuk ka ushtruar kompetenca në këtë drejtim, ndërkohë që opinionet e vlerësimet e tij, si titullari më i lartë me mandat publik, për autoritete të tjera publike nuk përbëjnë në vetvete konflikt juridik kushtetues ndërmjet tyre. Mendimet ose propozimet në lidhje me mënyrën se si vepron ose duhet të veprojë një autoritet i caktuar publik ose strukturat e tij, edhe nëse janë kritike, duhet të shoqërohen me veprime ose mosveprime të një natyre të atillë që të pengojnë përmbushjen e detyrave funksionale prej tij.

222. Për sa u takon fakteve që lidhen me marrëdhënien me Gjykatën Kushtetuese, ajo vëren se me shkresën nr. 1209, datë 5.4.2021 Presidenti i është drejtuar kësaj Gjykate duke bërë publik shqetësimin e tij në lidhje me një vendimmarrje konkrete të saj.

223. Kushtetuta në nenin 124, pika 2, të saj parashikon se Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës, ndërsa në nenin 126 parashikon se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim. Gjykata thekson se pavarësia e gjyqtarit kushtetues nuk është qëllim në vetvete, por është në funksion të mandatit të tij kushtetues, në mënyrë që të krijohen kushtet e nevojshme që të përmbushë rolin dhe detyrat e tij në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

224. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit *(shih vendimet nr. 17, datë 30.3.2021, nr. 49, datë 3.7.2017; nr. 44, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se Presidenti, si një ndër

subjektet e pakushtëzuara që vë në lëvizje gjykimin kushtetues, sipas nenit 134, pikat 1, shkronja "a" dhe 2, të Kushtetutës, mund të përdorë kërkesën kushtetuese si mjet për mbrojtjen e kushtetutshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të natyrës kushtetuese, brenda kufijve të kompetencave të kësaj Gjykate, duke respektuar më pas autoritetin e vendimmarrjes së saj.

225. Duhet theksuar se në shtetin e së drejtës është e nevojshme që Gjykata Kushtetuese, ashtu si edhe pushteti gjyqësor, të gëzojë besimin e publikut dhe, për rrjedhojë, sulmet publike denigruese, të pabazuara në fakte dhe prova duhet të mënjanohen, në veçanti nga aktorë të rëndësishëm të jetës publike, qofshin ata zyrtarë shtetërore ose media. Për më tepër, gjyqtarët, për shkak të funksionit që kryejnë, kanë detyrimin etik të vetëpërmbajtjes, që i kufizon ata t'u përgjigjen publikisht sulmeve të tilla.

226. Duke analizuar kriteret e shkeljes së rëndë dhe faktet konkrete, ndonëse rithekson mospajtimin me mënyrën se si Presidenti i është drejtuar asaj, Gjykata arrin në përfundimin se fakti i paraqitur si ndërhyrje në veprimtarinë e Gjykatës është i pabazuar, për rrjedhojë vlerëson se veprimet e Presidentit nuk përbëjnë shkelje të Kushtetutës.

227. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se faktet e paraqitura si shkelje që lidhen me pavarësinë e organeve publike nuk përbëjnë shkelje të Kushtetutës.

Ç.2.2.2.3 Shkeljet që lidhen me rendin dhe sigurinë publike

228. Kuvendi ka pretenduar se në shumë nga daljet e veta publike Presidenti ka zgjedhur të përdorë retorikë dhune dhe ta favorizojë haptazi atë në sytë e publikut si mjet për zgjidhjen e problemeve në vend të mjeteve që ofron shteti i së drejtës. Kjo retorikë, e justifikuar sipas tij si e nevojshme për mbrojtjen e votës nga vjedhja, ka pasur përshkallëzim të fortë deri në fund të fushatës. Kjo shkelje provohet edhe nga reagimi i përfaqësuesve të shteteve të huaja në vend, të cilët publikisht bënë thirrje për të ndaluar gjuhën dhe thirrjet për dhunë. Në prag të datës të zgjedhjeve në Elbasan ndodhi një përplasje midis dy grupe simpatizantësh, me pasoja të rënda, dhe mënyra e veprimit të tyre përputhet plotësisht me thirrjen publike të Presidentit. Thirrjet për dhunë reflektohen në përdorimin e shprehjeve, të tilla si: "*ngrehuni dhe bjeruni, vdekje tradhtarëve, t`i mprehin sfurqet*" ose deklarimet, se: "*struktura për mbrojtjen e votës është një e drejtë legjitime e opozitës, pasi shteti është i kapur nga krimi*" (*shih paragrafët 46, 124 dhe 126 të vendimit nr. 55/2021 të Kuvendit).*

229. Sipas Kuvendit, edhe pse Presidenti ka përkrahur nismën e opozitës për ngritjen dhe funksionimin e "Strukturës për mbrojtjen e votës", kjo çështje i takon për hetim organeve kompetente. Megjithatë, ai nuk është distancuar dhe nuk ka dënuar jo vetëm ngjarjen e rëndë të Elbasanit, por as modelin e kundërligjshëm që përfaqësonte kjo strukturë. Aktet dhe sjelljet e Presidentit kanë frymëzuar dhunë dhe ndasi sociale, nuk kanë kontribuar për uljen e konflikteve dhe pasqyrojnë gjuhë përçarjeje dhe urrejtjeje. Kjo nxitje dhune dhe ndasie shfaqet jo vetëm në deklaratat publike të Presidentit, por edhe në sjelljen e tij në situata konkrete (konflikti midis FRD-së dhe bashkisë së Tiranës), nuk ndikuan për qetësimin e situatave, përkundrazi i përshkallëzuan ato dhe përbëjnë shembuj negativë që nxisin vetëgjyqësinë.

230. Presidenti ka prapësuar se fushata e zgjedhjeve të përgjithshme u tensionua në nivele ekstreme për shkak të aktorëve politikë, duke kulmuar edhe me humbje jete (në qytetin e Elbasanit), sulme të armatosura (siç është rasti në qytetin e Kavajës), apo ngjarje e situata të tjera të rënda provokuese (ngjarjet në qytetin e Fierit). Deklaratat dhe denoncimet publike e shkresore të Presidentit kanë qenë plotësisht në proporcion të drejtë me situatën shumë të rëndë parazgjedhore, si dhe në funksion të parandalimit të përshkallëzimit dhe daljes jashtë kontrollit të saj. Në rastin e Fierit, të nxitur nga veprimet e paligjshme e provokuese të bashkisë dhe të përfaqësuesve të shumicës qeverisëse, Presidenti u kërkoi publikisht kandidatëve të një force politike (LSI) të mos binin pre e provokimeve dhe ta tejkalonin atë situatë me urtësi. Në lidhje me termin "sfurqet", ai është përdorur në kontekstin e një konflikti konkret të ndodhur në Fier, ku Presidenti ka qenë dëshmitar okular, dhe në këtë deklaratë "sfurqet" janë përmendur në mënyrë metaforike, si mjete pune të banorëve të zonës dhe në kontekstin e vënies në rrezik të interesit publik.

231. Gjykata, bazuar në analizën e kritereve të shkeljes së rëndë, nuk identifikon ndonjë normë kushtetuese të cenuar, pasi në lidhje me këto fakte Kuvendi nuk ka arritur të provojë ardhjen e pasojave në drejtim të cenimit të rendit dhe sigurisë publike. Edhe në këtë rast Presidenti nuk ka ushtruar veprimtari vendimmarrëse, nuk ka marrë ose ushtruar kompetenca të institucioneve të tjera dhe nuk është provuar ndonjë qëllim i tij për ndërhyrje në rendin dhe sigurinë publike.

232. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se faktet e paraqitura si shkelje që lidhen me rendin dhe sigurinë publike nuk përbëjnë shkelje të Kushtetutës.

233. Për sa më sipër, për sa kohë që Gjykata nuk arriti në përfundimin se Presidenti ka kryer shkelje të rëndë të Kushtetutës në drejtim të ushtrimit të funksionit si Kryetar i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit, sipas neneve 86, pika 1 dhe 89 të Kushtetutës, e lidhur edhe me të drejtat në procesin zgjedhor, të shqyrtuara më sipër, dhe as shkelje në veprimtarinë e tij që lidhet me marrëdhëniet me partnerët strategjikë dhe marrëdhëniet me jashtë, pavarësinë e organeve të shtetit dhe rendin e sigurinë në vend, çmon se është i pabazuar pretendimi i Kuvendit për shkeljen e detyrimeve që burojnë nga neni 88, pika 3, i Kushtetutës si rezultat i shkaqeve të parashtruara prej tij.

Ç.2.2.3 Shkelja e nenit 94 të Kushtetutës

234. Kuvendi ka parashtruar se është shkelur edhe neni 94 i Kushtetutës, që e ndalon Presidentin të ushtrojë kompetenca që nuk janë parashikuar për të në Kushtetutë dhe në ligj, për sa kohë që janë konstatuar shkelje që lidhen me nenin 89 të Kushtetutës, që ndalon kryerjen nga ana e tij e veprimtarive partiake dhe private gjatë ushtrimit të detyrës. Asnjë qëndrim ose akt i Presidentit, i konsideruar shkelje kushtetuese, nuk është kryer në ushtrim të ndonjë parashikimi që përcaktohet në tekstin e nenit 94 të Kushtetutës ose dispozita të tjera kushtetuese që përcaktojnë kompetencat e tij. Deklarimet, qëndrimet gjatë procesit zgjedhor, si dhe veprimet e Presidentit të konkretizuara me shkresat drejtuar Gjykatës Kushtetuese, prokurorisë, KQZ-së etj., jo vetëm që nuk rezultojnë në përputhje me kompetencat që i njeh Kushtetuta, por janë në tejkalim të tyre.

235. Presidenti është shprehur se ka vepruar në përputhje me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese në ushtrimin e veprimtarisë dhe se veprimet e tij kanë qenë në zbatim e respektim të plotë të Kushtetutës e ligjeve, si dhe në shërbim të interesit më të lartë publik.

236. Sipas nenit 94 të Kushtetutës, Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të, atribut që buron nga parimet e shtetit të së drejtës dhe atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. Detyra e tij si përfaqësues i unitetit të popullit është të mbikëqyrë funksionimin normal të mekanizmave kushtetues, duke ndërhyrë për eliminimin e mangësive në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 64, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

237. Gjykata, ashtu sikurse ka theksuar më sipër, vëren se kompetencat e Presidentit nuk janë parashikuar në një dispozitë ose krye të vetëm, por janë shpërndarë në disa krerë të Kushtetutës. Më konkretisht, hartuesit e Kushtetutës kanë zgjedhur t'i vendosin kompetencat e Presidentit në mënyrë të shprehur jo vetëm në nenin 92, por edhe në dispozita të tjera Kushtetutës, të cilat mbulojnë fusha të caktuara. Kështu, Presidenti ka kompetenca në fushën e marrëdhënieve me pushtetin ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor; në fushën e zgjedhjeve dhe të referendumeve; në fushën e të drejtave të njeriut; në fushën e mbrojtjes e të sigurisë; në fushën e arsimit e të shkencës, ekonomisë e financës; në fushën e marrëdhënieve me jashtë.

238. Gjykata vëren se neni 94 i Kushtetutës vendos ndalim për Presidentin për llojin e kompetencave që ai ushtron, i cili i lidhur me parimin e shtetit të së drejtës i kufizon ato në rrethin e atyre të shprehura *expressis verbis* në Kushtetutë, të shpërndara në një sërë dispozitash. Gjykata konstaton se pretendimi i Kuvendit për shkeljen e nenit 94 të Kushtetutës bazohet në premisën se Presidenti ka kryer aktet e tjera jo në përputhje me Kushtetutën, për shkak të mënyrës se si është sjellë dhe ka vepruar përgjatë periudhës kohore që ka qenë objekt i hetimit të komisionit hetimor (të analizuara më lart në këtë vendim).

239. Në rastin konkret Gjykata evidenton se shkeljet e nenit 94 të Kushtetutës nuk mund të bazohen ose të rrjedhin prej dispozitave kushtetuese që nuk kanë në objektin e tyre kompetenca konkrete të Presidentit, siç është neni 89 i Kushtetutës, që vendos ndalimin e tij të jetë anëtar partie. Për sa kohë Gjykata nuk konstatoi shkelje nga analiza e fakteve të paraqitura nga Kuvendi si ndërhyrje të Presidentit apo ushtrim të kompetencave të ndryshme nga ato të përcaktuara në Kushtetutë, pretendimi për shkeljen e nenit 94 të saj është i pabazuar.

240. Për të gjitha argumentet e mësipërme, Gjykata nuk arrin në përfundimin se Presidenti ka shkelur rëndë Kushtetutën, ndaj ajo do të shfuqizojë vendimin e Kuvendit për shkarkimin e tij nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 90, pika 2, dhe 131, pika 1, shkronja "dh", të Kushtetutës, si dhe neneve 63, pika 2, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr. 55/2021, datë 9.6.2021, të Kuvendit të Shqipërisë, "Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.2.2022.
Shpallur më 15.3.2022.

Kryetare: Vitore Tusha,
Anëtarë pro: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Përparim Kalo, Sonila Bejtja
Anëtarë kundër: Altin Binaj

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes së vënë në lëvizje me vendimin nr. 55, datë 9.6.2021, të Kuvendit të Shqipërisë, jam kundër përfundimit të shumicës për pjesën që nuk e ka konsideruar shkelje të rëndë veprimtarinë e Presidentit gjatë procesit zgjedhor të vitit 2021, e cila bie në kundërshtim me nenin 86, pika 1, në lidhje me nenin 89 të Kushtetutës, si dhe nenin 88, pika 3, të saj, ndërkohë që i bashkohem asaj për pjesën tjetër, sipas arsyetimit të vendimit të Gjykatës. Për këtë arsye, bazuar në nenin 132, pika 3, të Kushtetutës, si dhe nenin 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar dhe në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 39, pika 11, të Rregullores për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në vijim po parashtroj argumentet që mbështesin qëndrimin tim si gjyqtar në pakicë.

2. Pavarësisht nga vlerësimi i kundërt për elementin e cituar më sipër, mendimi i pakicës është i njëjtë me atë të 4 gjyqtarëve që arritën në përfundimin se veprimtaria e Presidentit ka qenë në shkelje të nenit 86, pika 1, në lidhje me nenin 89 të Kushtetutës *(shih paragrafin 187 të vendimit),* ndërkohë që në dallim nga këta të fundit vlerësoj se kjo shkelje ka qenë edhe e rëndë, në kuptim të përmbajtjes së nenit 90, pika 2, të Kushtetutës, për rrjedhojë passjell shkarkimin, për shkaqet që do të trajtohen më hollësisht në vijim.

3. Lidhur me përgjegjësinë e Presidentit dhe shkaqet e shkarkimit, sikurse me të drejtë arsyetohet nga shumica, neni 90, pika 1, i Kushtetutës, në raport me peshën dhe rëndësinë e këtij funksioni, ofron garancitë e nevojshme për përmbushjen me sukses të detyrës, kurse qëllimi i nenit 90, pika 2, të Kushtetutës, që përcakton se në rastet e shkeljes ose krimit të rëndë Presidenti i nënshtrohet përgjegjësisë, është mbrojtja e kushtetutshmërisë, e cila ka epërsi mbi garancitë e dhëna atij *(shih paragrafët 124–131 të vendimit),* ndërkohë që shkarkimi është një proces kushtetues, i shoqëruar me një sanksion të posaçëm kushtetues *(shih paragrafin 135 të vendimit).*

4. Gjykata me të drejtë ka theksuar, gjithashtu, se dispozita kushtetuese ka përcaktuar në mënyrë të qartë se shkak për shkarkim mund të jetë

vetëm shkelja e rëndë e Kushtetutës dhe jo shkelje të tjera të saj, ndërkohë që *shkelja e rëndë* përmbledh vetëm *aktet e rënda*, në kuptimin e gjerë që ky koncept ka në teorinë dhe praktikën e së drejtës, i cilësuar i tillë kur cenon një normë e cila ka për objekt mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të rëndësishme kushtetuese. Nga ana tjetër, akti është i rëndë edhe në raport me pasojën që ka ardhur ose mund të vijë prej tij, së bashku me rrethanat konkrete të kryerjes, pamundësinë e riparimit të dëmit kushtetues të shkaktuar, në kuptimin që shkarkimi nga detyra mbetet e vetmja mundësi, si dhe me momentin subjektiv që lidhet me qëndrimin që mban Presidenti, në veçanti qëllimin që ai ka ndjekur (*shih paragrafët 137, 140 të vendimit*).

5. Bashkohem me arsyetimin e shumicës edhe për përcaktimin e natyrës së akteve të Presidentit që përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës, si dhe konkluzionin që shkelje të rënda nuk janë aktet që thjesht mund të mos jenë në përputhje me Kushtetutën, por vetëm ato që haptazi bien ndesh me të (*shih paragrafët 141 dhe 142 të vendimit*), gjithashtu edhe për përcaktimin e 4 kritereve juridiko-kushtetues që duhet të plotësohen në rastin e shkeljes së rëndë (*shih paragrafët 144 - 149 të vendimit*), sikurse ndaj të njëjtin mendim edhe për rolin dhe pozicionin e Presidentit sipas Kushtetutës (*shih paragrafët 163–174 të vendimit*).

6. Duke u ndalur te roli dhe pozicioni i Presidentit i përcaktuar në Kushtetutë, ashtu siç ka theksuar edhe Gjykata, neni 86, pika 1, i Kushtetutës parashikon se Presidenti është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit, kurse sipas nenit 89 të saj, ai nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private.

7. Kushtetuta, sipas modelit të republikës parlamentare, e ka konceptuar Presidentin me pozitë neutrale, mbi palët (*super partes*), me rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, balancimin e pushteteve dhe kryerjen e funksioneve të tyre respektive. Presidenti nuk duhet të investohet politikisht, ai nuk duhet të shihet as si pjesë e drejtpërdrejtë e ekzekutivit dhe as si pjesë e drejtpërdrejtë e partive politike, por si një arbitër kushtetues, i cili vetëm në këtë pozicion mund të zgjidhë krizat institucionale dhe të bëhet garant i Kushtetutës.

8. Edhe Komisioni i Venecias ka theksuar se atributet që Kushtetuta i jep Presidentit nuk nënkuptojnë që autoriteti i tij është mbi politikën. Ato më saktë nënkuptojnë se Presidenti duhet të mbetet jashtë politikës partiake, me qëllim që të sigurojë, ndër të tjera, një konkurrencë të ndershme midis palëve dhe funksionimin e rregullt të formës së qeverisjes dhe të veprimtarive të tjera të shtetit. Në sistemet parlamentare objektivat që Presidenti duhet të ndjekë perceptohen se qëndrojnë mbi ato të politikës. Nga kjo rezulton se, në ushtrimin e këtyre kompetencave, Presidenti jo vetëm që duhet të sillet në mënyrë të paanshme, por edhe duhet të shihet që sillet në këtë mënyrë. Kurse duke iu referuar sistemeve të ngjashme parlamentare, Komisioni ka theksuar se Kryetari i Shtetit luan rolin e arbitrit dhe i shkëputur nga politikat partiake. Ndërkohë që askush nuk mund ta pengojë Kryetarin e Shtetit të ketë pikëpamjet dhe simpatitë e veta politike, tagrat e tij janë të kufizuara (*shih paragrafët 163, 164 dhe 166 të vendimit).*

9. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në një çështje të saj në gjykim, veç të tjerash, ka theksuar: "Është e arsyeshme që publiku të presupozojë se Presidenti i tyre, që përfaqëson unitetin e popullit dhe një fragment apo interes partiak, do të përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar gëzon të drejtën të sigurohet nga paanshmëria, integriteti dhe pavarësia e Presidentit. Partitë politike kanë si funksion dhe dëshirë themelore të fitojnë mbështetjen e qytetarëve dhe të influencojnë njerëzit në lidhje me çështjet politike dhe të fitojnë zgjedhjet. Nëse një parti politike ka mbështetjen e Presidentit ajo ka një aset të konsiderueshëm politik për të çuar përpara agjendën e saj politike dhe zgjedhjen e kandidatëve për poste publike" (*shih vendimin datë 28.9.2010, të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në çështjen nr. KI 47/10*).

10. Nga ky këndvështrim, si gjyqtar në pakicë bashkohem, gjithashtu, me vlerësimin e shumicës se pikërisht duke iu referuar standardeve të mësipërme, nën dritën e përgjegjësisë kushtetuese të Presidentit, duhet analizuar kuptimi i parashikimeve të nenit 86, pika 1, të Kushtetutës bashkërisht me parashikimet e nenit

89 të saj, për të përcaktuar rolin dhe pozicionin e tij në procesin zgjedhor.

11. Neni 86, pika 1, i Kushtetutës përcakton pozicionin e Presidentit në strukturën kushtetuese dhe si Kreu i Shtetit ai simbolizon qytetarin e parë të vendit dhe i ushtron kompetencat e tij në mënyrë të tillë që të ndihmojë, nxisë, komunikojë dhe bashkëveprojë me organet dhe subjektet e ndryshme, të cilave Kushtetuta u beson funksionet e drejtimit politik ose të garancive kushtetuese, me qëllim që të respektohen dhe mbrohen vlerat e parashikuara në ligjin themelor sipas parimit se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit (neni 4 i Kushtetutës). Për sa i takon përcaktimit si përfaqësues i unitetit të popullit, që në interpretimin gjuhësor nënkupton një gjendje në të cilën diçka përbën një të tërë të vetme dhe të pandarë, ky rol përmbledh detyra të Presidentit jo vetëm në drejtim të unitetit territorial të shtetit, që përcaktohet qartësisht në Kushtetutë (neni 1, pika 2, i saj), por sidomos në drejtim të strukturës së rendit kushtetues, si përfaqësues i vullnetit të popullit dhe i interesit të përgjithshëm të shtetit, në mënyrë që pushtetet të funksionojnë në mënyrë harmonike dhe në kohezion të plotë, pra të përmbushin përgjegjësitë dhe të mos tejkalojnë pushtetet, si dhe të veprojnë në mënyrë aktive.

12. Në përputhje me këtë pozicion të tij, nëse organet kushtetuese përfshihen në situata konfliktuale që cenojnë garancitë kushtetuese, Presidenti luan rol ekuilibrues dhe duhet të ndërhyjë si organ moderues dhe nxitës i pushteteve, duke evidentuar dhe rekomanduar atyre parimet që mund të ofrojnë zgjidhje të pranueshme. Për këtë qëllim, krahas nxjerrjes së akteve formale në përmbushje të detyrës, Presidenti mund të kryejë edhe veprimtari informale, të tilla si takime dhe komunikime. Me anë të kësaj veprimtarie ai, në mënyrë diskrete, ushtron "influencën" e autoritetit të tij për të bindur organet kushtetuese të marrin masa konkrete, të cilat ndikojnë pozitivisht në marrëdhëniet ndërmjet pushteteve të shtetit, duke u dhënë zgjidhje ngërçeve ose bllokimeve që ndodhin në jetën politike e institucionale.

13. Në funksion të rolit të përmendur më sipër, shumica me të drejtë arsyeton se, në parim dhe në varësi të personalitetit, individualitetit, prejardhjes eventuale politike, apo mënyrës sesi ai e koncepton dhe interpreton atë, ushtrimi nga Presidenti i një roli aktiv në jetën politike dhe shoqërore të vendit nuk mund të konsiderohet sjellje në kundërshtim me Kushtetutën, për sa kohë që veprohet brenda kuadrit të kompetencave të tij kushtetuese, por pas marrjes së funksionit të tij kushtetues, Presidenti duhet të gjejë pozicionin që dikton Kushtetuta për rolin neutral, pasi ai nuk përfaqëson më interesat e partisë politike, anëtar i së cilës mund të ketë qenë, por interesat e përgjithshme të vendit. Është e logjikshme dhe e pritshme që qytetarët të besojnë se Presidenti i tyre, në rolin e Kryetarit të Shtetit dhe përfaqësuesit të unitetit të popullit, do t'i përfaqësojë të gjithë ata dhe jo vetëm pjesën që mbështet një fragment të caktuar politiko-partiak.

14. Për rrjedhojë, Gjykata me të drejtë ka vlerësuar se Presidenti duhet t'i përmbahet parimit të neutralitetit, të qëndrojë mbi politikat partiake, pasi ai është Kryetari i Shtetit dhe përfaqëson interesat e përgjithshme të vendit dhe jo interesa partiake. Nga ana tjetër, ndalimi i parashikuar në nenin 89 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidenti nuk mund të jetë anëtar partie politike, është i lidhur me rolin dhe pozicionin e tij, sepse reflekton kërkesën kushtetuese për të qenë mbi të gjitha palët, por, gjithashtu, edhe për të garantuar kushtetutshmërinë brenda kompetencave të veta kushtetuese. Në kontekstin e procesit zgjedhor, ai, duke ruajtur asnjanësinë politike, njëherazi nxit dhe moderon organet dhe subjektet e ndryshme që kanë funksione të caktuara në këtë proces, me qëllim realizimin e një procesi zgjedhor në përputhje me standardet kushtetuese. Vetëm duke respektuar ndalimin kushtetues "të mos jetë anëtar partie", Presidenti përmbush kërkesat për neutralitet të parashikuara nga Kushtetuta, që janë premisë që veprimtaria e tij të jetë në përputhje me interesin e përgjithshëm publik, jashtë linjave partiake.

15. Sikurse theksohet në vendimin e Gjykatës, përcaktimi për të mos qenë anëtar i një partie politike nuk është një ndalim kushtetues vetëm në kuptimin formal, por edhe në atë substancial për Presidentin, në interpretimin që ai e ndalon atë të kryejë veprimtari në mbështetje të një partie të caktuar politike apo që gjatë fushatës zgjedhore të ndërhyjë dhe të deformojë

formimin e opinionit publik, duke cenuar konkurrimin e ndershëm dhe vlerësimin e drejtë të partive politike dhe kandidatëve. Përndryshe, një veprimtari e tillë do të cenonte parimin themelor të qeverisjes në demokracinë tonë parlamentare, të sanksionuar nga neni 1, pika 3, i Kushtetutës, sipas të cilit qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike. Parimi i zgjedhjeve të lira nuk do të thotë vetëm se votuesit duhet të jenë në gjendje të votojnë pa pasur ndikim të detyruar ose të padrejtë nga shteti ose shoqëria, por, gjithashtu, që votuesit duhet të jenë në gjendje të gjykojnë dhe marrin vendimet e tyre në mënyrë të informuar, në një proces të lirë për të formuar opinionet e tyre. Ky parim, në kontekstin e rolit neutral të Presidentit, nënkupton detyrimin e tij për të ruajtur asnjanësinë politike, pra ndalimin e tij për të mbështetur ose kundërshtuar ndonjë parti ose përfaqësues të veçantë politik që garon si kandidat në zgjedhje (*për më tepër shih paragrafët 163–173 të vendimit, si dhe vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 64, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Duke iu rikthyer çështjes konkrete dhe mbi bazën e provave të shqyrtuara në seancat publike, rezulton se Presidenti gjatë ushtrimit të detyrës së tij nuk ka qenë formalisht anëtar i ndonjë partie politike, pasi ka hequr dorë prej saj kur u zgjodh dhe bëri betimin para Kuvendit, pra detyrimi formal në kuptimin e ngushtë të përmbajtjes së nenit 89 të Kushtetutës është i përmbushur.

17. Por duke qenë se, sikurse arsyetohet më sipër, parashikimi kushtetues nuk nënkupton vetëm mosqenien formalisht anëtar partie, por edhe ndalimin substancial, sipas të cilit Presidenti gjatë ushtrimit të detyrës nuk mund të kryejë veprimtari politiko-partiake, po ashtu si shumica vlerësoj se premisa nga e cila duhet nisur për të arritur në një përfundim të drejtë në lidhje me këtë çështje, është analizimi i përmbajtjes dhe kontekstit të deklaratave dhe veprimeve të Presidentit. Vetëm në këtë mënyrë mund të vlerësohet nëse kjo veprimtari e Presidentit, e kryer gjatë procesit zgjedhor, ka qenë në mbështetje ose në kundërshtim të një partie ose grupimi politik, si dhe pasojat e saj në raport me zgjedhjet.

18. Në analizë të sa më sipër rezulton se para dhe gjatë fushatës zgjedhore, në mënyrë të përsëritur, Presidenti ka mbajtur qëndrim publik për procesin zgjedhor, që janë reflektuar sipas vendimit të Kuvendit në rreth 19 emisione televizive, 9 deklarata për mediet dhe rreth 45 postime në rrjetet sociale (*shih paragrafin 180 të vendimit*).

19. I bashkohem qëndrimit të shumicës, e cila, duke analizuar qëndrimet e Presidentit, ka vlerësuar se qasja e tij në ushtrimin e këtij funksioni të lartë nuk ka qenë e përmbajtur, pasi ai ka ushtruar rol aktiv në jetën politike dhe shoqërore të vendit, në veçanti gjatë fushatës zgjedhore. Ndonëse kjo lidhet edhe me personalitetin dhe të shkuarën politike të tij, me të drejtë është theksuar në vendim se Presidenti, sikurse edhe çdo pjesëmarrës në jetën publike, duhet të komunikojë me respekt të ndërsjellë, në mënyrë që të dëshmojë tek të gjithë qytetarët se vepron për të promovuar dinjitetin njerëzor, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin, si vlera themelore të shoqërisë.

20. Qëndrimet dhe deklaratat e Presidentit janë mbajtur në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të përgjithshme, të cilat kanë natyrë thellësisht politike, pasi përmes tyre materializohet demokracia e drejtpërdrejtë, përforcohet stabiliteti dhe legjitimiteti i qeverisjes. Me anë të zgjedhjeve, qytetarët ushtrojnë të drejtën për të votuar dhe zgjedhur përfaqësuesit politikë të tyre, bazuar në konkurrimin e drejtë dhe të barabartë të partive dhe programeve politike që ato ofrojnë.

21. Shumica ka theksuar gjithashtu se, edhe në kontekstin e rolit aktiv që ka zgjedhur të mbajë Presidenti gjatë mandatit të tij kushtetues, qëndrimi i tij në ushtrim të detyrës, ndërkohë që ka qenë i veshur me petkun zyrtar të Kryetarit të Shtetit, i materializuar në deklarata dhe postime të shumta nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik dhe në përmbajtje me mesazhe politike, para dhe gjatë fushatës zgjedhore, përbën veprimtari me natyrë politike. Gjykata nuk mund të diktojë mënyrën se si duhet të sillet ose komunikojë Presidenti në një kontekst të caktuar politik apo historik, por ajo thekson se teksti kushtetues, praktika kushtetuese e krijuar ndër vite që reflekton mënyrën se si është ushtruar ky funksion, pritshmëritë e popullit, të palëve dhe

aktorëve politikë si dhe vetëdija e arsyeshme e vetë Presidentit në lidhje me rolin e tij, janë elementet që përcaktojnë mënyrën se si duhet të sillet, madje edhe si duhet të shihet ai (*shih paragrafët 182, 185 dhe 186 të vendimit*).

22. Duke e përmbledhur arsyetimin si më sipër, shumica ka vlerësuar premisën se shkak për shkarkimin e Presidentit është shkelja e rëndë e Kushtetutës ose krimi i rëndë, e cila, bazuar në kriteret e përcaktuara në vendim (*shih paragrafët 144-149 të vendimit*), që të konsiderohet e tillë duhet jo vetëm të bjerë ndesh me një parashikim/ndalim kushtetues, për rrjedhojë të cenojë një marrëdhënie, vlerë ose çështje që mbrohet në mënyrë të shprehur nga Kushtetuta, por edhe të provohet në drejtim të pasojave dhe efekteve reale në jetën e vendit, si dhe të natyrës së pakthyeshme e pamundësisë së riparimit të dëmit kushtetues, përveçse me shkarkimin e Presidentit nga detyra. Duke ritheksuar se shkarkimi i Presidentit ndërhyn në mënyrë të pazakontë në funksionimin e rendit kushtetues, si një ngjarje përjashtimore, që synon të mbrojë Kushtetutën në atë masë që përfitimet e mbrojtjes së saj të kenë epërsi mbi humbjen që do t'i shkaktonte vendit shkarkimi i tij, në rastin konkret veprimtaria e Presidentit me natyrë politike, pavarësisht nëse ka qenë ose jo edhe partiake, nuk rezulton të ketë sjellë pasoja dhe efekte reale në drejtim të cenimit të thelbit të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, veçanërisht atyre që zbatohen gjatë procesit zgjedhor, të rendit kushtetues ose funksionimit të institucioneve të shtetit, në përmasa të atilla që do të diktonin vënien para përgjegjësisë kushtetuese të Presidentit dhe do të justifikonin shkarkimin e tij nga detyra. Për rrjedhojë, shumica vlerësoi se veprimtaria politike e Presidentit, para dhe gjatë fushatës zgjedhore, nuk konsiderohet si shkelje e rëndë e Kushtetutës (*shih paragrafin 187 të vendimit*).

23. Por, në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, bazuar në analizën e kritereve që përcaktojnë shkeljen e rëndë dhe në faktet e paraqitura gjatë këtij gjykimi, rezulton se veprimtaria e Presidentit, para dhe gjatë fushatës për zgjedhjet e përgjithshme 2021, ka qenë jo vetëm politike, por edhe me natyrë të pastër e të qartë partiake dhe, si e tillë, përbën shkelje të rëndë të Kushtetutës për argumentet që do të parashtroj në vijim.

24. Sikurse u theksua edhe më sipër, rëndësi të veçantë në këtë analizë ka momenti kohor kur janë mbajtur qëndrimet e Presidentit, pikërisht ai i zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, gjatë së cilës partitë politike janë protagoniste kryesore dhe intensifikojnë veprimtarinë e tyre, me qëllim tërheqjen e besimit të elektoratit, në përputhje me një prej objektivave të tyre kryesore politike, që është marrja e pushtetit nëpërmjet zgjedhjeve.

25. Gjykata në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka theksuar se partitë politike luajnë rolin kryesor në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve në të gjitha fushat e jetës publike, të cilin ato synojnë ta transformojnë në vullnet shtetëror, nëse fitojnë zgjedhjet e përgjithshme, çka i bën ato subjektet me rëndësi të posaçme. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Ato marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike dhe kryesisht nëpërmjet: a) ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike; b) nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidentimin e aftësive të shtetasve për të marrë përsipër përgjegjësi publike; c) pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve e veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri te ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, demokracia përfaqësuese, ashtu edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Mes partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta dhe shteti duhet të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë *(shih vendimet nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 28, datë 9.5.2012; nr. 32, datë 21.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu rikthyer deklaratave dhe qëndrimeve të Presidentit, të pranuara si prova gjatë këtij gjykimi kushtetues, të mbajtura në emisione televizive, konferenca shtypi ose rrjete sociale, rezulton se ato janë mbajtur para dhe gjatë periudhës së fushatës për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, përfshirë edhe ditën e heshtjes zgjedhore. Ato karakterizohen nga përsëritjet e shpeshta të mesazheve që përcjellin, si dhe janë mbajtur në platforma që ndikojnë në një masë të madhe në krijimin e opinionit publik, në këtë rast atij politik, duke qenë afër datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

27. Në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, qëndrime të tilla që janë përsëritur shpesh kanë synuar ndikimin e vullnetit të elektoratit që do të shfaqej në ditën e zgjedhjeve të përgjithshme në funksion të rezultatit të tyre, sepse ato si në rastin kur kanë qenë direkte ose indirekte, kanë qenë qartazi në kundërshtim të ashpër të shumicës qeverisëse dhe në mbështetje të grupimeve politike kundërshtare, ndërkohë që disa deklarata të tjera, po ashtu të lidhura me rezultatin e zgjedhjeve, kanë shkelur hapur parimet e qëndrimit mbi palët, asnjanësinë dhe neutralitetin që, sipas Kushtetutës, janë të detyrueshme për Presidentin.

28. Në këtë kuptim konsiderohen qëndrime që kanë synuar të ndikojnë në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve, veç të tjerave, deklarata të tilla publike si: "*Nga zgjedhjet e 25 prillit 2021, Shqipëria pret një përmbysje të madhe, jo thjesht një rotacion*"; "*Të gjithë janë nisur drejt kutive të votimit, për të sjellë ndryshimin historik duke çuar Shqipërinë në rrugën e duhur*"; "*Nuk ka patronazhist, fuks dhe bandit që mund ta ndalë ndryshimin e madh më 25 prill*"; "*Prandaj 25 prilli është referendum popullor kundër mafies së inceneratorëve e plehrave dhe kandidatëve të saj*"; "*Zgjedhjet duhej të ishin mbajtur me kohë, përmbysje demokratike më 25 prill 2021*"; "*Më 25 prill 2021 do të ketë një referendum mbarëkombëtar për të rrëzuar këtë sistem oligarkik, që kërkon t'i kthejë qytetarët shqiptarë në qenie pa vlerë, të pafuqishëm dhe të pambrojtur*". Përsëritja në deklarata të tilla publike e mesazheve të Presidentit për domosdoshmërinë e rotacionit, ndryshimit ose përmbysjes politike në ditën e zgjedhjeve, të drejtuara pikërisht ndaj zgjedhësve, të cilët ka identifikuar si ata që mund të sillnin me votë një rezultat të tillë, ka pasur si synim ndikimin në formimin e opinionit politik të këtyre të fundit.

29. Nga ana tjetër, konsideroj se janë qëndrime në kundërshtim të hapur me shumicën qeverisëse ose në mbështetje të subjekteve zgjedhore opozitare, veç të tjerave, edhe deklaratat publike të tilla si: "*Unë nuk besoj se zoti Rama mund të bëjë zgjedhje të ndershme*"; "*Qeveria po bën çdo gjë në këto zgjedhje për të prishur standardet e tyre*"; "*Opozita duhet të organizohet në mënyrën më të mirë për të parandaluar këto fenomene kriminale elektorale nga të cilat Kryerilindasi nuk shkëputet dot*"; "*Në Shqipëri është vetëm një kërcënim për zgjedhje të lira dhe të ndershme, është Edi Rama. Nuk është askush tjetër, nuk është as zoti Basha, nuk është asnjëri tjetër*".

30. Kurse në lidhje me qëndrimet e Presidentit që kanë shkelur parimet e qëndrimit mbi palët, të asnjanësisë dhe neutralitetit, që imponon funksioni dhe pozicioni i tij kushtetues, siç është analizuar më sipër, veç të tjerave, konsiderohen edhe deklarata publike të tilla si: "*Nëse Rama fiton 71 mandate me votë të lirë, unë jap dorëheqjen nga posti i Presidentit. Nëse ai merr 71 mandate pa prekur votën e popullit unë kaloj në opozitë dhe marr drejtimin e opozitës*"; "*Në rast se Rama fiton 71 mandate pa prekur votën do t`i jap edhe mandatin tim si President. T`i marrë të gjitha, ta marrë edhe Presidencën, të vërë atje një kukull. Nëse populli do votojë Ramën unë s'kam pse rri dhe një vit kot*". Në vlerësimin tim, këto qëndrime konsiderohen të tilla sepse e lidhin pozicionin dhe perspektivën institucionale të Presidentit me vetëm një rezultat të caktuar të zgjedhjeve të përgjithshme politike, ndërkohë që sikurse është arsyetuar në vendimin e Gjykatës, Presidenti jo vetëm që nuk duhet, por as edhe nuk duhet të duket se po investohet politikisht (*shih paragrafët 163 – 166 të vendimit*).

31. Pikërisht, duke mbajtur në konsideratë kohën e periudhës zgjedhore kur është kryer, frekuencën mjaft të shpeshtë përsëritëse të saj, qëllimin e hapur të deklaratave dhe qëndrimeve të cilat janë mbajtur publikisht, si dhe anësinë politike të treguar, kjo veprimtari e Presidentit është në substancë politiko-partiake, pasi përputhet plotësisht me rolin, funksionin dhe objektivin kryesor të partive politike gjatë fushatave zgjedhore (*shih paragrafët 15, 24 dhe 25 të mendimit në pakicë*).

32. Nëpërmjet kryerjes së një veprimtarie të tillë, Presidenti ka shkelur një ndalim kategorik

kushtetues, atë të parashikuar në nenin 89 të Kushtetutës, çka automatikisht sjell edhe shkeljen e nenit 86, pika 1 të saj, sepse sikundër është arsyetuar më hollësisht si në vendimin e shumicës, ashtu edhe në këtë mendim të pakicës (*shih paragrafët 11–15 të mendimit në pakicë*), kryerja e veprimtarisë politiko-partiake nga Presidenti është e papajtueshme me përmbushjen e funksionit të tij kushtetues si Kryetar i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit, në drejtim të parimeve të qëndrimit mbi palët, asnjanësisë dhe unitetit.

33. Në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, në veprimtarinë konkrete të sipërpërmendur, objekt i veprimtarisë hetimore të Kuvendit, si edhe objekt i vlerësimit nga kjo Gjykatë, gjenden të plotësuara në mënyrë të njëkohshme të gjitha kriteret që Gjykata ka arsyetuar se duhet të plotësohen, në mënyrë që shkelja e Kushtetutës nga Presidenti të konsiderohet e rëndë (*shih paragrafët 140 - 149 të vendimit*).

34. Duke i analizuar me radhë këto kritere, vlerësoj se lidhur me kriterin e parë të shkeljes së rëndë, rezulton se veprimtaria politiko-partiake e Presidentit ka shkelur norma të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë, përkatësisht nenin 86, pika 1, në lidhje me nenin 89 të saj. Kështu duke kryer veprimtari politiko-partiake, në kundërshtim me ndalimin kategorik kushtetues, Presidenti njëkohësisht ka shkelur edhe detyrimin kushtetues të nenit 86, pika 1 të Kushtetutës për t'u sjellë kurdoherë si Kreu i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit. Në këtë rast, norma kushtetuese e shkelur paraqitet me një peshë dhe rëndësi të të veçantë në tërësinë e normave të Kushtetutës, sepse përcaktimi i pozicionit dhe rolit të Presidentit në republikën tonë parlamentare reflekton parimet themelore kushtetuese, sikundër ato të shtetit të së drejtës, ndarjes dhe balancimit të pushteteve etj.

35. Lidhur me kriterin e dytë të shkeljes së rëndë, një veprimtari e tillë e përsëritur dhe e zgjatur në kohë gjatë gjithë periudhës zgjedhore, i ka prodhuar edhe pasojat e saj. Për sa më sipër, duke qenë se neni 89 i Kushtetutës përmban një ndalim kategorik për t'u kryer edhe një herë të vetme nga Presidenti, duke u shkelur në mënyrë të përsëritur prej tij ky parashikim kushtetues është shkaktuar humbja e besimit kushtetues tek institucioni, për rrjedhojë Presidenti nuk mund të përmbushë më detyrimet e nenit 86, pika 1, të Kushtetutës, për të qenë mbi palët, asnjanës, dhe për të përfaqësuar si një të tërë dhe të pandarë unitetin e të gjithë popullit. Në këtë mënyrë vlerësoj se është cenuar edhe arkitektura institucionale kushtetuese, brenda së cilës pozicioni i tij zë një vend qendror. Kjo pasojë rezulton po ashtu e rëndë, sepse i referohet një veprimtarie që cenon në mënyrë brutale dhe të dukshme Kushtetutën, për sa kohë që është tërësisht në të kundërt me ndalimin e nenit 89 të saj.

36. Kurse lidhur me kriterin e tretë të shkeljes së rëndë, mbahen në konsideratë një sërë faktorësh, sikurse rrethanat konkrete të kryerjes së shkeljeve të rënda dhe pasojat e shkarkimit, të cilat përfshijnë vlerësimin mbi bazën e provave nëse shkelja është aq e rëndë sa që nuk mund të riparohet veçse me shkarkimin e Presidentit nga detyra. Ndërkohë që mbahet në konsideratë edhe fakti që, nga njëra anë, vendimi i Gjykatës në këtë proces siguron garancitë kushtetuese të Presidentit, ndaj të cilit ka filluar procedura e shkarkimit dhe, nga ana tjetër, përcakton edhe jurisprudencën e detyrueshme në funksion të mbrojtjes së Kushtetutës nga shkeljet e rënda eventuale të Presidentit në të ardhmen, nëpërmjet kryerjes së veprimtarisë politiko-partiake të ndaluar. Mbi bazën e kësaj analize, arrij në përfundimin se, ndonëse përfaqëson një ngjarje përjashtimore, Gjykata duhej të deklaronte shkarkimin e Presidentit, sepse përfitimet e mbrojtjes së Kushtetutës, në rastin konkret në shqyrtim, kanë epërsi dhe i tejkalojnë efektet që shkaktohen në jetën publike dhe institucionale nga shkarkimi i Presidentit.

37. Lidhur me kriterin e fundit të shkeljes së rëndë, pra vërtetimin e fajësisë së Presidentit, sikurse u përmend edhe më sipër, i bashkohem arsyetimit të shumicës për analizën e këtij koncepti kushtetues, që nënkupton se Presidenti, i vetëdijshëm për rëndësinë e autoritetit shtetëror që mbart dhe të rolit përfaqësues që duhet të luajë, si dhe duke parashikuar dëmin që shkakton, kryen akt antikushtetues duke cenuar vlerat themelore, të cilat rendi kushtetues ka detyrë t'i mbrojë (*shih paragrafët 133–135 të vendimit*).

38. Në kuptim të sa më sipër, nga provat e këtij gjykimi kushtetues ka rezultuar tërësisht e provuar se gjatë veprimtarisë së tij të lartpërmendur, që siç kam arsyetuar vlerësoj se është kryer në shkelje të rëndë të Kushtetutës, Presidenti ka qenë plotësisht i vetëdijshëm jo vetëm për detyrimet që burojnë nga pozicioni dhe roli i tij kushtetues, por edhe për pasojat eventuale nga këto akte të kryera prej tij në ushtrim të detyrës. Në lidhje me qëndrimin e tij Presidenti, si gjatë procedurës së shkarkimit në Kuvend ashtu edhe gjatë seancave publike në Gjykatë, ka mbajtur qasjen se ka vepruar në respektim të plotë të parashikimeve të Kushtetutës, edhe pse karakteristika të tilla si qëndrimi mbi palët, asnjanësia apo përfaqësimi i unitetit të popullit për funksionin e tij nuk burojnë vetëm nga teksti kushtetues, por janë trajtuar në jurisprudencë të vazhdueshme nga Gjykata, madje edhe në çështje ku palë në proces ka qenë edhe ai vetë (shih *vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 64, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Kjo sepse, në rastet kur Gjykata bën interpretimin e normave kushtetuese, sikurse edhe për rolin dhe pozicionin e Presidentit, ai interpretim është vetë kuptimi i Kushtetutës dhe i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë, bazuar në parashikimet e neneve 124, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës dhe jurisprudencën e saj.

39. Por sikurse u përmend edhe më sipër, i vetëdijshëm për veprimtarinë në kundërshtim të hapur me detyrimet që burojnë nga pozicioni dhe roli i tij kushtetues, Presidenti kreu veprimtari politiko-partiake në periudhën para dhe gjatë zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2021. Kjo veprimtari nuk u krye vetëm një herë, por në mënyrë të përsëritur, me mjetet dhe format e lartpërmendura, me qëllimin për të ndikuar vullnetin e elektoratit në funksion të rezultatit të zgjedhjeve, duke shkelur kështu nenet 86, pika 1 dhe 89 të Kushtetutës. Rrethana të tilla, sikurse përmbajtja e qëndrimeve, frekuenca e shpeshtë e përsëritjes së tyre, mjetet dhe mënyrat e përdorura për përhapjen e tyre, momenti dhe vendi ku ato janë mbajtur, kanë rëndësi për të krijuar bindjen edhe për qëllimin e kësaj veprimtarie të Presidentit gjatë periudhës zgjedhore, që sikurse u analizua më sipër, ka qenë ai i ndikimit në formimit e opinionit politik të zgjedhësve, në funksion të një rezultati të caktuar.

40. Në këto rrethana, në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, rezulton e provuar edhe fajësia si koncept kushtetues gjatë kryerjes së shkeljeve të rënda të Kushtetutës nga Presidenti, që thënë ndryshe mund të përcaktohet si qëndrimi subjektiv i tij ndaj shkeljeve kushtetuese dhe pasojave të saj.

41. Për tërësinë e argumenteve të përmendura më sipër, arrij në përfundimin se Presidenti gjatë procesit të zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021, duke kryer në mënyrë të përsëritur veprimtari politiko-partiake, ka kryer shkelje të rënda të neneve 86, pika 1 dhe 89 të Kushtetutës, për rrjedhojë ka shkelur rëndë edhe nenin 88, pika 3, të Kushtetutës dhe, në këto kushte, Gjykata, në përputhje me nenin 90, pika 3, të Kushtetutës dhe nenin 63, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, duhej të kishte deklaruar shkarkimin e tij nga detyra.

Marrë më 16.2.2022.
Anëtarë: Altin Binaj

VENDIM
Nr. 5, datë 22.2.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha,	kryetare;
Elsa Toska	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Përparim Kalo	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 22.2.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 14 (E) 2021 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Emiljano Shullazi

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2, datë 12.1.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 63, datë 3.3.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; dhe nr. 00-2021-360, datë 25.5.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2, të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(Prokuroria e Posaçme)*, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 122, datë 13.11.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, bazuar në nenet 109/b/1, 28/4, 334/1 dhe 333/a/1, të Kodit Penal *(KP)* ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë", kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal në dëm të shtetasve Y.B. dhe J.Z., "Grupi i strukturuar kriminal", si dhe deklarimin e tij të pafajshëm për disa vepra të tjera penale. Në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 55 të KP-së e ka dënuar atë me 14 vjet burgim, ndërsa në zbatim të nenit 33 të këtij kodi dhe nenit 12 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", të ndryshuar *(ligji nr. 8328/1998)*, ka vendosur vuajtjen e dënimit nga kërkuesi në burg të sigurisë së zakonshme.

2. Në zbatim të vendimit nr. 286, datë 18.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për fillimin e funksionit të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar", gjykatat për krime të rënda u emërtuan dhe filluan të funksionojnë e ushtrojnë kompetencat Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë*) dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Apelit*).

3. Në datën 20.12.2018, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 108/2018, "Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", të ndryshuar", në të cilin u shtua dispozitë e veçantë për zbatimin e regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë. Ky ligj është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 15.1.2019, dhe ka hyrë në fuqi në datën 31.1.2019.

4. Me shkresën nr. 166 prot., datë 1.11.2019, bazuar në nenet 2 dhe 13/1 të ligjit nr. 8328/1998, si dhe në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2, datë 24.5.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm, "Për zbatimin e ligjit lidhur me regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë", drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda i është drejtuar ministrit të Drejtësisë me kërkesë për vendosjen e kërkuesit në regjim të posaçëm në burg të sigurisë së lartë për një afat 1-vjeçar. Kjo kërkesë është rikonfirmuar me shkresën nr. 27 prot., datë 10.3.2020, të Prokurorisë së Posaçme, në përgjigje të shkresës me nr. 443 prot., datë 6.3.2020 të ministrit të Drejtësisë për rikonfirmimin e saj.

5. Me urdhrin nr. 253, datë 28.7.2020, "Për vendosjen në regjimin e posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë për të paraburgosurin Emiljano Shullazi" *(urdhri nr. 253/2020)*, ministri i Drejtësisë ka urdhëruar, ndër të tjera, vendosjen e kërkuesit në këtë regjim për një vit pranë Institucionit të Ekzekutimit të Dënimeve Penale *(IEVP)* "Jordan Misja". Ky urdhër është ekzekutuar në datën 1.8.2020. Ndërkohë, me urdhrin nr. 474, datë 29.7.2021, të

ministrit të Drejtësisë *(urdhri nr. 474/2021)* është disponuar zgjatja e masës së regjimit të posaçëm ndaj kërkuesit edhe për një vit tjetër. Ky urdhër i dytë është bazuar në ligjin nr. 81/2020, datë 25.6.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" *(ligji nr. 81/2020)*, i cili, ndonëse ka shfuqizuar ligjin nr. 8328/1998, përmban të njëjtat rregullime për vendosjen e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burg.

6. Në datën 6.8.2020, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë me ankim kundër urdhrit nr. 253/2020, e cila, me vendimin nr. 2, datë 12.1.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

7. Mbi apelin e kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit, me vendimin nr. 63, datë 3.3.2021, ka vendosur: *"Miratimin e vendimit nr. 2, datë 12.1.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar."*.

8. Me vendimin nr. 00-2021-360, datë 25.5.2021, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*.

9. Në datën 2.9.2021, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë sipas objektit.

10. Në datën 19.10.2021, Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 15.11.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të aspekteve të mëposhtme:

11.1 E drejta e mbrojtjes, pasi urdhri nr. 253/2020, përmes të cilit ai është vendosur në regjimin e posaçëm në burg të sigurisë së lartë, është bazuar në katër shkresa të institucioneve shtetërore të klasifikuara si të nivelit "sekret" dhe "i kufizuar" nga ligji nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar *(ligji nr. 8457/1999)* me përmbajtjen e të cilave nuk është njohur as ai dhe as gjykatat. Gjykata e Lartë, ndërsa pranon se palët në gjykim kanë të drejtë të njihen me aktet shkresore, provat dhe faktet që administrohen në proces, në mënyrë paradoksale ka vendosur për mospranimin e rekursit.

11.2 E drejta e aksesit, për shkak të pamundësisë për t'u njohur me këto akte, të cilat nuk janë shqyrtuar as nga gjykatat, qoftë edhe pjesërisht, për të vlerësuar ndërhyrjen e veprimtarisë shtetërore në sferën private të individit. Pavarësisht se fillimisht Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vlerësuar marrjen nga Ministria e Drejtësisë të dokumentacionit të nevojshëm në funksion kërkesës së tij për kundërshtimin e urdhrit nr. 253/2020, me vendim të ndërmjetëm ka vendosur revokimin e vendimit të saj për kërkimin e këtij dokumentacioni, me arsyetimin se aktet janë të klasifikuara "sekret" dhe se ajo nuk ishte e certifikuar për t'u njohur me to. Klasifikimi i akteve si "sekret" dhe "i kufizuar" është bërë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 8457/1999. Vendosja e kërkuesit në regjimin e posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burg të sigurisë së lartë është bërë, pasi, sipas informacioneve të agjencive ligjzbatuese, ai "mban komunikime/kontakte me organizatën kriminale ku bën pjesë dhe me organizata të tjera, si dhe me të paraburgosurit e tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë dhe organizatave të tjera, me të cilat bashkëpunojnë" dhe jo për mbrojtjen e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë, siç kërkon ligji nr. 8457/1999.

11.3 Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti, pasi urdhri nr. 253/2020 është nxjerrë me qëllimin e vetëm për t'i mohuar atij të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për t'i kundërshtuar ato. Kufizimi i së drejtës për t'u njohur me aktet mund të bëhet vetëm nëse nuk cenon të drejtën e mbrojtjes në atë masë sa ta bëjë atë joefektive. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë nuk mori asnjë masë për të garantuar aksesin në informacionet mbi të cilat është bazuar urdhri nr. 253/2020, duke shkelur parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe duke e privuar kërkuesin

nga e drejta e mbrojtjes. Urdhri nr. 474/2021 i ministrit të Drejtësisë, që ka zgjatur masën e regjimit të posaçëm ndaj kërkuesit edhe për një vit, është bazuar sërish në 4 shkresa të klasifikuara "sekret", me përmbajtjen e të cilave ai nuk është njohur. Ndërhyrja që ligji nr. 81/2020, si ligj i zakonshëm, ka bërë në KPP është e sforcuar, pasi vendimi i ministrit të Drejtësisë përbën një akt administrativ dhe jo vendim gjyqësor. Si i tillë, kundërshtimi i tij duhet të bëhet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, duke thirrur si subjekt të interesuar në këtë gjykim ministrin e Drejtësisë. Kërkesat e kërkuesit për thirrjen në gjykim të këtij ministri, gjatë procedurave të kundërshtimit të urdhrit nr. 474/2021, nuk u morën parasysh as nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe as nga Gjykata e Posaçme e Apelit.

12. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, ka prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, se urdhri nr. 253/2020 dhe vendimet e kundërshtuara të gjykatave janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, pasi:

12.1 Në aspektin procedural, kërkesa e kërkuesit është pa objekt. Efektet e urdhrit kanë zgjatur vetëm një vit dhe kanë pushuar në datën 28.7.2021. Për rrjedhojë, në këtë fazë, rigjykimi i çështjes në gjykatat e sistemit gjyqësor nuk do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur.

12.2 Masat për vendosjen e kërkuesit në regjimin e posaçëm janë të përkohshme dhe proporcionale. Këto masa janë vendosur për një interes publik, siç është lufta kundër krimit të organizuar. Informacionet e vëna në dispozicion tregojnë se kërkuesi e vazhdonte aktivitetin kriminal brenda ambienteve të IEVP-së dhe se sjellja e tij mund të vinte në rrezik sigurinë publike në të ardhmen.

12.3 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i pabazuar, pasi njohja e tij me aktet ka qenë efektive. Ai dhe gjykata janë njohur mjaftueshmërisht me thelbin e përmbajtjes së informacionit të klasifikuar, për aq sa është e nevojshme për debatin gjyqësor dhe vendimmarrjen.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

14. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

16. Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, për të cilin ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm,

parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese *(shih vendimet nr. 23, datë 29.4.2021; nr. 54, datë 24.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte *(shih vendimet nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 29, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se, përjashtimisht, kontrollit të saj i nënshtrohen edhe ato vendime të ndërmjetme, karakteri i të cilave do të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000. Ky përjashtim zbatohet vetëm kur plotësohen së bashku tri kritere: i. vendimi i ndërmjetëm duhet që të ketë vendosur mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; ii. ky lloj vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë; iii. shkelja e pretenduar duhet të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes së të drejtës kushtetuese *(shih vendimet nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 40, datë 18.7.2012; nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimet e kundërshtuara i plotësojnë kriteret e mësipërme të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka ngritur pretendime për masën e regjimit të posaçëm të vendosur ndaj tij përmes urdhrit nr. 253/2020, të cilën ai e ka kundërshtuar gjyqësisht deri në Gjykatën e Lartë. Në vendimet e tyre gjykatat janë shprehur për pretendimet e kërkuesit dhe vendimmarrja e këtyre gjykatave, përfshirë edhe ajo e Gjykatës së Lartë, janë objekt i ankimit të tij kushtetues. Me anë të këtyre vendimeve kërkuesit i është kufizuar liria në një regjim të posaçëm, përmes një procesi të veçantë gjyqësor, që ai e kundërshton si të parregullt në aspektet e së drejtës së mbrojtjes, të aksesit, si dhe të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

21. Po në këtë drejtim, Gjykata vëren se pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i çështjes së fajësisë së kërkuesit vazhdon ende, vendimi përfundimtar që do të jepet për themelin e saj nuk është i tillë që të mund të ndryshojë vendimet e kundërshtuara për vendosjen e tij në regjim të posaçëm në burg të sigurisë së lartë. Për rrjedhojë, procesi gjyqësor i zhvilluar në këtë drejtim është autonom nga procesi i shqyrtimit të çështjes së themelit për akuzat penale në ngarkim të kërkuesit. Vendosja në këtë regjim të posaçëm, i ndryshëm nga regjimet e zakonshme të sigurisë për vuajtjen e dënimeve penale, ka çuar në kufizim të mëtejshëm të të drejtave që kërkuesi kishte si i paraburgosur në IEVP-në "Jordan Misja", çka bën që procesi gjyqësor në lidhje me këto të drejta të qëndrojë i pavarur nga të drejtat e tij përgjatë procesit penal të themelit, në lidhje me akuzën penale në ngarkim të tij. Në linjën e këtij arsyetimi, Gjykata vlerëson të theksojë edhe qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)*, e cila i ka konsideruar vendimet e dhëna nga gjykatat kombëtare ndaj një urdhri të ministrit të Drejtësisë për vendosjen e një të pandehuri ose të burgosuri në regjim të posaçëm të burgut të sigurisë së lartë si procese të veçanta nga procesi penal i themelit i zhvilluar ndaj tij *(shih vendimet e GJEDNJ-së Barbaro k. Italisë, datë 16.2.2010; Enea k. Italisë, datë 17.9.2009; Asciutto k. Italisë, datë 27.11.2007; Ganci k. Italisë, datë 30.10.2003)*. Gjykata konstaton, gjithashtu, se shkelja e pretenduar nga kërkuesi është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimeve të kundërshtuara.

22. Për sa më lart, Gjykata vëren se për vendimet gjyqësore, objekt kërkese, kërkuesi i ka shteruar mjetet efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, prandaj ato janë të një natyre të tillë që i nënshtrohen kontrollit kushtetues.

23. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka mbyllur procesin gjyqësor në gjykatat e zakonshme, mban datën 25.5.2021, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 2.9.2021. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor, të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

24. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* të kërkuesit, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata evidenton se kërkuesi, në objektin e ankimit kushtetues, ka pretenduar shkeljen e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në aspektin e së drejtës së mbrojtjes, aksesit, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të cilat kanë natyrë kushtetuese, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se në vështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pretendimet e tij përfshihen në juridiksionin kushtetues.

25. Gjykata vëren se sipas GJEDNJ-së, masat përmes të cilave një i paraburgosur ose i burgosur vendoset në regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burg të sigurisë së lartë, në vetvete, nuk kanë karakter ndëshkues, por parandalues *(shih vendimin e GJEDNJ-së Provenzano k. Italisë, datë 25.10.2018, § 150)*. Për rrjedhojë, kufizimet që i bëhen të drejtave të një të burgosuri si rezultat i vendosjes së tij në regjim të posaçëm burgimi, bien brenda sferës së të drejtave personale dhe, si të tilla, përfshihen brenda konceptit të "të drejtave dhe detyrimeve civile", të parashikuar në nenin 6/1 të KEDNJ-së që garanton të drejtën e procesit të rregullt *(shih vendimet e GJEDNJ-së Enea k. Italisë, datë 17.9.2009, §§ 97-98; Papalia k. Italisë, datë 4.12.2007, § 27; Musumeci k. Italisë, datë 11.1.2005, § 36; Ganci k. Italisë, datë 30.12.2003, §§ 20-26)*. Sipas GJEDNJ-së, garancitë e procesit të rregullt ligjor, të tilla si e drejta për akses, për t'u dëgjuar, për barazi të armëve dhe kontradiktoritet, zbatohen edhe në këto lloj procedurash *(shih vendimet e GJEDNJ-së Musumeci k. Italisë, datë 11.1.2005, §§ 48–49; Ganci k. Italisë, datë 30.10.2003, §§ 20–26; Ëerner k. Austrisë, datë 24.11.1997, § 66)*.

26. Gjykata thekson se, në kushtet kur objekt i gjykimit kushtetues janë vendimet gjyqësore që lidhen me urdhrin e parë nr. 253/2020, në situatën kur regjimi i posaçëm i burgut të sigurisë së lartë ndikon në të drejtat dhe liritë themelore të individit, kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet e tij kushtetuese për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, aksesit, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

27. Gjykata konstaton, gjithashtu, se kërkuesi, në thelb, kundërshton urdhrin nr. 253/2020, duke paraqitur në përmbajtje të kërkesës edhe pretendime për urdhrin pasues nr. 474/2021, që ka zgjatur më tej me 1 vit vënien e tij në regjim të posaçëm në burg të sigurisë së lartë. Nga ana tjetër, në parashtrimet e saj para Gjykatës, Prokuroria e Posaçme ka pretenduar se efektet e urdhrit nr. 253/2020 kanë zgjatur vetëm 1 vit dhe kanë pushuar në datën 28.7.2021. Në këto kushte, ky akt nuk mund të sjellë më pasoja, për shkak të mbarimit të afatit të përcaktuar ligjërisht.

28. Në jurisprudencë konstante, Gjykata ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave *(shih vendimin nr. 8, datë 23.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Konkretisht, e drejta e kërkuesit për akses dhe për t'u njohur me provat, mbi bazën e të cilave ai është vendosur në regjim të posaçëm në burg të sigurisë së lartë, është e lidhur ngushtësisht me ushtrimin e të drejtave të tij të mbrojtjes, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim.

29. Gjykata vëren se, në thelb, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar atij të drejtën për proces të rregullt ligjor, duke mos i dhënë mundësi të mbrohet efektivisht dhe të ushtrojë të drejtën e kontradiktoritetit në gjykim. Për rrjedhojë, në zbatim të parimit *iura novit curia,* Gjykata vlerëson të analizojë pretendimet e ngritura nga kërkuesi në këndvështrim të së drejtës për kontradiktoritet, si pjesë thelbësore e procesit të rregullt ligjor, duke qenë se cenimi i

saj ndikon edhe në elemente të tjera të procesit të rregullt, të tilla si e drejta e mbrojtjes, aksesi dhe barazia e armëve.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të kontradiktoritetit

30. Kërkuesi ka kundërshtuar në Gjykatë vendimet gjyqësore, të cilat kanë shqyrtuar ankimin e tij ndaj urdhrit nr. 253/2020, përmes të cilit ai është vendosur në regjimin e posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burg të sigurisë së lartë. Sipas tij, vendosja në këtë regjim është bazuar në katër shkresa të institucioneve të ndryshme shtetërore të klasifikuara "sekret" dhe "i kufizuar", sipas ligjit nr. 8457/1999, me përmbajtjen e të cilave nuk është njohur as ai dhe as gjykatat. Ndërkohë që fillimisht Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vlerësuar të nevojshme tërheqjen nga Ministria e Drejtësisë të praktikës për nxjerrjen e urdhrit nr. 253/2020, me vendim të ndërmjetëm ka revokuar vendimin e saj për kërkimin e këtij dokumentacioni, me arsyetimin se aktet ishin të klasifikuara "sekret" dhe se ajo nuk ishte e certifikuar për t'u njohur me to. Po sipas kërkuesit, legjislacioni në fuqi njeh të drejtën e gjykatës për të pasur akses në informacionet e klasifikuara "sekret shtetëror" dhe detyrimi për ruajtjen e sekretit nuk e pengonte atë të vlerësonte ligjshmërinë e akteve, të cilat qenë në themel të vendimmarrjes së ministrit të Drejtësisë për vendosjen e kërkuesit në regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burg. Mosshqyrtimi dhe mosvlerësimi i këtyre akteve nga gjykatat i ka cenuar atij të drejtën e aksesit e të mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Po kështu, Gjykata e Lartë, ndërsa pranon të drejtën e palëve në gjykim për t'u njohur me aktet shkresore, provat dhe faktet që administrohen në proces, në mënyrë paradoksale ka vendosur për mospranimin e rekursit.

31. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka pretenduar se si organ të cilit i janë adresuar aktet që përbëjnë sekret, nuk ka qenë e autorizuar nga institucionet që kanë prodhuar këto akte për të bërë ekspozim të tyre për gjykatën ose kërkuesin. Kërkuesi dhe gjykata janë njohur mjaftueshmërisht me thelbin e përmbajtjes së informacionit të klasifikuar, për aq sa është e nevojshme për debatin gjyqësor dhe vendimmarrjen. Njohja me përmbajtjen e këtij informacioni u ka dhënë mundësi palëve, përfshirë dhe kërkuesin, të debatojnë në lidhje me të, si dhe gjykatës që të vlerësojë dhe të krijojë bindjen e saj për këto akte. Kërkesa e ish-drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, si dhe konfirmimi i saj nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, kanë qenë të mjaftueshme për gjykatën për të konkluduar për çështjen dhe për të garantuar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve për palët në gjykim. Në këto kushte, njohja me aktet ka qenë efektive dhe parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është garantuar. Kjo mënyrë procedimi nuk ka cenuar thelbin e parimit të procesit të rregullt ligjor.

32. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit *(shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*.

33. Sipas Gjykatës, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njërës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do

të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë *(shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 19, datë 1.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

34. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre, është në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj *(shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre *(shih vendimin nr. 19, datë 1.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

35. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit kushtetues të çështjes, Gjykata vëren se përmes shkresës nr. 166 prot., datë 1.11.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda i është drejtuar ministrit të Drejtësisë me kërkesë për vendosjen e kërkuesit në regjim të posaçëm në burg të sigurisë së lartë për një afat 1-vjeçar, pasi ishte informuar nga agjencitë ligjzbatuese se gjatë kohës kur ndodhej në ambientet e IEVP-së "Jordan Misja", ai vazhdonte të ushtronte veprimtari kriminale që konsistonin në dyshime për kanosje të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda me qëllim për të ndikuar në vendimmarrjen e tyre, dyshime për realizimin e takimeve me të paraburgosur të tjerë pranë IEVP-së, si dhe transmetim urdhrash jashtë saj për kryerje veprimtarie kriminale të paligjshme. Po kështu, kjo prokurori ka informuar ministrin e Drejtësisë se edhe ndaj drejtuesve të IEVP-së nr. 313, Tiranë ishte bërë kallëzim penal për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së, pasi i kishin mundësuar kërkuesit kushte lëvizjeje dhe takime në kundërshtim me ligjin. Në këto kushte, vendosja e tij në regjimin e posaçëm të burgut të sigurisë së lartë do të shërbente për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë si në ambientet e vuajtjes së dënimit, ashtu edhe jashtë.

36. Me ngritjen e Prokurorisë së Posaçme, kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e datës 1.11.2019, është rikonfirmuar edhe prej saj, përmes shkresës nr. 27 prot., datë 10.3.2020. Në vijim, bazuar në shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrisë së Brendshme, si dhe në të dhëna e informacione të vëna në dispozicion nga agjenci të tjera ligjzbatuese, ministri i Drejtësisë ka nxjerrë urdhrin nr. 253/2020 për vendosjen e kërkuesit në regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burg të sigurisë së lartë.

37. Gjykata vëren se kërkuesi ka paraqitur ankim ndaj urdhrit nr. 253/2020 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, e cila në vendimin e saj nr. 2, datë 12.1.2021 ka arsyetuar, ndër të tjera: *"Në gjykim të kësaj natyre, çështja që shtrohet për zgjidhje lidhet me ligjshmërinë e urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, tek bazueshmëria e këtij urdhri në ligj, nëse është respektuar forma dhe procedura e parashikuar në ligj, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 13/1 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, të ndryshuar, dhe jo tek vlerësimi i këtyre provave në vetvete." (shih paragrafin e dytë, faqja 7, të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë)*, arsyetim i cili është pasqyruar edhe në vendimin nr. 00-2021-360, datë 25.5.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për çështjen *(shih paragrafin e dytë, faqja 3, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

38. Gjykata thekson se sipas pikës 6 të nenit 13/1 të ligjit nr. 8328/1998, e drejta e ankimit ndaj urdhrit për vendosjen në regjim të posaçëm nuk kufizohet vetëm për shkaqe procedurale, që do të thotë se përmes ankimit kërkuesit i jepet e drejta të ngrejë jo vetëm shkaqe procedurale, por edhe substanciale, që lidhen me thelbin e masës së vendosjes në regjim të posaçëm. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në zbatim të parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës, edhe nenet 27 dhe 28 të saj parashikojnë garanci të shtuara procedurale dhe substanciale, që i referohen kufizimeve të të drejtave themelore për personat të cilët ndodhen në kushtet e kufizimit të lirisë së tyre në ambientet e paraburgimit ose të burgimit.

39. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se urdhri i ministrit të Drejtësisë duhet vlerësuar jo vetëm nga ana formalo-procedurale, por në veçanti nga ana substanciale, pasi një urdhër i tillë kufizon në shkallë të lartë të drejtat dhe liritë e kësaj kategorie personash. Në këtë pikëpamje, në aspektin kushtetues merr rëndësi përcaktimi i shkaqeve dhe i të dhënave mbi të cilat është bazuar vendosja e kërkuesit në këtë regjim.

40. Edhe pse në pretendimet e tij kërkuesi e ka cilësuar urdhrin nr. 253/2020 si një urdhër me natyrë administrativo-penale, Gjykata konstaton se ai përbën një akt administrativ dhe se kompetenca për nxjerrjen e tij i është njohur ministrit të Drejtësisë me ligj, e konkretisht me ligjin nr. 8328/1998. Në këtë kuptim, Gjykata do të analizojë procesin me objekt kundërshtimin e këtij urdhri në drejtim të cenimit të së drejtës së kërkuesit për njohjen me aktet mbi të cilat është bazuar vendosja e tij në këtë regjim me qëllim të garantimit të parimit të kontradiktoritetit në gjykim, i cili është i zbatueshëm edhe në rastin e shqyrtimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të urdhrave të kësaj natyre.

41. Gjykata thekson se në rastet e vendosjes së të burgosurit në regjim të posaçëm të sigurisë së lartë, juridiksioni i zakonshëm duhet të vlerësojë thelbin e çështjes, e konkretisht nëse urdhri i ministrit të Drejtësisë është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së *(shih vendimet e GJEDNJ-së Ganci k. Italisë, datë 30.10.2003, § 31; Asciutto k. Italisë, datë 27.11.2007, § 38)*. Pavarësisht se e drejta e një pale në gjykim për akses në dokumente nuk është absolute, çdo kufizim i kësaj të drejte duhet të jetë i tillë që nuk cenon thelbin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6/1 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, gjykatat duhet të kenë akses të pakufizuar në të gjithë dokumentacionin e klasifikuar mbi të cilin është bazuar vendimmarrja e autoritetit shtetëror. Ato duhet të kryejnë një shqyrtim të detajuar të arsyeve të autoritetit shtetëror për mosbërjen me dije të dokumenteve të klasifikuara, t'i vlerësojnë ato, si dhe të urdhërojnë bërjen të ditur të atyre dokumenteve që vlerësojnë se nuk justifikojnë klasifikimin. Për më tepër, gjykatat janë të pajisura me pushtet për të vlerësuar thelbin e vendimmarrjes së autoritetit shtetëror, të heqin kufizimin për pasjen e certifikatës së sigurisë, si dhe të shfuqizojnë, kur është rasti, një vendim arbitrar të autoritetit. Ato duhet të ushtrojnë pushtetin e tyre duke treguar kujdes në shqyrtimin e çështjeve të kësaj natyre, si për sa i përket konfidencialitetit të dokumenteve të klasifikuara, ashtu edhe të arsyeve të masës së dhënë ndaj kërkuesit, duke arsyetuar vendimmarrjen e tyre në varësi të rastit konkret *(shih vendimin e GJEDNJ-së Regner k. Republikës Çeke, datë 19.9.2017, §§ 153, 154)*.

42. Sipas GJEDNJ-së, është thelbësore që shtetet të kenë një hapësirë vlerësimi në lidhje me mjetet e përdorura për garantimin e sigurisë dhe rendit në një kontekst të vështirë siç është burgu. Megjithatë, "drejtësia nuk përfundon në dyert e burgut" dhe të burgosurve nuk duhet t'u mohohen garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së. Çdo kufizim i këtyre të drejtave duhet t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor [...] me qëllim që të arrihet një ekuilibër i drejtë mes detyrimeve me të cilat përballet shteti në kontekstin e burgjeve, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave të të burgosurve, nga ana tjetër *(shih vendimin e GJEDNJ-së Enea k. Italisë, datë 17.9.2009, §§ 105–106)*.

43. GJEDNJ-ja ka theksuar, gjithashtu, se autoritetet shtetërore nuk mund t'i shmangen kontrollit efektiv të akteve të tyre nga gjykatat, duke pretenduar se bëhet fjalë për çështje të sigurisë kombëtare ose terrorizmit, pasi ekzistojnë teknika që mund të përdoren, të cilat marrin parasysh shqetësimet e tyre të ligjshme për natyrën dhe burimet e informacionit të inteligjencës, duke garantuar njëkohësisht edhe të drejtat procedurale të individit *(shih vendimet e GJEDNJ-së Dağtekin dhe të tjerë k. Turqisë, datë 13.12.2007, §§ 34–35; Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar, datë 15.11.1996, § 131)*.

44. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, mbrojtësit e kërkuesit kanë kërkuar të njihen me përmbajtjen e shkresave të klasifikuara "sekret" dhe "i kufizuar", të cituara në urdhrin nr. 253/2020 të ministrit të Drejtësisë *(shih faqet 108-110 të dosjes gjyqësore)*.

45. Në referim të procesverbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara në këtë gjykatë, rezulton

se në seancën e datës 6.10.2020 gjyqtarja e çështjes ka çmuar se ishte e nevojshme të tërhiqej dosja mbi të cilën është mbështetur urdhri nr. 253/2020 i ministrit të Drejtësisë për vënien e kërkuesit në regjimin e posaçëm të sigurisë në burg *(shih procesverbalin e seancës së datës 6.10.2020, faqja 11)* dhe i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për vënien në dispozicion të kësaj praktike, duke i sjellë në vëmendje respektimin e kufizimeve të vendosura në ligjin nr. 8457/1999 në përcjelljen e saj. Kjo praktikë është vënë në dispozicion të gjykatës me shkresën nr. 443/4 prot., datë 27.10.2020 të Ministrisë së Drejtësisë, gjithsej 16 akte, të cilat në përshkrimin e statusit të tyre përbënin "sekret" sipas ligjit nr. 8457/1999. Pas kërkesës së mbrojtësit të kërkuesit që gjyqtarja të konfirmonte nëse ishte e pajisur me certifikatën e sigurisë për vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë dhe, nëse jo, t'i drejtohej Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për t'u pajisur me këtë certifikatë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vendosur t'ia kthejë të gjitha aktet e përcjella për çështjen Ministrisë së Drejtësisë, me arsyetimin se nuk kishte akses në këto dokumente bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 8457/1999, pasi ato ishin të klasifikuara si "sekret shtetëror" *(shih procesverbalin e seancës së datës 18.12.2020, faqet 5–6).*

46. Gjykata vëren se ligji nr. 8457/1999 dhe vendimi nr. 188, datë 4.3.2015 i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit" parashikojnë kushtet, kriteret, rregullat, si dhe subjektet që mund të kenë akses në informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", ku përfshihen edhe institucionet shtetërore, të cilat gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, njihen, prodhojnë, ruajnë, administrojnë, transportojnë dhe transmetojnë informacion të klasifikuar.

47. Nga sa më lart, Gjykata konstaton se, pavarësisht se bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë mund të kishte akses në informacionin e klasifikuar mbi të cilin është bazuar urdhri nr. 253/2020 i ministrit të Drejtësisë për vendosjen e kërkuesit në regjimin e posaçëm të burgut të sigurisë së lartë, ajo ka vlerësuar të kthejë materialet e dërguara nga Ministria e Drejtësisë, duke e vlerësuar urdhrin e ministrit vetëm nga ana formalo-procedurale dhe jo nga ajo substanciale.

48. Gjykata vëren se pavarësisht se në ankimin e tij drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kërkuesi kishte ngritur pretendime jo vetëm për procedurat e nxjerrjes së urdhrit nr. 253/2020, por edhe për thelbin, gjykata nuk ka vlerësuar nëse të dhënat e akteve, mbi të cilat është bazuar ky urdhër, janë marrë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, nëse kërkuesi duhej të ishte njohur me këto akte me qëllim të garantimit të së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor në drejtim të kontradiktoritetit, si dhe nëse në nxjerrjen e tyre organet shtetërore kanë vepruar në përputhje me ligjin dhe jo në mënyrë abuzive ose arbitrare.

49. Për pasojë, mungesa e shqyrtimit të elementeve substanciale të urdhrit nr. 253/2020 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë nuk u konstatua dhe nuk u rregullua nga Gjykata e Posaçme e Apelit ose Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të kërkuesit për vlerësimin nga gjykatat të urdhrit të ministrit të Drejtësisë, me qëllim që, të paktën ato, të njiheshin me përmbajtjen e këtyre akteve.

50. Gjykata evidenton se në çështjen konkrete, pretendimet e kërkuesit për procesin e rregullt duhen vlerësuar edhe të analizuara në kontekstin e statusit të kërkuesit, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, pika 2, shkronja "c", të Kushtetutës, përgjatë procesit penal ku po gjykohet fajësia e tij për kryerjen e një vepre penale dhe, për më tepër, duke marrë shkas edhe nga fakti se ndaj tij është zbatuar një regjim i posaçëm, edhe më rigoroz në drejtim të kufizimit të lirisë dhe të të drejtave të tjera. Pa paragjykuar fajësinë për kryerjen e veprës penale ndaj tij, për shkak të së cilës kërkuesit i është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg" dhe vërtetësinë e të dhënave, për shkak të të cilave ndaj tij është caktuar masa e regjimit të posaçëm, Gjykata thekson se sipas nenit 15 të Kushtetutës, organet e pushtetit publik kanë detyrimin të respektojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor edhe ndaj personave, të cilëve sipas ligjit iu është kufizuar liria, pasi, ashtu si të drejtat e tjera, edhe kjo e drejtë është e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme.

51. Në këtë pikëpamje, duhet vënë re se në rastin e kësaj kategorie individësh, liria e të cilëve

është kufizuar sipas ligjit, organet e pushtetit publik kanë detyrime shtesë për të dëshmuar se të drejtat kushtetuese të tyre respektohen dhe, pikërisht për këtë arsye, nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës parashikojnë garanci specifike për këtë kategori individësh, ku ritheksohet në mënyrë të veçantë se çdo person, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

52. Për sa më lart, Gjykata çmon se, në rastin konkret, kërkuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të parimit të kontradiktoritetit në gjykim.

53. Megjithatë, Gjykata vlerëson se pavarësisht konstatimit të shkeljes së të drejtave themelore në rastin e kërkuesit, dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për të. Në këto kushte, duke pasur parasysh shuarjen e efekteve të urdhrit të kundërshtuar për shkak të mbarimit të afatit të tij, Gjykata vlerëson të shprehet vetëm për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit të ankimit të kërkuesit ndaj urdhrit nr. 253/2020 të ministrit të Drejtësisë.

54. Si përfundim, Gjykata çmon se, kërkuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të parimit të kontradiktoritetit në gjykim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit të ankimit ndaj urdhrit nr. 253, datë 28.7.2020, të ministrit të Drejtësisë, "Për vendosjen në regjimin e posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë për të paraburgosurin Emiljano Shullazi", si pasojë e mosrespektimit të parimit të kontradiktoritetit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.2.2022.
Shpallur më 17.3.2022.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Përparim Kalo

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 47
Datë: 2022/03/29 16:38:00
1d2f3a94-3691-4694-8382-00f3cb7fc365

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 304 lekë